

**UNITED NATIONS**  
United Nations Interim  
Administration Mission in  
Kosovo



**NATIONS UNIES**  
Mission d'Administration  
Intérimaire des Nations Unies  
au Kosovo

**PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT**

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

**T R A N S K R I P T**

**NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR  
MË 15 SHKURT 2008**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA, ODRŽANE 15  
FEBRUARA 2008.GODINE**

**SHKURT – FEBRUAR  
2008**

### **Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
2. Njoftim lidhur me publikimin e rezultatit të votimit përmes sistemit elektronik,
3. Shqyrtimi i Mocionit të grupeve parlamentare (5) për shmangie nga Rregullorja e Punës së Kuvendit për shqyrtimin dhe miratimin e ligjeve të identifikuara në Propozimin gjithëpërfshirës nga Pakoja e Ahtisarit për zgjedhjen e Statusit të Kosovës,
4. Shqyrtimi i Propozimit për shmangien e afateve nga Rregullorja e Punës së Kuvendit për shqyrtimin dhe miratimin e Projektligjit për Buxhetin e viti 2008, si dhe procedimi i tij.
5. Shqyrtimi i Propozimit të Grupit Parlamentar të AAK-së për zgjedhjen e Naim Maloku anëtar i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës,
6. Shqyrtimi i Propozimit të Kryeministrit për emërimin e zëvendësministrave dhe
7. Shqyrtimi i Propozimit të Grupit Parlamentar të SLS-së për zgjedhjen e dy anëtarëve në komisionet parlamentare.

### **Dnevni red:**

1. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
2. Upoznavanje u vezi objavljivanja rezultata glasanja elektronskim sistemom,
3. Razmatranje Mocije parlamentarnih grupa (5) da se odstupi od Poslovnika Skupštine za razmatranje zakona identifikovanih u Sveobuhvatnom predlogu iz Paketa Ahtisarija o rešavanju statusa Kosova,
4. Razmatranje Predloga da se odstupi od Poslovnika Skupštine za razmatranje i usvajanje Nacrta budžeta za 2008. godinu, kao i njegovo procesuiranje,
5. Razmatranje Predloga Parlamentarne grupe AAK da se Naim Maloku izabere za člana Predsedništva Skupštine Kosova,
6. Razmatranje Predloga premijera za imenovanje zamenika ministara i
7. Razmatranje Predloga Parlamentarne grupe SLS o izboru dva člana u parlamentarnim komisijama.

## **A g e n d a:**

1. Approval of the minutes from the previous session,
2. Notification regarding publication of the voting results through electronic system,
3. Discussion of the motion of the Parliamentary Groups (5) to disregard the Rule of Procedure of the Assembly in order to discuss and approve the identified laws of overall proposal from the Ahtissari's Package for selection of the Kosovo Status,
4. Discussion of the proposal for avoidance of the terms from the Rule of Procedure of the Assembly of Kosovo in discussing and approving the Draft Law on Budget for year 2008, as well as its proceeding.
5. Discussion of the proposal of the Parliamentary Group of AAK in selecting Naim Maloku as a member of the Presidency of the Assembly of Kosovo,
6. Discussion of the proposal of the Prime Minister for nomination of vice ministers and
7. Discussion of the proposal of the Parliamentary Group of SLS for selection of two members in Parliamentary Committees.

Seanca filloi punën në orën 10,20.

Seancën e drejtoi zoti Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit të Kosovës.

**KRYETARI I KUVENDIT JAKUP KRASNIQI:**

Të nderuar deputetë, zëvendëskryeministra dhe ministra,

Mirë se keni ardhur në seancën plenare.

Para se të fillojmë punën, dëshirojmë ta testojmë sistemin elektronik të votimit dhe ju kisha lutur që t'i vendosni të gjithë kartelat.

Bëhuni gati për të provuar. Faleminderit!

Votojmë tash. Mund të provojmë edhe “për” edhe “kundër”. Do të thotë ky është vetëm një testim para se të vazhdojmë me punën.

Si po duket, kemi deputetë pa kartela. Nëse po, sa janë pa kartela, le të shohim.

Ndërkohë, do të merrni rezultatin e votimit të shkruar në letër dhe do ta shihni secili rezultatin e votimit. Votimi elektronik, nuk është i fshehtë.

Të nderuar deputetë, të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra,  
Rendin e ditës e keni marrë dhe për pikën 4, Kryeministri ka kërkuar të shtyhet për orën 14, sepse është duke i bërë vizitë Republikës së Maqedonisë.

Ju njoftoj se në sallë janë të pranishëm 115 deputetë dhe janë plotësuar kushtet për t'ia filluar punës.

Po ashtu, ju njoftoj se, në pajtim me Rregullën 6, pika 2 dhe 23 të Rregullores së Punës të Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Kush është për rendin e propozuar të ditës, të cilin e keni para veti, me ndryshimin e propozuar që të shtyhet pika e katërt për orën 14.

Faleminderit!

A ka kundër? Nuk ka.

A abstenon ndokush? 2 abstenime.

Konstatoj se rendi i ditës për seancën e sotme, u miratua.

Vazhdojmë me pikën 1 të rendit të ditës:

**- Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare, të mbajtur më 31 janar 2008**

Procesverbali dhe transkripti, nga seanca plenare e mbajtur më 31 janar 2008, iu janë shpërndarë me kohë deputetëve.

Lus deputetët të deklarohen se a kanë vërejtje në procesverbal?

Meqenëse nuk ka vërejtje, konstatojmë se u miratua procesverbali.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

**- Njoftim lidhur me publikimin e rezultateve të votimit përmes sistemit elektronik**

Ju njoftoj se, në pajtim me Rregullën 24 të Rregullores së Punës të Kuvendit, dhe në konsultim me kryetarët e grupeve parlamentare, duke filluar nga kjo seancë plenare, votimi elektronik do të regjistrohet me emër dhe do të publikohet në ueb-faqen e Kuvendit.

Do të thotë, ky ishte njoftim për të gjithë deputetët, por edhe për të tjerët.

Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

**- Shqyrtimi i mocionit të grupeve parlamentare për shmangie nga Rregullorja e Punës së Kuvendit për shqyrtimin dhe miratimin e ligjeve të identifikuara në Propozimin gjithëpërfshirës nga Pakoja e Presidentit Ahtisari për zgjidhjen e statusit të Kosovës**

Në pajtim me rregullat procedurale, grupet parlamentare të Kuvendit të Kosovës kanë propozuar mocion përmbajtjesor për shmangie nga Rregullorja e Punës të Kuvendit me rastin e procedimit, të shqyrtimit dhe të miratimit të ligjeve nga Pakoja e Ahtisarit.

Njëherësh, në mbledhjen e Kryesisë, të mbajtur më 13 shkurt 2008, kryetarët e grupeve parlamentare i kanë propozuar përfaqësuesit e vet për anëtarë të Komisionit Ad-hoc të paraparë me këtë mocion, përbërjen e të cilit e keni marrë së bashku me material.

Ju njoftoj se për miratim të këtij propozimi kërkohet shumica e dy të tretave të deputetëve të pranishëm në seancë plenare – Rregulla 61.

Së pari, do ta marrin fjalën shefat e grupeve parlamentare.  
Fjalën e ka deputeti Ramë Buja.

RAMË BUJA: I nderuar zoti Kryetar,  
Të nderuar kolegë deputetë, zëvendëskryeministra dhe ministra,  
Dua t'ju njoftoj se ne, shefat e grupeve parlamentare, ose kryetarët e grupeve parlamentare – të thuhet se sa shefa jemi dakorduar që këtë mocion ta bëjmë bashkë dhe e kemi bërë bashkë, e kemi tumirë dhe aprovuar bashkë dhe këtu në mocionin që e keni përpara nuk e kemi nënshkrimin e zotit Bojan Stojanović, dhe ai thotë se në parim e përshëndesin këtë procedurë të përshpejtuar. Domethënë, gjashtë grupe të tjera parlamentare kanë vënë firmat e tyre dhe janë pajtuar që mocioni të votohet dhe procedura e miratimit të ligjeve të Pakos së Ahtisarit të jetë me procedurë të përshpejtuar. Ju faleminderit!

KRYTARI: Faleminderit, Ramë Buja!  
Vazhdojmë me grupet parlamentare, nëse ka. LDK- Nuk e ka kërkuar fjalën. AKR- Jo. AAK, deri më tani s'e ka kërkuar fjalën. LDD, si duket gjithashtu është në pajtim me atë që tha deputeti Ramë Buja. SLS, po ashtu. Grupi "7+", nuk paraqitet.

Meqenëse, nuk paraqiten përfaqësuesit e grupeve për diskutim, atëherë shkojmë me diskutimet e deputetëve. Për fjalë është paraqitur Ramadan Avdiu.

RAMADAN AVDIU: I nderuari Kryetar,  
Sipas të gjitha gjasave, do të jetë ndonjë defekt teknik, sepse pas fjalës së shefit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, nuk kam për të thënë asgjë.

KRYETARI: Fjalën, me radhë, e ka kërkuar Numan Baliq.

NUMAN BALIĆ: Faleminderit, zoti Kryetar! Selam svima ovde koji su prisutni!  
Kao što znate, ja sam bio jedini poslanik koji je napravio taj izuzetak, neki smatraju skandal, te sam glasao protiv Paketa Ahtisarija, zbog poznatih razloga koje sam navodio više puta, a koji su na štetu i većinske zajednice i drugih zajednica, prema tome i Bošnjaka, i Albanaca, i Roma, i Egipćana i svih ostalih.

U ovom slučaju, vezano za ovo usvajanje, bez prethodne diskusije odnosno u jednom paketu i na način kako je objašnjavano, mislim da je važno istaći činjenicu da se radi o čitavom setu zakona koji predviđaju Zakon o izborima, Zakon o lokalnoj vlasti, Zakon o granicama budućih opština, te neke druge zakone koji se tiču budućeg statusa Kosova i statusa svih zajednica u njemu.

Takodje želim da istaknem da, kao poslanik u Parlamentu Kosova, kao čovjek koji je već 18 godina radio na svemu ovome, mnogo prije mnogih ljudi koji se nalaze ovde, nijednom riječu niti sam konsultovan, niti znam sastav tih zakona, niti sam upoznat sa bilo čime. Sudeći prema današnjim saznanjima i ovih dana koje sam imao, vidio sam da i mnoge parlamentarne grupe i da mnogi poslanici uopšte niti su uzeli učešće u pripremanju tih zakona, niti su očima vidjeli te zakone. Ja mislim da je neshvatljivo i nevjerovatno da 120 poslanika glasa za nešto u čemu uopšte nije uzelo učešća ili većinom nije uzela učešća niti je imala mogućnost da sudijeluje. Smatram da se radi o sudbini ove zemlje, smatram da se radi o veoma važnim zakonima ove zemlje i smatram da je neprihvatljivo da mi ne možemo uzeti učešće u pravljenju tih zakona i takodje osudjujem da je ovo način imponovanja ovoj Skupštini i svima nama, i meni osobno, i našim zajednicama da, jednostavno, htjeli ili ne htjeli, moramo glasati za te zakone.

Protivim se toj praksi i protestujem zbog toga! Hvala vam ljepa!

KRYETARI: Faleminderit! Për fjalë është paraqitur, Hydajet Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Kur merren vesh shifat e grupeve parlamentare, është e zorshme për deputetin të veçojë fjalën - qëndrimin e tij.

Megjithatë, për hir të së vërtetës dhe të parimit, s'mund të mos konstatoj se kjo procedurë, kështu siç ka filluar, është, thënë më së buti – e lëndueshme.

Po ndryshojmë rregullat e procedurës së Kuvendit, pa e pyetur Komisionin për Rregullore. Pse?

Po vendosim t'i miratojmë me procedurë të shpejtë të pazakonshme disa ligje, pa e ditur cilat ligje, pa e pasur çka ka brenda.

Disa prej këtyre ligjeve ne i kemi marrë, por i kemi marrë në legjislaturën e mëparshme. Ka një parim, sipas të cilit, ligjet që kanë qenë në procedurën e mëparshme, konsiderohen punë të pakryera dhe në legjislaturën e re duhet të riprocedohen. Pse ta anashkalojmë?

Është kërkuar që kjo të bëhet për shkak të dokumentit të Ahtisarit, të cilin e ka miratuar ky Kuvend. Megjithatë, nuk del nga kjo pse e ka miratuar ky Kuvend pakon, ashtu siç e ka miratuar, se duhet tash të miratojë në këtë procedurë edhe gjithçka që futet në ligje. Nuk e nënkupton njëra – tjetrën.

Për më tepër, është thënë se këto ligje duhet t'i miratojë Kuvendi, jo vetëm në procedurë të përshpejtuar, por edhe t'i miratojë formalisht. Pse formalisht? Është kërkuar që një komision ad-hoc të kryejë punën që zakonisht do të duhej ta kryenin të gjitha komisionet. Pse? Pse të mos e kryejnë komisionet që janë funksionale për atë fushë? Po na ndodh ajo që na ka ndodhur me kushtetutë, zonja e zotërinj. Dhe, kurrë nuk kemi marrë përgjigje. Pse duhet të anashkalohen institucionet e Kosovës? Pse duhet të anashkalohet Kuvendi i Kosovës? Kjo ngjall dyshime dhe nuk i bën nder as Kuvendit, as atyre që kanë punuar në këto procese. Në një rast kur po diskutonim pikërisht për këtë dokumentin e Ahtisarit, të cilit i janë bërë shumë vërejtje dhe ato vërejtje do të duhej të përfshiheshin, zonja e zotërinj, argumenti i vetëm që kemi dëgjuar ka qenë – kjo s'mund të ndryshohet.

KRYETARI: Ju lutem, nuk je në rend të ditës!

HYDAJET HYSENI: Jam krejt në rend të ditës, zoti Kryetar!

KRYETARI: Jo, s'je në rend të ditës.

HYDAJET HYSENI: Mirë, u ktheva! Dhe këtu e kam dëgjuar, po ashtu, argumentin se s'mund të ndryshohet. Është interes i madh i Kosovës, duhet të përpijmë gjithçka. Të jemi të sqartë, ky Kuvend nuk pajtohet me shumëçka që është në dokumentin e Ahtisarit dhe që do të jetë në Pakon e ligjeve të Ahtisarit.

(Ndërhyrje e kryetarit, nuk kuptohet për transkriptim)

HYDAJET HYSENI: Po e shpreh mendimin tim dhe le të më demantojë koha. Nëse duhet të miratohet si diçka e imponuar, le të vijmë, zonja e zotërinj, ata që e imponojnë dhe le të kërkojnë që kjo të miratohet pa Kuvend. Le ta ndërpremë njëherë e përgjithmonë praktikën që ky Kuvend të miratojë diçka me të cilën nuk pajtohet, po ta miratojë, sepse dikush po ia imponon. Nuk iu bënë nder as atyre që imponojnë. Ky Kuvend ka dëshmuar pjekuri politike e institucionale për t'i zgjidhur problemet siç duhet dhe për t'u dhënë rrugë demokratike- institucionale. Unë jam i bindur se mënyra më e mirë është që të shkojmë në rrugë normale parlamentare dhe Kuvendi të dëshmojë se është jo më pak i pjekur se liderët e tij.

Ju faleminderit!

KKRYETARI: Faleminderit, deputet Hyseni për fjalën historike, por nuk jemi këtu për të bërë histori. Historinë e kanë bërë të tjerët. Për fjalë është paraqitur Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuari Kryetar i Kuvendit të Kosovës,

Të nderuar deputetë, ministra, zëvendësministra,

Ju lutem, shumëkush po e quan Pako, kurse vetë autori, zoti Ahtisari nuk e ka quajtur pako, por e ka quajtur propozim. Prandaj, ju lutem, që në të ardhmen ta quajmë ashtu si është në origjinal. Ky propozim është dizajnuar për t'u miratuar në mënyrë bilaterale. Kjo nuk ka ndodhur. Prandaj, shtrohet pikëpyetja se sa do të ishte, si të themi kështu, oportune që të konsiderohet i miratuar. Ju lutem, çdo privilegjim është deprivilegjim i dikujt. Edhe unë, gjithmonë do të isha angazhuar dhe mendoj se plotësisht kam të drejtë

që ne duhet ta bëjmë një Kosovë demokratike, të përparuar, të lirë, të barabartë për secilin qytetar, pa asnjë privilegje. Çdo privilegje e kujtëdo është deprivilegjim i dikujt tjetër, prandaj nuk do të ishte fare e akceptueshme. Unioni Evropian e ka një dokument që quhet Konventa për Minoritetet. Ato janë standarde ndërkombëtarisht të pranueshme, valide dhe do të ishin fare të mira për t'u inkuadruar në Kushtetutën dhe në dokumentet tona.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka Vlora Çitaku.

VLORA ÇITAKU: I nderuar zoti Kryetar, zëvendëskryeministra, ministra, kolegë deputetë,

Unë mendoj se kemi devijuar pak nga rendi i ditës, sepse nuk jemi këtu për të diskutuar përmbajtjen e Pakos së Presidentit Ahtisari apo propozimin, siç e quajti profesor Smaka, por një procedurë përmes së cilës ne do të procedonim me ligjet që derivojnë nga Pakoja e Presidentit Ahtisari, përmbajtjen e së cilës ky Kuvend e ka miratuar me shumicë votash në legjislaturën e kaluar. Nëse do të duhej hapur debat për përmbajtjen, atë mund ta bëjnë grupet parlamentare përmes propozimeve për ta vënë në rendin e ditës, mirëpo sot jemi duke diskutuar për një pikë të veçantë që ka të bëjë me procedimin e ligjeve që derivojnë nga ajo pako dhe do t'ju kisha lutur që debatin ta mbajmë në atë vijë.

Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka ministri Arsim Bajrami.

ARSIM BAJRAMI: Kryetar i Parlamentit,

Të nderuar deputetë,

Atë që vërtetë doja ta thosha unë, e tha zonja Vlora Çitaku. Ky nuk është një debat për Pakon e Ahtisarit, ai debat është mbajtur ma herët dhe, siç e dini, Kuvendi i ka thënë mbështetje unanime Pakos së Ahtisarit. Thjesht, është një propozim që, meqenëse implementimi i këtyre ligjeve është pjesë e pakos së statusit final, kërkesa është që të bëhet një procedurë e shpejtuar e diskutimit dhe e miratimit të këtyre ligjeve dhe kjo ka edhe një mbështetje ligjore, sepse Kuvendi i Kosovës ka të drejtë dhe mundësi ta ndërrojë Rregulloren e Punës. Natyra e këtyre ligjeve është urgjente, këto ligje janë pjesë e statusit final, kështu që, mendoj se duhet ta fokusojmë këtu debatin, jo tani të hyjmë në kualifikime politike të Pakos së Ahtisarit. Ato janë diskutuar në një mbledhje paraprake ku Kuvendi në mënyrë unanime e ka miratuar këtë pako. Thjesht, qëllimi është që të krijohet një bazë juridike që këto ligje të procedohen në mënyrë të shpejtë për shkak se vetë kërkesat e statusit final kërkojnë një procedim të tillë. Pra, unë dola vetëm për ta sqaruar këtë, sepse tani nuk është koha për debate politike për Pakon, por është koha për një intervenim në Rregulloren e Punës që të mundësohet, në fakt, procedimi më i shpejtë i këtyre ligjeve.

Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Për fjalë ishte paraqitur pak më herët, deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Unë nuk e kam quajtur as nuk e quaj një dokument, cilindo qoftë, ashtu si do ta kisha quajtur unë, po e zëmë, arbitrarisht, po me korrektësi. Vetë zoti Ahtisari e ka emërtuar dhe definuar “propozim”. Prandaj, unë e quaj “propozim” dhe kushdo që nuk e quan “propozim”, gabon. Faleminderit!

KRYTARI: Faleminderit! E kemi lexuar “Ppropozim gjithëpërfshirës”, po s’di sa e keni dëgjuar. Fjalën e ka deputeti Sabit Rrahmani.

SABIT RRAHMANI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Vetëm desha të kyçem lidhur me atë që e tha zoti Ramë Buja. Këtu po thuhet shumë mirë se është shqyrtim i mocionit të grupeve parlamentare. Nuk është vetëm i shefave të grupeve parlamentare, por i grupeve parlamentare. Pra, të gjithë shefat e grupeve parlamentare është dashur të konsultohen me deputetët e vet që i kanë në grupe parlamentare. Unë po mendoj që çdo deputet që po e merr fjalën këtu është vetëm debat bosh. Shumë mirë dhe e qartë është që është mocion i grupeve parlamentare e jo i deputetëve në veçanti. Atëherë, grupet parlamentare ishte dashur të merren vesh ndërmjet veti e jo të zhvillojnë debate boshe këtu. Mendoj se nuk ka arsye për debat.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Sabit! Për fjalë është paraqitur anëtari i Kryesisë, Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Zoti Kryetar,

Kolegë të nderuar deputetë dhe ministra të Qeverisë së Kosovës,

Ne kemi një mocion për Kuvendin, të paraqitur dhe të nënshkruar nga kryetarët e grupeve parlamentare që lidhet me ligjet që dalin nga Plani i Ahtisarit. U tha këtu dy-tri herë dhe mirë që u tha, unë pajtohem me ata që thanë se sot s’duhet të bisedojmë për atë çka shkruan te Pakoja e Ahtisarit, mirëpo të gjithë këta, pra duhet të bëhen konkret e të bisedojnë çka kanë në letër përpara, sepse kjo është letër, mocion letër. Kjo s’është lexuar, është dhënë në dorë. Unë mendoj që është dashur të lexohet këtu kjo letër. Kur kërkohet të votohet me 2/3, duhet të lexohet, jo vetëm të dërgohet si letër. Por, po e zëmë që deputetët e paskan lexuar të gjithë. Unë dua këtu të tërheq vërejtjen që Kuvendi e ka të drejtën ta ndërrojë Rregulloren e vet, e ka të drejtën që të gjejë forma më të shpejta të aprovimit të ligjeve në situata të caktuara, e kjo është e tillë për Kuvendin dhe këtu ekziston logjika.

Vërejtja ime ka qenë edhe në Kryesi, kur ka ardhur ky mocion, dhe këtu që duhet ta bëj publike para kolegëve deputetë, që mënyra se si është kërkuar kjo zgjidhje nuk më ka pëlqyer dhe më është dukur që është shumë reduksioniste, me një përpjekje që t’i merret e drejta Parlamentit që me institucionet që i ka brenda, në këtë rast komisionet, ta kryejë këtë punë më fuqishëm dhe më intensivisht se sa të gjitha këto punë që janë kaq të ngutshme, qenkan kaq të domosdoshme, t’i grumbullohen një Komisioni ad-hoc, i cili menjëherë mbrapa i ka emrat.

Pra, kolegë të nderuar, të gjitha këto punë që duhet të kryehen në një afat të shpejtë, do t'i kryejnë Fehmi Mujota, Selvije Halimi, Lutfi Haziri, Haki Shatri, Ibrahim Makolli, Lulzim Zeneli, Ardian Gjini, Enis Kervan dhe një vend më ka mbetur thatë. Pra, me këtë që ne kemi sot këtë mocion, grupet tona parlamentare kërkojnë, pra ne kërkojmë prej vetvetes, që Kuvendi për të gjitha këto ligje të votojë vetëm formalisht në fund, që komisionet e Kuvendit më s'kanë të drejtë të bëjnë vërejtje, sepse vërejtje në ligje kanë të drejtë të bëjnë vetëm ky Komision ad-hoc ose vetëm këta 9 zotëri e zonja. Kjo është esenca, ky është problemi.

Pra, kërkohet që të shpejtohen procedurat dhe na po hymë në fazat kur po shpejtojmë procedurat për ligje të veçanta. Instrumentimi, aranzhimi, metoda e kërkimit për mua ka vërejtje dhe unë këto vërejtje i thashë. Faleminderit shumë, zoti Kryetar!

KRYETARI: Faleminderit, për fjalën! Për fjalë është lajmëruar Nekibe Kelmendi.

NEKIBE KELMENDI: I nderuari zoti Kryetar,  
Të nderuar zëvendëskryeministra e ministra dhe kolegë deputetë,

Unë, duke parë se çka është vënë në rend të ditës sot, e kam kuptuar ashtu siç e kam kuptuar vetë se ne duhet të votojmë për shmangie nga Rregullorja e Punës së Kuvendit për shqyrtimin dhe miratimin e ligjeve. Mendoj se me Kreun 17, Rregullën 61 të Rregullores së Punës së Kuvendit një gjë e tillë është lejuar, sepse aty decidivisht shkruan. "Për shmangiet nga Rregullorja e Punës mund të vendos Kuvendi me 2/3 e shumicës së deputetëve të pranishëm në Kuvend, përveç nëse kjo është në kundërshtim me dispozitat e Kornizës Kushtetuese". Prandaj, konsideroj se kur është fjala për shmangie, ne nuk kemi çka të diskutojmë dhe të debatojmë, sepse këtë na e mundëson Rregullorja e Punës së Kuvendit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Për fjalë është lajmëruar Driton Tali.

DRITON TALI: Zoti Kryetar,  
Të nderuar të pranishëm,

Unë mendoj se këto debate të cilat i dëgjuam nuk janë të kota, por janë si rezultat i moskënaqësisë edhe të atyre deputetëve të cilët e kanë votuar dokumentin e Ahtisarit dhe tash kërkohet që me një procedurë shumë më të shpejtë t'i votojmë disa ligje të cilat rrjedhin nga ai dokument, me të cilin edhe ashtu nuk jemi të kënaqur, apo nuk janë të kënaqur ata të cilët e kanë votuar, po them, se unë s'kam votuar, s'kam kurrfarë gjynahesh aty.

Unë jam kundër ngutjes. Mos të bëjmë më shumë zarar, sepse as gjysmën e ligjeve, mos të them të gjitha, shumica këtu nuk i dinë, nuk i kemi parë. Mendoj se duhet t'i këqyrim ngadalë, me analiza të thukëta të mundohemi ta zvogëlojmë dëmin, sepse kemi të bëjmë me ardhmërinë e fëmijëve tanë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Replikë ka kërkuar Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Çështja e procedurave është shumë në rregull dhe unë kolegen Nekibe Kelmendi e përgëzoj se ajo është abecedë. Po të mos kishte qenë mundësia që kemi të drejtë ta ndërrojmë rregulloren, ne se kishim vënë në rend të ditës fare. Ajo është ana formale, por Kuvendi bisedon për substancën e asaj që propozohet në bazë të anës formale. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Shkumbin Demaliaj.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Në këtë rast besoj se humbja e kohës është në disfavorin tonë. Ne e kuptojmë këtë. Dihet se ligjet që burojnë nga Pakoja e Ahtisarit janë ligje që janë aprovuar dhe forma e aprovimit ka ndodhur në formë procedurale në këtë Kuvend. Besoj që për ne është një anashkalim apo lëndim i demokracisë parlamentare në këtë rast. Mirëpo, besoj se ka qenë qëndrim politik i të gjitha partive politike për të ardhur deri te ky përfundim.

Ndërkaq, tani e tutje besoj se e dimë çfarë na pret gjatë ditëve në vazhdim. Ne sot kemi nxjerrë në pah dhe mendojmë të diskutojmë e të tregojmë se çka mund të burojë dhe të dalë nga Pakoja e Ahtisarit. Besoj se duhet të dalim me një qëndrim politik në këtë rast dhe të shkojmë më tutje, sepse për shkelje të procedurave dihet, kanë ndodhur që nga fillimi. Mirëpo, besoj se edhe komisionet parlamentare në të ardhmen mund t'i shqyrtojnë ato, sepse e dimë se nuk është volumni aq i madh i atyre ligjeve që janë hartuar deri më tash. Ka kolizion nëpër to, mirëpo besoj se duhet të tejkalojmë këtë sfidë sepse për këtë kanë marrë qëndrim shëfat e grupeve parlamentare. Ne e kemi diskutuar këtë edhe besoj se duhet të ecim përpara, mos të ndalemi. Është një propozim që besoj se Kuvendi duhet ta kuptojë për momentin në të cilin ndodhet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputeti Gani Koci.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Përshëndetje Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Ne, vërtet, siç u tha edhe nga diskutuesit e mëparshëm, mund të vazhdojmë këtë diskutim deri vonë edhe mos të nxjerrim asnjë përfundim. Më duket se kërkesa është e qartë. Rregulla 61 lejon një shmangie nga një rregull tjetër ose nga një procedurë tjetër, qoftë në këtë rast për miratimin e ligjeve ose për një çështje tjetër që është e përcaktuar me këtë Rregullore. Unë, me sa kuptoj, ky mocion është bërë që vërtet të mos përfillen rregullat 33, 34 dhe 35 të miratimit të ligjeve. Se a është esenciale ose joesenciale kjo, le të mbetet ose të diskutohet diku tjetër, por me sa di unë, ose me sa kuptoj unë, të gjitha ato ligje që derivojnë nga propozimi i Ahtisarit janë bërë nga njerëzit tanë ose, së paku, me njerëz tanë, me të gjitha ato grupe punuese, natyrisht me mbështetjen edhe të subjektit edhe të faktorit ndërkombëtar, dhe, vërtet, në qoftë se na kanë ardhur si të gatshme ato në një pako nga dikush tjetër, nuk do të ishte krejt e lehtë që t'i tejkalojmë pa një shikim ose rishikim të tyre. Por, derisa e dimë se në ato projekte ose në ato projekte të atyre ligjeve kanë punuar edhe njerëzit tanë edhe nga grupet politike dhe jopolitike, nuk di pse

duhet të shtrohet tash esenca e atyre ligjeve. Shmangia nuk nënkupton që ne si deputetë të mos i kemi ato ligje në dorë dhe të mos japim edhe një mendim për ato ligje. Në fund të fundit, mund ta zgjedhim edhe një komision ad-hoc, si është këtu, por me shmangien nënkuptoj që të mos shkohet në dy javë, në tri javë, në lexim të parë e në lexim të dytë dhe të tretë. Kjo është çështja. Për këtë mund ta jap mendimin Komisioni ad-hoc të cilin e miratojmë sot ose nuk e miratojmë sot. Mos ta zgjasim këtë diskutim por të votojmë për shmangie sepse dihet ku është shmangia.

**KRYETARI:** Është e qartë, deputetët po nxiten nga diskutimet që vërtet nuk po prodhojnë asgjë, por unë jam i obliguar që t'ua jap fjalën. Për fjalë është paraqitur deputeti Nexhat Daci.

**NEXHAT DACI:** Ju faleminderit, zoti Kryetar,!

Unë kam filluar të brengosem në dy vitet e fundit për mungesë të vullnetit të udhëheqësive në mandatin e kaluar dhe po vazhdon edhe tani që të mos u jepet informata e saktë, politikisht korrekte dhe që deputetët të mos trajtohen si të papjekur ose si njerëz të papërgjegjshëm. Kjo ngjau edhe në Kryesinë e fundit të Parlamentit të Kosovës, kur anëtarët e Kryesisë nuk kishin informatë të duhur dhe të saktë dhe u zhvillua një debat jo i shkurtër dhe në momente herë-herë ndoshta edhe jo në nivel të duhur edhe kolegjal. Prandaj, të ndërpritet kjo praktikë dyvjeçare edhe e pozitës së kaluar, edhe e pozitës së tanishme, dhe efektet do të jenë gjithmonë më produktive, do të jenë më të mira. Unë nuk dua të merrem me emra, po kur në Kryesi një njeri i pranishëm thotë, unë e kam shkruar këtë mocion dhe e ka nënshkruar vetëm vetë, atëherë krijohet konfuzion në Kryesi dhe pastaj u korrigjua në takimin me shefat e grupeve parlamentare kur tha që atë që e lexoi më parë, është e saktë. Mungesa e informacionit të vërtetë gjithmonë po krijon destabilitet politik edhe në shoqëri, edhe në vend. Pse diskutojmë për teknikën? Ajo që ministrja e Drejtësisë e tha është profesionalisht krejtësisht e saktë dhe nuk merrem me esencën politike.

Këto ligje, që në një mënyrë, si propozim, apo ekspertët e dinë, i ka aprovuar Parlamenti në përbërjen e kaluar dhe pse nuk themi hapur që është obligim i madh politik i Parlamentit që merr mbi vete që, në insistimin e mos aprovimit të një mocioni të tillë, ne me vetëdije ndoshta me arsye, po me vetëdije, e prolongojmë edhe kohën e finalizimit të deklaramentit ose të rideklaramentit të pavarësisë së Kosovës. Kjo është pjesë përbërëse, kolegë të nderuar deputetë, dhe pse nuk u thuhet deputetëve të përbërjes së re, që janë ndoshta 50% ose më tepër, që këtë punë pozita dhe opozita e kaluar, 6 muaj ose 1 vjet, me punën e saj e ka vulosur gjatë dialogut ose polemikave, nuk di tjetër, me palët e tjera të interesuara në këtë proces.

Ekipi i Unitetit me ekspertët e vet, me ekipet e veta, e ka sjell Parlamentin në pozitë të këtille dhe nuk i jepet informata e saktë. LDD do ta përkrah, unë po ju them, do ta përkrah, mocionin që shefat e kanë nënshkruar të vetëdijshëm për kohën se si kemi ardhur deri në këtë mocion, të vetëdijshëm për momentin që po e jetojmë, dhe nuk dëshirojmë që ne me kontributin tonë ta zgjasim edhe 1 apo 2 muaj, pa e kontestuar fjalën e deputetit në të gjitha mandatet, ose të Hydajet Hysenit ose të dikujt tjetër, sepse të

gjithë ata, edhe profesor Smakaj që e tha, edhe Hydajeti, edhe të tjerët, në fakt si deputetë dhe qytetarë kanë të drejtë të plotë.

Prandaj, ju lutem që udhëheqësia, pozita e tanishme, të jetë transparente dhe nuk ka as opozita pse të ofendohet. Ne jemi deklaruar në partitë opozitare parlamentare që nuk jemi dhe nuk duam të jemi opozitë e procesit politik që po e kalon Kosova, nuk jemi opozitë për deklarimin e pavarësisë, nuk jemi opozitë për proceset që po hasim dhe menjëherë pas arritjeve tona, atëherë ne do të përcaktohem në bazë të propozimeve ose të punës së pozitës.

Prandaj, unë do të thosha që deputetët ta kenë të vërtetën dhe e vërteta në një mënyrë është e këtillë dhe ky është realiteti ynë dhe me vetëdije të plotë po hyjmë në përkrahjen e mocionit që është paraqitur prej shefave të grupeve parlamentare. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Unë po ua tërheq vërejtjen dhe mendoj që të gjitha partitë politike, përmes shefave të grupeve parlamentare, dhe grupet parlamentare kanë qenë të njoftuara dhe kemi qenë shumë transparent në këtë drejtim dhe i kisha lutur deputetët që vërtetë diskutimet e tyre t'i vejnë në shërbim të proceseve në të cilat po hyjmë dhe jo në shërbim të historisë.

Fjalën e ka zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi.

HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kolegë ministra,

Mendoj se duhet ta pranojmë faktin se ne po bëjmë një qasje pak më ndryshe për miratimin e këtyre ligjeve, por nuk besoj që është mirë, që është koha ta bëjmë një qasje më ndryshe për dokumentin e miratuar në Kuvend nga të gjithë ne që kemi qenë prezent dhe Kuvendi i ardhshëm apo ky Kuvend i mbanë obligimet e veta.

Natyrisht se e përmendim edhe disa si propozim, por derisa është miratuar në Kuvend, ka qenë propozim, tash është dokument i Kuvendit. Besoj se kjo është në kuptimin juridik për Pakon e Ahtisarit apo propozim, si e quanim. Është menduar në dy forma që të absorbohet puna e debatit:

E para, t'ju them që besoj se të gjithë e dini, që duket ka nevojë për një koordinim më të mirë në mes të partive politike, grupeve parlamentare brenda për brenda tyre. Në të gjitha grupet punuese për këto ligje që po përmendet se duhet të miratohen në Kuvend, marrin pjesë të gjitha grupet parlamentare, edhe ato të pozitës, edhe të opozitës. Këtu është menduar se absorbohet një formë e diskutimit tonë.

E dyta, të gjitha këto ligje miratohen në grupin për tranzicion, ku është niveli politik më i lartë, ka edhe kryetar partive aty, dhe unë kisha dashur që ata t'i koordinojnë me partitë e tyre politike.

Ndërsa, forma e tretë mendohet që të absorbohet me Komisionin ad-hoc, ku prapë ka nga të gjitha partitë politike. Ne jemi të vetëdijshëm për fazën që po kalojmë, jemi të

vetëdijshëm që ky është një obligim politik, nuk është vetëm procedurë normale legale, por nuk besoj që ndonjë subjekt politik duhet ta ndiej veten të anashkaluar, e aq më pak që nuk ka marrë pjesë në hartimin e tyre deri në fazën përfundimtare të miratimit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Kuçi!

Për fjalë është lajmëruar deputetja Melihate Tërmkolli.

MELIHATE TËRMKOLLI: Faleminderit!

Unë, shkurtimisht do të përpiqem vetëm dy tri fjalë t'i them rreth kësaj çështjeje, ani pse, do me thënë, po bëhet një vazhdimësi e dërgimit edhe me vonesë të materialeve dhe të gjitha këto. Kujtoj që nuk u bë mirë që nuk u dha asnjë shpjegim këtu pak më i gjerë prej grupeve ose prej një të autorizuari nga grupet parlamentare. Unë e kuptoj që mund të përshpejtohen procedurat, por nuk shoh ndonjë arsye të veçantë pse ato duhen të shkelen dhe të anashkalohen, sepse në këtë mënyrë Kuvendit po i merret e drejta për të dhënë një vendim edhe një qëndrim tij, që nuk mund t'ia marrë askush të drejtën këtij Kuvendi. Mendoj që Kuvendi në këtë mënyrë përjashtohet në njëfarë mënyre nga miratimi i këtyre ligjeve, dhe, të themi më së buti, është kjo një fyerje e madhe për Kuvendin edhe për deputetë të këtij Kuvendi, sepse kjo shprehë një mosbesim të madh ndaj këtij institucioni që është votuar nga qytetarët e Kosovës edhe mendoj që nuk ka asnjë nevojë që të ndodhë kështu.

Nëse duhet një Komision ad-hoc t'i miratojë dokumentet shumë esenciale mbi bazë të një dokumenti që e ka miratuar ky Kuvend, atëherë pse paska nevojë të kemi kuvende. Ne hiq s'kemi nevojë të bëjmë kuvende, i bëjmë do komisione, i zgjedhim ad-hoc dhe i kryejmë krejt punët me to. Unë nuk di çfarë efekti do të sjellë kjo dhe efekti i krejt kësaj, kujt i duhen ligje gati në formë klandestine. Unë mendoj që askujt nuk i duhen. Ky Kuvend ka për të punuar shumë edhe për zbatimin e tij, ka për t'u kujdesur për zbatimin e këtyre ligjeve. Nëse i zvogëlohet efekti në trajtimin dhe miratimin e tyre, atëherë cili është roli i tij në zbatimin e tyre. Unë kujtoj që nuk ka asnjë arsye për improvizim, nuk ka rrethana të jashtëzakonshme në Kosovë, kush i ka shpall ato rrethana të jashtëzakonshme? Në Kosovë është një rrethanë e veçantë, është një rast krejtësisht i veçantë, por unë nuk mendoj që janë të jashtëzakonshme, prandaj mendoj që duhet të trajtohen në mënyrë shumë më të drejtë këto çështje dhe pa improvizime. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

I lus deputetët në vijim që të jenë më paqësorë dhe të jenë në rend të ditës.

Fjalën e ka deputeti Zef Morina.

ZEF MORINA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Kolegë deputetë,

Vërtet, Pakon e Ahtisarit ky Kuvend në legjislaturën e kaluar e ka miratuar në mënyrë unanime, por e dimë që në atë propozim ose në atë dokument, apo në atë pako kanë qenë me vija të trasha të përcaktuara kriteret ose të gjitha rregullat se si duhet të funksionojë shteti i Kosovës.

Dëshiroj që të mos më keqkuptojnë kolegët të cilët janë të emëruar këtu si anëtarë të mundshëm të Komisionit ad-hoc, por mendoj që për ligjet e tilla të cilat kanë një rëndësi jashtëzakonisht të veçantë, do të ishte shumë më mirë që të gjitha partitë parlamentare të jenë të përfaqësuara në këtë Komision dhe mendoj që edhe vetë kualiteti i atyre ligjeve do të jetë më i mirë. Është lehtë të miratohen, por unë mendoj që pastaj janë shumë vështirë të amendohen kur dihet se si janë rregullat për amendimin e këtyre ligjeve. Prandaj, unë kërkoj që edhe deputetët kolegë do të përkrahin mendimin tim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Për fjalë është paraqitur deputeti Hajdin Abazi.

HAJDIN ABAZI: Përshëndetje, zoti Kryetar,

Përshëndetje të nderuar deputetë,

Përshëndetje Kabinet i Qeverisë,

Rendi i ditës është shqyrtimi dhe miratimi i mocionit të propozuar dhe këtu u parashtua se edhe ata që e kanë shkruar dhe nuk patën ndonjë diskutim, që do të thotë se janë dakorduar paraprakisht. E kuptoj shqetësimin e një vargu deputetësh këtu që po paraqiten dhe atë shqetësim e ndaj edhe unë, sepse ne, në fund të fundit, duhet t'i votojmë ligjet të cilat do të na i nxjerrin ne këtu përpara, dhe faktikisht, duke i votuar ato, ne e marrim përgjegjësinë mbi vete. Mirëpo, këtu konsideroj se kemi një rast tepër specifik që, pak po thuhet, po më tepër nuk po thuhet, por që të gjithë ne e kemi të qartë, sepse efikasiteti dhe shpejtësia e aprovimit të ligjeve që rrjedhin nga ky mocion do ta përshpejtojnë edhe procedurën e vet shpalljes dhe njohjes së pavarësisë. Duke i pasur parasysh këto rrethana tepër specifike, konsideroj se këtu e kemi edhe bazën morale, por edhe mundësinë për vendim politik që vërtetë ta akceptojmë dhe të mos bëhemi ne vetë shkaktarë të prolongimit të procesit. Deri më tash, në të dy legjislaturat ka pasur mundësi të punohet dhe të përgatitet si duhet, kështu që ne të vazhdojmë në vazhdimësi. Nëse do të ketë shmangie, kësaj radhe ky Kuvend do të ketë nderë të bëjë shmangie, sepse do të bëjë shmangie për hir të pavarësisë së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Gani Buçinca, le të përgatitet Ibrahim Makolli.

GANI BUÇINCA: Ju përshëndes, zoti Kryetar,

Përshëndes Kabinetin qeveritar dhe të gjithëve ju, kolegë deputetë,

Nuk desha ta marrë fjalën, por, vërtet, duke dëgjuar debatin, u nxita dhe dëshiroj të theksoj vetëm disa çështje që më duken se janë shumë të rëndësishme për të na mundësuar ne që të marrim një vendim. Nuk është fjala këtu për një shmangie nga një procedurë, po bëhet fjalë për shmangie nga një e drejtë, nga e drejta e një deputeti që t'i votojë ligjet.

Unë, pikërisht desha të theksoj këtë çështje dhe, sa më përket mua, unë këtë të drejtë timen qysh moti ua kam deleguar atyre të cilët i kanë hartuar këto ligje për arsye se të gjitha ata që kanë marrë pjesë në hartimin e këtyre ligjeve janë ose kolegë partiakë, ose janë kolegë deputetë, ose janë miq tanë ndërkombëtarë. Në rast se ne e kemi pranuar Pakon e Ahtisarit dhe jemi të vendosur që minoritetet t'i kenë të gjitha të drejtat në Kosovë, jo si një detyrim i yni politik, por si një detyrim civilizues, besoj se të gjithë ata që kanë punuar në këto ligje, nuk mendojnë më keq se ne që jemi këtu deputetë. Kështu, iu kisha lutur që të gjithë ta delegoni këtë të drejtë si deputetë, ta delegoni te ata që e kanë hartuar dhe bile, për mua, më duket që është krejt i panevojshëm edhe Komisioni ad-hoc, që ligjet të vinë në Parlament, me një votim formal të votohen dhe të ecim përpara e të mos bëhemi pengesë për procesin.

Pastaj, çka do të bëhet? Më pastaj, ne jemi këtu dhe ju kisha lutur që atëherë të jemi shumë më unikë në rast se do të dalin probleme në implementimin e tyre ose në funksionimin e shtetit të ardhshëm të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI. Faleminderit! Urdhëro zoti Kuçi!

HAJREDIN KUÇI: Ju kërkoj falje që po e marrë fjalën për herë të dytë. U panë dy keqkuptime prej kolegëve. Nuk është fjala për miratim, po për shqyrtim të ligjeve. Miratimin prapë do ta bëjë ky Kuvend me votat e veta. Do të thotë, e drejta e miratimit nuk i merret Kuvendit, vetëm procedura e shqyrtimit bëhet më e përshpejtuar.

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të ARK-së, Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë,

Kujtoj që për të gjithë ata të cilët kanë qenë pjesë e Kuvendit të kaluar, por edhe për qytetarët e Kosovës, dihet mirëfilli se me rastin e pranimin të Pakos së Ahtisarit nga ana e Kuvendit të Kosovës, liderët politikë dhe institucionalë të Kosovës janë zotuar për përshpejtimin e procedurave dhe nxjerrjen e ligjeve që burojnë nga kjo pako. Për më tepër, subjektet politike të përfaqësuara në Kuvend në përbërjen e kaluar kanë marrë pjesë në miratimin, në hartimin e këtyre ligjeve dhe, nëse dikush do të duhej të ishte i pakënaqur, edhe si individ, edhe si grup për shkak të mospjesëmarrjes dhe për shkak të një akti të kryer, natyrisht do të duhej të ishin deputetët e rinj dhe subjektet e reja politike në Kuvend.

Jam shumë i vetëdijshëm që në këtë rast kemi të bëjmë me lëndim të demokracisë por gjithnjë duke pas parasysh se rrethanat në të cilat po kalon Kosova dhe nevoja për përshpejtimin e nxjerrjes së këtyre ligjeve e mundëson dhe, kujtoj, politikisht e arsyeton një gjë të tillë. Në asnjë rast në këtë mocion, që është paraqitur para jush sot, nuk thuhet se ky Komision i merr të drejtat dhe përgjegjësitë e Kuvendit të Kosovës. Ky Komision, sikurse edhe komisionet e tjera të Kuvendit të Kosovës, ka për detyrë që pas të gjitha këtyre hapave që janë ndërmarrë deri tash në procesimin e këtyre ligjeve, të japë mendimin e vet dhe atë mendim t'ia paraqes Kuvendit të Kosovës për ta miratuar.

Prandaj, konsideroj se në asnjë rast nuk kemi të bëjmë me marrje të kompetencave nga ky Komision.

Për më tepër, mund të diskutohen individët, personat të cilët janë brenda këtij Komisioni, por në asnjë rast nuk mund të diskutohet për arsyeshmërinë e tij. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!  
Fjalën e ka deputeti Bajram Kosumi.

BAJRAM KOSUMI: I nderuar Kryetar i Kuvendit,  
Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,  
Të nderuar kolegë deputetë,

Ne sot po e shqyrtojmë një mocion përmbajtësor për përshpejtimin e procedurave, që është në përputhje me Rregulloren e Punës së Kuvendit. Kuvendi mund të vendosë për përshpejtimin e procedurave në raste të veçanta. Unë besoj se gati të gjithë në këtë çështje nuk do të kishin një kundërshtim. Kundërshtimi është te mënyra se si kërkohet dhe ajo që në thelb e paraqet këtë përshpejtim të procedurës. Edhe unë e besoj, si e tha njëri prej kolegëve më herët, se është dashur që ky mocion përmbajtësor të lexohet këtu, që ta kuptojnë saktë deputetët se çka kërkohet në këtë mocion. Në këtë mocion kërkohet që për 24 orë të shqyrtohen rreth 30 ligje dhe për 24 orë të tjera të votohen këto 30 ligje.

Unë pajtohem me gjithë ata që thanë se është një vetëpërkrahje i Kuvendit të Kosovës me një procedurë të tillë, vetëpërkrahje i Kuvendit të Kosovës në çështjen e këtyre ligjeve. Është një vetëpërkrahje e rolit të Kuvendit të Kosovës, e dinjitetit të deputetit dhe të qytetarëve të Kosovës në miratimin e këtyre ligjeve në këtë mënyrë. Kjo mënyrë duket gati si një kamuflim. Ndërsa, ne duhet të jemi të dinjitetshëm në punën që e kemi bërë gjatë viteve të kaluara dhe në punën që jemi duke e bërë tash në vendimin për statusin final të Kosovës.

Nëse ne jemi pajtuar, e jemi pajtuar në këtë Kuvend me propozimin e zotit Ahtisari, jemi pajtuar me gjithë vërejtjet që i kemi pasur dhe nëse, në anën tjetër, këto ligje janë në përputhje me atë propozim, pse të frikësohemi të ecet në procedurë normale? Mund të shkohet edhe në procedurë të përshpejtuar, por përsëri në kuadër të një procedure normale. Pse duhet të frikësohemi nga vetvetja? Nëse ne duhet t'i miratojmë këto ligje, e duhet t'i miratojmë, por duhet ta bëjmë me vetëdije, duhet ta bëjmë shumë hapur dhe shumë qartë se e bëjmë me vetëdije të plotë dhe me ndërgjegje të plotë dhe jo të bëjmë kinse po i kalojmë sy mbyllazi, kinse s'po dimë çka po bëjmë.

Por, ne jemi deputetë, jemi përfaqësues, jemi përfaqësues të popullit këtu. Ne, populli na ka besuar që të marrim vendime këtu, me gjithë besimin, me gjithë respektin për gjithë ata që kanë punuar në ligje, në grupe, e të tjera, e të tjera. Firma e këtij Kuvendit shkon në ato ligje, zonja dhe zotërinj, nuk shkojnë firmat e grupeve punuese, po firma e juaj, zoti Kryetar, dhe firma e juaj zotërinj deputetë e deputete. Prandaj, duhet të ecet me një procedurë të përshpejtuar, por jo kështu si është këtu.

Prandaj, unë në fund e kam një propozim, i nderuari Kryetar. Meqenëse të gjithë e kuptojmë përshpejtimin e procedurës se duhet të ndodhë, ju lutem ftoni shefat e grupeve parlamentare përsëri dhe rregulloni këto 24 orë e 5 minuta, që i keni shkruar këtu pak më ndryshe. Leni hapësirë që deputetë me vetëdije, në mënyrë të vetëdijshme, në mënyrë shumë dinjitoze t'i lexojnë ligjet, të diskutojnë për ligje dhe t'i votojnë ligjet. Thirrëni një takim përsëri, bëni një pauzë, ndryshoni këto orët dhe minuat që i keni bërë në këtë propozim dhe të votojmë pastaj. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Shefin e Grupit parlamentar e keni pasur gjatë një jave në punë dhe ka marrë pjesë në të gjitha punët që janë kryer këtu. Prandaj, të falënderoj për diskutimin, ishte shumë historik. Fjalën e ka Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Do të doja ta plotësoja atë që zëvendëskryeministri Kuçi e paraqiti, por jo në mënyrë detaje.

Qeveria aktuale, si trashëgimi të punës e ka trashëguar një numër të madh të ligjeve që kanë qenë të finalizuara dhe për miratimin e ligjeve që dalin nga Propozimi gjithëpërfshirës i zotit Ahtisari, edhe në Qeveri ka pasur procedura të veçanta.

Mënyra e draftimit, mënyra e punës dhe mekanizmat, që këto drafatligje kalojnë në Qeveri dhe ardhja e një numrit të tyre edhe në Parlament, më herët nëse ju kujtohet, tri nga ato e kanë kaluar leximin e parë dhe janë kthyer mbrapa, ka sjellë shumë çka që sot ndoshta kuptohet, apo interpretohet ndryshe.

Prej momentit të shpalljes së asaj deklarate të shumëpritur, për të cilën të gjithë ne po mendojmë se duhet të ndodhe shumë shpejtë, deri te periudha tjetër e detyrimit apo e miratimit të ligjeve, që shkon si pjesë e obligimit të Kosovës dhe të Parlamentit të Kosovës, vërtet duhet të jetë një mekanizëm, i cili është detyrues dhe garantues i miratimit të atyre ligjeve. Ligjet janë finalizuar. Ligjet, si pjesë e obligimeve, nuk mund të ndryshohen në pjesën që ka qenë e negociueshme, për atë pjesë që ka qenë e negociueshme dhe për atë pjesë që është deklaruar Kuvendi, nuk mund asnjë autoritet, qoftë ai edhe Parlamenti, ta ndryshojë. Për pjesën tjetër strukturore e ligjeve, që sigurisht është një numër i madh i ligjeve, natyrisht që Kuvendi duhet ta ketë fjalën e vet dhe natyrisht që Kuvendi është autoriteti i vetëm i cili mund ta miratojë.

Këtë sqarim isha i obliguar ta jap. Mendoj që deputetët e kuptojnë rëndësinë e procesit dhe të procedurave që duhet të kalojnë dhe, vërtet, pa vonesë, gjithnjë po themi, pa vonesë, se po lajmërohem për fjalë, por është momenti që duhet ta përmbylлим këtë pjesë të punës.

KRYETARI: Ju faleminderit deputet! Fjalën e ka deputeti, Gani Geci.

GANI GECI: I nderuari Kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë nuk e kam ndërmend të bëjë diskutim historik, por do të flas allakaturarë. Ne këtyre herë, kur e prashitnim kallamoqin, nëse e lenim pirrakun dhe shkonim shpejt, mandej kishim probleme me vetë kallamboqin, ose nëse rastësisht e lëndonim gjatë punës, na dilte më së mbrami njëfarë tufaku. Prandaj, çdo punë që bëhet shpejtë, ka rrezik që në fund të na del me ndonjëfarë tufaku, sepse ju e dini që ne edhe më herët i kemi pasur njerëz tanë në kuvendet e mëhershme, do me thënë kanë qenë shqiptarë, por kanë bërë disa gabime dhe na ka dalë me tufak. Prandaj, kisha lutur deputetë që, për hir të procesit, për hir të përshpejtimit të procesit të statusit të Kosovës, ndoshta ne duhet ta aprovojmë këtë, por që mund të na dalë tufak, ta dimë dhe po e dimë të gjithë. Ju faleminderit!

KRYTARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Është përmendur disa here këtu plani i Ahtisarit, janë përmendur edhe disa çështje të tjera. Ka ekzistuar një arsye pse Kuvendi i Kosovës e ka pranuar atëherë propozimin e Presidentit Ahtisari, më duket me një votë kundër. Ai pranim ka qenë një premtim i Kuvendit të Kosovës. Realisht, kur është premtim i Kuvendit të Kosovës, është premtim i Kosovës, se e bën një marrëveshje me të gjithë ata që e mbështesin pavarësinë e Kosovës realisht, në mënyrë që atë premtim ta mbajë. Gjithmonë, kur jepet një premtim për t'u mbajtur, në vetvete, do të thotë implicit e përmban edhe një element të kohës se deri kur pritet që të mbahet ai premtim. Nuk mundet Kosova të premtoj se do ta bëjmë një ditë. Askush nuk mund të bëjë premtim, i cili nuk e ka në vetvete edhe një element kohor. Ekzakt, është koha që ne të tregojmë pse premtimin që e kemi dhënë si Kosovë, jo vetëm si Kuvend i Kosovës, do ta mbajmë. Të gjithë e dimë që ka elemente, të cilat në rrethanat të tjera, ndoshta nuk do të na kishin pëlqyer, elemente të cilat në rrethana të tjera nuk do t'i kishim bërë.

Mirëpo, në rrethana të tjera Kuvendi i Kosovës do ta kishte ratifikuar një marrëveshje të tillë dhe do të ishte obliguar atëherë. Ekziston edhe një çështje tjetër, që Kuvendi i Kosovës nuk mund të ratifikojë sot marrëveshje të tilla dhe ajo çka po bëjmë ne, është që ta përshpejtojmë gjithë punën në mënyrë që shumë shpejtë, brenda javësh Kuvendi i Kosovës të mund të ratifikojë marrëveshje. Do të thotë, ne po e elevojmë Kosovën në një gjendje tjetër, në të cilën sot nuk është. Për ta arritur këtë, është dashur që detyrimisht të bëjmë kompromise gjatë rrugës, kemi bërë kompromise dhe besoj se sot ne duhet të tregojmë se, jo vetëm që kemi premtuar, por një ditë do ta bëjmë këtë që po e bëjmë sot, por do ta bëjmë atëherë, kur të gjithë ata që na kanë mbështetur, do t'ju duket se është e rëndësishme, do të jepet një mesazh i tillë. Më duket se ka pasur problem edhe me fjalën: "formal" në tekstin i cili është propozuar nga shefat e grupeve parlamentare. Mund t'ju them se, nëse shikohet fjala: "formal", atëherë "formal" do të thotë në bazë të formave dhe të rregullave. Ndoshta kishte mund të ishte edhe fjala "joformal", atëherë do të kishte qenë shumë më keq. Ndoshta nuk ka pasur nevojë fare që të jetë fjala: "formal" aty, do të thotë që Kuvendi t'i votojë ato ligje më tutje, mirëpo fjala: "formal" nuk do të thotë në kuptimin të cilin shumë shpesh jemi mësuar që ta dëgjojmë vetëm sa

për sy e faqe. Në fund të fundit, Kuvendi do të votojë për ato ligje. Mirëpo, ne çka po bëjmë? Vetëm po e mbajmë premtimin që e kemi dhënë si Kosovë dhe po tregojmë se nuk kemi dilema se a do ta mbajmë atë premtim apo jo. Ju faleminderit!

KRYETARI: Është interesant, diskutimi po e nxitë diskutimin. Për fjalë është paraqitur Behxhet Pacolli.

BEHXHET PACOLLI: I nderuari Kryetar,

Të nderuar kolegë,

Më duket që po humbim kohë. Më vjen keq që dr. Smaka e bëri një propozim me vend dhe e shfrytëzoi kohën e rëndësishme prej dy minutash. Për komentet që u bënë rreth propozimit të tij, u shpenzuan 10 minuta të tjerë. Ne po humbim kohë. Ne na ka zgjedhur shoqëria kosovare që të punojmë, e jo të bëjmë komente pa vend.

Pakoja e Ahtisarit, gjegjësisht propozimi i Ahtisarit është akceptuar nga populli i Kosovës dhe, si të tillë, shefat e grupeve parlamentare kanë nënshkruar një dokument dhe janë dakord që të formohet Komisioni ad-hoc. Ne jemi dakord. Aleanca Kosova e Re do ta përkrahë çdo propozim që ndihmon procesin deri te pavarësia e Kosovës. Ne propozojmë të shkojmë përpara dhe besoj se këto diskutime që po bëhen, është mirë që të diskutohen në seli të partive të juaja. I keni zgjedhur grupet, shefat e grupeve parlamentare që duhet t'i konsultoni.

Ne, para se të vijmë në këtë Kuvend, kemi biseduar, jemi mbledhur, kemi akorduar dhe jemi në dakord për këtë Komision ad-hoc, prandaj mos të humbim kohë, ju lutem, se qytetari është duke shikuar tani, dhe qytetari prej nesh kërkon përgjegjësi, kërkon rezultate. Të shkojmë në punë konkrete, të shkojmë drejtpërsëdrejti me shfrytëzimin e kohës në mënyrë racionale. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Për fjalë është lajmëruar Gjylnaze Syla

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar anëtar të Kabinetit qeveritar,

Kolegë të nderuar,

Unë e kuptoj tërësisht shqetësimin e deputetëve më tepër lidhur me përmbajtjen e ligjeve dhe ndikimin e tyre në përmbajtjen e ligjeve, se sa me vetë ndryshimin ose shmangien nga rregulla ose rregullat normale të punës për ligjet.

Megjithatë, janë dy mënyra të punës: njëra ka qenë brenda atyre grupeve punuese dhe, tjetra, tash koha është shumë e shkurtër prej 24 orëve, që influencën e tyre deputetët ta shtrojnë brenda përfaqësuesit ose përmes përfaqësuesit të tyre në këtë grup ad-hoc, ose komisionin ad-hoc që do të formohet.

Unë e mora fjalën për ta kujtuar Kuvendin se me votimin e Pakos së Ahtisarit e kemi marrë përgjegjësinë për zbatimin e atij propozimi gjithëpërfshirës si dhe të ligjeve, të cilat dalin pastaj nga ai propozim.

Zoti kryetar,

Unë Ju ftoj që tani ta filloni votimin lidhur me këtë shqyrtim të mocionit të grupeve parlamentare. Ju faleminderit!

KRYTARI: Faleminderit, deputete! Fjalën e ka deputeti Ali Lajçi.

ALI LAJÇI: I nderuari Kryetar,

Deputetë dhe i gjithë stafi i Ministrisë atje me Qeverinë, dhe zëvendësministrat, kryeministri, etj.,

Ne jemi disa deputetë të rinj dhe këtu kemi përcjellë procesin politik në tërësi gjatë gjithë kohës dhe ne duhet të shikojmë këto procedura esencialisht. Ne jemi që ajo të mund të ecën sa më shpejtë, por nuk jemi që të ndryshohet përmbajtja, metodologjia e punës dhe procedurat të cilat japin shans dhe mundësi që deputetët të jenë dinjitoz në kuptim të shikimit të ligjeve, të vërejtjeve, që unë mendoj se ka mjaft çka të thuhet, sidomos kur jemi në këta dy kapitujt. Plani i Ahtisarit, që është një plan i ditur dhe hyn në procesin e bërjes së shtetit, kurse ne duhet ta bëjmë një kapitull gjithnjë të ri, ndoshta bashkë me te, por të shohim çka është adapte në te, e çka jo. Ne do të shikojmë, ne do ta shpallim shtetin e pavarur demokratik të Kosovës, por jo pjesën e saj ku definojnë pozitën juridike të planit të Ahtisarit, i cili thotë se Kosova është bashkësi etnike, e tjera. Prandaj, në frymën e kësaj, ne duhet që...

(Ndërhyrje e Kryetarit: Në rend dite e kemi mocionin, ju lutem.)

..OK. Ne këto do t'i lidhim me ligje, prandaj ligjet të cilat vijnë në kapituj të veçantë që mund të adaptohen në një kushtetutë të re, ne duhet t'i lexojmë mirë, t'i rilexojmë, të kemi afate kohore të mjaftueshme që ne në këtë mënyrë të japim vërtetë ...

(Regjia ndërpret diskutimin)

KRYETARI: Ju faleminderit!

Unë kam për obligim t'i jap dy njoftime të reja, një që deputetja e propozuar nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, Selviye Halimi, zëvendësohet me deputetin Ramadan Gashi, dhe lus Grupin e SLS-së që ta japë kandidatin për Komisionin ad-hoc.

Fjalën e ka Bojan Stojanović

BOJAN STOJANOVIĆ: Poštovani gospodine predsjedniče,

Poštovano gospodo poslanici,

Uvežana gospodo vladinog kabineta,

Ja nisam želeo da uzmem reč u ovoj diskusiji da ne bih trošio vreme. Mi smo na Poslaničkom klubu razmatrali ovo. Ja sam bio prisutan kada su šefovi poslaničkih grupa razmatrali ovo pitanje. Znači, i mi smo odlučili da u ovom slučaju budemo uzdržani, s obzirom da u celoj proceduri koja se dešavala oko donošenja zakona iz paketa ili plana, kako god da ga nazovemo, mi nismo učestvovali. Mi smo u novom sazivu Skupštine sada, ali bi ujedno hteo da zadržim pravo da eventualno, naknadno delegiramo člana u ovoj komisiji. S obzirom da nikakve materijale nemamo vezano ni za zakone, ni za Nacrt ustava, mi trenutno nismo u mogućnosti da prihvatimo tako neto. Znači, u slučaju ove Komisije mi ostajemo uzdržani. Hvala vam!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Vendi i juaj është i hapur. Lus deputetët dhe regjinë që të përgatitemi të votojmë për miratimin e mocionit së bashku me përbërjen e komisionit dhe me ndryshimet që i thashë. Votojmë, tash!

Kush është “për”?

Konstatohet se 79 deputetë kanë votuar “për”, me kartelë dhe 1 ka votuar me ngritjen e dorës, pra gjithsej 80 deputetë kanë votuar “për”, 4 kanë abstenuar dhe 6 janë “kundër”. Konsiderojmë se Mocioni u miratua. Do të thotë, Kuvendi miratoi propozimin për shmangie nga Rregullorja e Punës së Kuvendit, Rregulla 61, me rastin e procedimit, të shqyrtimit dhe të miratimit të ligjeve nga Pakoja e Ahtisarit, si dhe propozimin për emërimin e Komisionit ad-hoc.

Pikën e katërt e kemi kaluar për më vonë, kështu që kalojmë në pikën e pestë:

**- Shqyrtimi i propozimit të Grupit Parlamentar të AAK-së për zgjedhjen e Naim Malokut anëtar të Kryesisë të Kuvendit të Kosovës**

Me propozimin e Kuvendit nga Seanca plenare e 31 janarit 2008, dhe me miratimin e PSSP-së, është bërë amendimi i Kornizës Kushtetuese lidhur me numrin e anëtarëve të Kryesisë së Kuvendit.

Në pajtim me këtë, Partia parlamentare e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, ka propozuar deputetin Naim Maloku për anëtar të Kryesisë.

Ndryshimi i Kornizës kushtetuese dhe propozimi i AAK-së, u është shpërndarë deputetëve.

Lus deputetët dhe regjinë që të përgatiten për votim, ose të bëjmë votim formal.

Kush është “Për”?

Ju faleminderit!

A është kush “kundër”? Nuk është. Shumica absolute, do të thotë miratohet propozimi për emërtimin e deputetit Naim Maloku për anëtar të Kryesisë së Kuvendit.

Pika gjashtë e rendit të ditës:

**- Shqyrtimi i propozimit të Kryeministrit për emërimin e zëvendësministrave**

Në pajtim Rregullën 18, pika 3 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Rregulloren për Degën e Ekzekutivit, Kryeministri i Kosovës, zoti Hashim Thaçi, ka propozuar emërtimin e zëvendësministrave. Propozimi u është shpërndarë deputetëve. Ftoj zëvendësministrin, zotin Kuçi, që ta arsyetojë propozimin.

HAJREDIN KUÇI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,  
Anëtarë të Qeverisë së Kosovës,

Në bazë të Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2001/19 të datës 13 shtator 2001 për Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Kosovës, të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut, nr. 2005/15, neni 1.2.1, Kryeministri i Kosovës i propozon Kuvendit të Kosovës këta kandidatë për zëvendësministra:

1. z. Sasha Rashiq, për zëvendësministër në Ministrinë e Punëve të Brendshme, nga Partia Liberale Serbe,
2. z. Usmen Baldazhi, zëvendësministër në Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë nga koalicioni VAKAT, dhe
3. z. Raif Elezi, zëvendësministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, po ashtu nga koalicioni VAKAT

Lusim Kuvendin e Kosovës që për hir të funksionimit të plotë të Qeverisë së Kosovës dhe të prezantimit të komuniteteve në mënyrë adekuate në qeverinë e Kosovës, t'i aprovojë këto propozime.

**KRYETARI:** Ju faleminderit, zoti zëvendëskryeministër!

Njoftoj deputetët se propozimi i katërt që e keni në material, është tërhequr, do të thotë, sot votojmë vetëm për 3 anëtarët që i lexoi zëvendëskryeministri.

Për miratimin e propozimit kërkohen shumica e votave të deputetëve të Kuvendit, 61 vota “për”.

Lus deputetët dhe regjinë që të përgatiten për votim.

Votojmë tash:

81 deputetë kanë votuar “për”, 16 “kundër” dhe 3 abstenime.

Konstatohet se miratohet propozimi për emërimin e zëvendësministrave: Usmen Baldazhi, Sasha Rashiq dhe Raif Elezi.

Pika e shtatë e rendit të ditës:

**- Shqyrtimi i propozimit të Grupit Parlamentar të SLS-së për zgjedhjen e dy anëtarëve në komisionet parlamentare**

Në seancën plenare të mbajtur me 31 janar 2008, është miratuar propozimi për emërimin e kryetarëve, të zëvendëskryetarëve dhe anëtarëve të komisioneve parlamentare, me përjashtim të anëtarit nga radha e Grupit Parlamentar të SLS-së në Komisionin për Arsim, Shkencë, Kulturë, Rini e Sport, dhe në Komisionin për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit, e jo në Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, siç kemi theksuar në seancën e kaluar.

Ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të të SLS-së, Bojan Stojanović, që t'i propozojë emrat e dy anëtarëve të ri për komisionet e cekura.

BOJAN STOJANOVIĆ: Poštovani gospodine predsjedniče, hatero sam da skrenem pažnju na ime stranke Samostalna liberalna stranka, znači ne smatram da je bilo nikakve namere, ali pojedini poslanici kod izgovaranja imena Poslaničkog kluba, kažu Srpska liberalna stranka, mi smo Samostalna liberalna stranka. Normalno, sa zadovoljstvom predstavljamo Srpsku zajednicu u Parlamentu Kosova, ali da skrenem pažnju na to.

Što se tiče ove sedme tačke dnevnog reda, kao i prošlog puta kada je došlo do nemogućnosti formiranja svih komisija, ja mislim da se u izmedju dva plenarna zasedanja ništa novo nije desilo. Znači, našli smo se u problemu koji nije direktno vezan za Samostalnu liberalnu stranku, već za mandate stranke koja je koalicioni partner u Poslaničkom klubu Samostalne liberalne stranke.

Nažalost, mi smo uputili sve dopise gospodinu Rueckeru, OESC-eu kao i vama, na konsultaciju, i nismo uspeli da prevaziđemo taj problem, da jasno definišemo ko ima pravo na taj mandat. U medjuvremenu se čak i Ministarstvo unutrašnjih poslova uključilo u ceo slučaj, znači da je slučaj došao i do policije, došlo je do prijave od strane gospodina Dragana Dimića za zloupotrebu i falsifikovanje njegovog potpisa i ovlašćenja, tako da vas molim da ove dve komisije ostavimo za neko drugo zasedanje, gde ćemo blagovremeno, kada se to bude rešilo, obavestiti Predsedništvo Skupštine da stavi tu tačku na dnevni red. Hvala vam!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Pas diskutimit të kryetarit të Grupit SLS, duhet të konstatohet se:

1.Emërimi i anëtarëve të Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, është bërë në Seancën plenare me 31 janar 2008, ndërsa,

2.Emërimi i përfaqësuesve të Grupit Parlamentar të SLS-së, në Komisionin për Arsim, Shkencë, Kulturë, Rini e Sport dhe në Komisionin për Mandate, Imunitete dhe Rregullores së Punës së Kuvendit, do të bëhet pas zgjedhjes së statusit të kontestuar të deputetit Dragan Dimić.

Mendoj se duhet ta bëjmë edhe një votim, se ju e dini se në seancën e kaluar nuk kemi votuar për Komisionin për Komunitete dhe Kthim, do të thotë është bërë një gabim dhe sot duhet të votojmë për këtë Komision.

Lus deputetët që me ngritje dore që ta miratojmë këtë.

Ju faleminderit!

Shumica absolute.

A ka "kundër"?

Nuk ka.

Konsideroj se edhe kjo pikë e rendit të ditës u miratua.

Ju njoftoj se deri në orën 14,00 do të kemi pauzë.

**Vazhdimi i punës së seancës plenare pas pauzës, në orën 14,00**

KRYETARI: Të nderuar deputetë,  
I nderuar Kryeministër dhe Kabinet qeveritar,

Ju njoftojmë se keni marrë rezultatin e votimit elektronik dhe prej ditës së sotme votimi do të jetë transparent për ju dhe do të publikohet në Ueb-faqen e Kuvendit.

Tani do të vazhdojmë me procedimin e pikës së katërt, nga agjenda e para ditës, me konstatim se në seancë janë të pranishëm 100 deputetë.

Rendi i ditës është ky :

- **Shqyrtimi i propozimit për shmangien e afateve nga Rregullorja e Punës së Kuvendit për shqyrtimin dhe miratimin e Projektligjit për Buxhetin e Kosovës për vitin 2008, si dhe procedimi i tij**

Me kërkesë të Kryeministrit të Kosovës, në pajtim me Rregullën 61 të Rregullores së Punës të Kuvendit, propozohet që të bëhet shmangie nga afatet procedurale me rastin e shqyrtimit dhe të miratimit të Buxhetit të Kosovës për vitin 2008.

Ju njoftoj se kërkesa e Kryeministrit të Kosovës është përkrahur në mbledhjen konsultative të Kryesisë me kryetarët e grupeve parlamentare dhe se e ajo iu është shpërndarë deputetëve.

Ju njoftoj se për miratimin e këtij propozimi janë të nevojshme votat e dy të tretave të deputetëve të pranishëm në seancën plenare.

Ftoj zëvendëskryeministrin, zotin Kuçi, që të arsyetojë këtë kërkesë të Qeverisë.

HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuari Kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

Kryeministri i Kosovës, duke pasur parasysh se Buxheti i Konsoliduar i Kosovës nuk është miratuar në afatin e paraparë dhe duke pasur parasysh se për shkak të ndryshimit të legjislaturës miratimi i Projektbuxhetit më herët ka qenë i pamundur dhe duke marrë parasysh se në bazë të nenit 21 të Ligjit për menaxhimin e financave publike, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-ës në Kosovë, zoti Ruecker ka nënshkruar një udhëzim administrativ për shfrytëzimin e buxhetit dhe të shpenzimeve për periudhën janar-shkurt të vitit 2008, kemi marrë parasysh se ndërkohë kemi bërë

rishikimin e buxhetit. Kemi miratuar rishikimin e buxhetit në Qeverinë e Kosovës dhe në Këshillin Ekonomik Fiskal më datën 7 shkurt, ndërsa shpenzimet për buxhetin në këtë vit, nga udhëzimi administrativ i përmendur, janë të lejuara vetëm deri me datën 29 shkurt të këtij viti. Pra, kemi konsideruar që Kuvendi i Kosovës ka nevojë ta shqyrtojë këtë çështje në mënyrë urgjente dhe kemi kërkuar që Kuvendi i Kosovës ta vë në rend dite. Njëkohësisht, ju lusim të keni mirëkuptimin tuaj që ta shqyrtoni këtë projektligj sipas procedurës së përshpejtuar, në mënyrë që nga data 1 mars i këtij viti të fillojmë me shfrytëzimin e Buxhetit të Kosovës sipas asaj që miratohet në Kuvendin e Kosovës.

Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Kuçi! Në radhë janë shefat e grupeve parlamentare, nëse kanë nevojë. Sipas radhës është shefi i Grupit Parlamentar i Partisë Demokratike, Ramë Buja.

RAMË BUJA: I nderuar, zoti Kryetar,  
I nderuar zoti Kryeministër me Kabinet qeveritar dhe ju të nderuar deputetë,

E dimë se koha ka qenë e shpejtë për të analizuar dhe përimtuar këtë projektligj për buxhetin, por megjithatë ne si Grup Parlamentar e kemi shfrytëzuar racionalisht kohën dhe i kemi përpunuar mirë, konsideroj, dhe ato gjëra të cilat nuk i kemi pasur mirë të qartësuar, na i kanë qartësuar disa anëtarë të Komisionit për Buxhet dhe Financa, kështu që ne e përkrahim në tërësi edhe përshpejtimin, por edhe buxhetin si tërësi.

Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Ramë Buja! Sipas radhës, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, Haki Shatri.

HAKI SHATRI: Faleminderit, zoti Kryetar i Kuvendit!

Të nderuar të pranishëm,  
Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka marrë letrën e Kryeministrit, me kërkesë të përshpejtimit të afateve për miratimin e Projektbuxhetit për vitin 2008. Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës konsideron se kërkesa është e arsyeshme dhe është i përgatitur që brenda afateve kohore që ka kërkuar Kryeministri të japë kontributin e vet në miratimin e këtij dokumenti shumë të rëndësishëm për institucionet dhe për Kosovën. Arsye e përkrahjes së kësaj kërkesë është që Buxheti i Konsoliduar i Kosovës është dokumenti më i rëndësishëm vjetor që miraton Kuvendi i Kosovës.

Arsye tjetër janë momenti aktual politik dhe disa çështje që duhet, patjetër, të ndryshohen në dokumentin e miratuar nga Qeveria dhe të proceduar për miratim. Edhe si anëtar i Komisionit për Buxhet konsideroj të arsyeshme të them se kemi bërë përgatitjet që procedimi i këtij ligji mund të bëhet. Jemi të gatshëm ta japim kontributin tonë aty ku duhet ta japim patjetër.

Kam dy kërkesa shtesë. Ndoshta është harruar që buxhetet e dy agjencive të pavarura – Rregullatorit të Energjisë dhe Agjencisë të Rregullatorit të Telekomunikacionit, të cilat

janë përgatitur nga Komisioni për Buxhet, duhet të potencohen që miratohen ose si pika të veçanta ose përnjëherë me Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës. Sepse, në pika të skajshme, ato shifra do të jenë pjesë përbërëse të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës. Dhe një që duket pak largpamëse, meqenëse kam një përvojë në punë të buxhetit, kërkoj që strukturat përgjegjëse me rastin e vendimit për shpalljen e periudhës së zgjedhjeve, të kenë parasysh periudhën e miratimit të buxhetit të Kosovës sepse, nëse ndodhë që t'i shpallim zgjedhjet në nëntor, gjithmonë do të kemi problem për miratimin e buxhetit të Kosovës dhe në vonesën në miratimin e tij, gjë që sjell shumë probleme dhe pengesa. Faleminderit shumë!

**KRYETARI:** Faleminderit! Fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli.

**BEHGJET PACOLLI:** I nderuar Kryeministër,

I nderuari Kryetar,

Kolegë, ministra,

Sot është Dita e Flamurit të ashkalinjve dhe kisha shfrytëzuar rastin t'ua uroj Ditën e Flamurit.

(Duartrokitje)

Ditët e fundit kam marrë një dokumentacion, sikurse edhe kolegët e tjerë, ku kërkohet të miratohet Buxheti i Kosovës. Besoni, unë jam edhe dje thashë, tejet i zhgënjyer që kam pasur atë dokumentacion në dorë dhe ta studioj. Është shumë i pakuptueshëm dhe tash kritika nuk di kujt t'i bëhet, a Qeverisë së përparshme, apo Qeverisë aktuale. Por, sidoqoftë, nuk bëhet një kërkesë për miratim me atë dokumentacion që ju na e keni dhënë ne. Ai është shumë i pakuptueshëm, nuk i ka tri shtylla. Duhet të ketë një shtyllë për vitin 2006, bile të ketë një shifër sa ai institucion, përkatësisht ajo komunë ka pasur në buxhet për vitin e kaluar 2007 dhe si është shfrytëzuar ai? Çka ka mbetur pa u shfrytëzuar dhe kërkesat, që të shihen diferencat. Asnjë informatë nuk është treguar, prandaj, është shumë i komplikuar dhe nuk di si ta miratojmë. Po më duket, ju po ia bëni, siç thotë një fjalë popullore "Miu e ka mësuar rrugën dhe tash duhet t' i grahët gjithmonë". Ju po kërkon që nesh të miratojmë dokumentacionin pa e parë, pa ditur çka ka brenda, çka përmban. Nuk është në rregull, sepse kemi një përgjegjësi ndaj qytetarit të Kosovës, prandaj ju lutem, që në të ardhmen të keni kujdes.

Buxheti juaj nuk paraqet ato premtime që Qeveria i ka bërë. Ky buxhet asnjëherë nuk do të mund të shfrytëzohet për ato premtime që ju, zoti Kryeministër i keni bërë. Programin e juaj qeveritar nuk na e keni prezantuar, ne nuk e dimë se çfarë programi është ai, keni premtuar se do të na sillni një program qeveritar, por deri më sot nuk e kemi atë program. Nuk di çka do të bëni në të ardhmen dhe ne duhet sot të miratojmë Buxhetin e Kosovës, por nuk di në çfarë baze ta miratojmë atë.

Gjatë studimit të Projektbuxhetit kam hasur në disa anomali. Ju keni rritur buxhetin për 33 komuna të Kosovës vetëm për 14 milionë, kurse në anën tjetër keni rritur Buxhetin e Kosovës për qendrën, do të thotë diku për 440 milionë. Nuk di çfarë zhvillimi do të keni

ju në tërë Kosovën me një rritje të buxhetit në krahasim me vitin e kaluar prej 14 milionëve. Ato janë shumë pak. Dhe çka do të bëni ju me 440 milionë që i keni ndarë nëpër ministri, përkatësisht nëpër organizatat qeveritare dhe joqeveritare.

Unë dua t'ju them sot atë që kam parë se ky buxhet dedikohet për paga – mëditje, shpenzime të udhëtimeve. Shumë pak për arsim, atë që ju e keni premtuar gjithmonë. Shumë pak për shëndetësi, shumë pak për kulturë, rini dhe fusha të tjera të jetës. Keni rritur buxhetin për AKM-në, për Ministrinë e Financave, për Ministrinë e Telekomunikacionit. Besoj se keni paraparë, edhe pse s'kemi parë asnjë dokument, se do të ndërtoni rrugë – autostrada - që keni premtuar. Prandaj, ne edhe kësaj radhe do të votojmë për buxhetin e Kosovës, por të keni kujdes, në të ardhmen që të na i sillni dokumentet dhe të shohim çka po votojmë, për arsye se edhe ne do të jemi përgjegjës para qytetarit të Kosovës, i cili na e ka dhënë votën që ne të mbrojmë interesat e qytetarit të Kosovës.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Pacolli! Fjalën e ka shefi i AAK-së, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Zoti Kryeministër,

Deputetë të nderuar të Kuvendit të Kosovës,

Ne, në Grupin Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës mendojmë se sot është një kohë në të cilën shumëkush pret diçka tjetër. Të gjithë jemi duke pritur diçka tjetër. Është njëfarë atmosfere në të cilën edhe bisedat e gjata rreth buxhetit dhe të tjerat, ndoshta e japin një shije pak më ndryshe në opinion, i cili e përcjell Kuvendin e Kosovës. Sidoqoftë, buxheti është diçka me të cilën duhet të jetojmë një kohë të gjatë. Pas miratimit të buxhetit, Qeveria duhet të punojë me atë buxhet. Ne mendojmë se nuk është e domosdoshme, në të njëjtën kohë, nuk është as në rregull që buxheti të kalojë me një lexim, do të thotë të kalojë shpejtë. E kuptojmë nevojën që të përshpejtohet kjo procedurë dhe besojmë se duhet të përshpejtohet. Mirëpo, mendojmë se prapëseprapë duhet t'i japim vetes kohë që pak më gjatë ta lexojmë dhe ta shqyrtojmë buxhetin e Kosovës. Për aq sa kemi mundur deri me tani, kemi parë defekte në këtë buxhet. E dimë që buxheti nuk bazohet në një program qeverisës. Nuk e kemi marrë atë program qeverisës. Nuk e dimë cili është programi. Në të njëjtën kohë, besojmë se ka disa ndryshime në buxhet, të cilat nuk shkojnë në të njëjtën vijë me ato që thuhën vazhdimisht. Shembull, ta marrim, ulen shpenzimet, ndërsa në tjetrën kohë rritet buxheti për mallra dhe shpenzime. Kjo është diçka e pakuptueshme për ne, kështu që kërkojmë nga Kuvendi i Kosovës që t'i japë vetes kohë, disa ditë të paktën, që ta shqyrtojë buxhetin edhe një herë, që t'i ketë dy lexime. Ne nuk do të votojmë që buxheti të kalojë vetëm me një lexim.

Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk është çështja e dy leximeve. Është çështja e shkurtimit të procedurave. Do të jenë dy lexime, në dy seanca që do të mbahen sot njëra pas tjetrës. Fjalën e ka Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Zoti Kryetar! Mendoj se jeni duke folur për procedurë të përshpejtimin dhe jo tash për një qasje të përgjithshme të debatit për buxhet. Por, sa i përket procedurës së përshpejtimin, Grupi Parlamentar i LDD-së atë e akcepton dhe konsideron se është konform nevojës dhe domosdoshmërisë së procesit nëpër të cilin po kalojmë.  
Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Zeneli! Fjalën e ka shefi i Grupit të SLS-së, Bojan Stojanović. Më falni, në vend të Bojanit, Slobodan Petrović.

SLOBODAN PETROVIĆ: Poštovani predsedniče, predsedniče Vlade, ministri, narodni poslanici,  
Gospodin Stojanović je upravo na konsultacijama sa ljudima iz OSCE-a i UNMIK-a upravo na ovu temu, ali da se malo našaljim, idemo u duhu što bržeg procesa, toliko je brz da nismo ni videli budžet koji je na temi, ali svakako, ukoliko je to predlog Vlade, to će biti... strana.

KRYETARI: Faleminderit! Nga Grupi “7+”, është paraqitur Xhezair Murati.

DŽEZAIR MURATI: Poštovani predsedniče, gospodine predsedniče Vlade, zamenici Premijera, gospodo ministri i kolege poslanici,  
Polazeći od toga da je nova Vlada bila suočena sa vremenskim cajtnotom, sa nedovoljno vremena, ja mislim da naša Parlamentarna grupa, u principu, je zadovoljna ovakvom analizom i predlogom Nacrta budžeta za ovu godinu, tako da i mi u Parlamentarnoj grupi u okviru raspoloživog vremena koje smo imali takodje nećemo se baviti danas detaljima. U principu prihvatamo Predlog nacrta budžeta iz razloga koji su pomenuli već prethodni govornici, s obzirom na to da imamo i sugestije Specijalnog predstavnika i da to moramo da uradimo u najkraćem vremenu.

Rukovodeći se upravo vremenskim ograničenjima, ja bih rekao da imamo načelnih primedaba u raspodeli budžeta u nekim ministarstvima i ja bih, pre svega, ovde spomenuo Ministarstvo za zajednice i povratak. Mislim da ono polako dobija jedan loš prizvuk da ga svi smatraju ministarstvom jedne zajednice. Ono je Ministarstvo svih nevećinskih zajednica i raspodela budžeta u to ministarstvo trebaće malo više vremena, odnosno prostora i finansija da posveti i ostalim zajednicama. Imamo odredjenih primedaba, kažem načelnih, i o raspodeli sredstava u nekim ministarstvima, ali ćemo, pošto su tu ministri, iskoristiti priliku na konstruktivan način da sednemo sa ministrom za saobraćaj i telekomunikacije u jednoj prilici, sa ministrom zdravlja, sa ministrom obrazovanja, ministrom za kulturu pa ćemo onda sigurno izneti te naše primedbe ili sugestije.

I sasvim na kraju, mi u načelu podržavamo predloženi Nacrt budžeta, želeći da on bude na najbolji način iskorišćen u godini u kojoj se nalazimo. Hvala vam!

KRYETARI: Faleminderit Xhezair! Tani mund ta marrin fjalën deputetët, sipas radhës. E ka fjalën Gjylnaze Syla. Më fal Gjylnaze, fjalën e ka kryetari i Komisionit, zoti Gani Koci.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuari, zoti Kryeministër, zëvendëskryeministra dhe anëtarë të Kabinetit qeveritar, Të nderuar deputetë,

Ne, si Komision për Buxhet dhe Financa i Kuvendit të Kosovës, pasi që morëm draftin e rishikuar të buxhetit, kemi filluar një punë shumë intensive. Po ju them sinqerisht, kemi punuar, e kam thënë edhe në Komision, në mënyrën turbo në mënyrë që seanca për miratimin e buxhetit të mos na gjejë të papërgatitur. Me këtë rast dua t'i falënderoj të gjithë anëtarët e Komisionit për angazhimin e tyre, për konstruktivitetin e tyre gjatë këtyre punëve dhe ne si Komision kemi ardhur...

KRYETARI: Gani, të lutem, Jemi duke folur vetëm për procedurë. Ende nuk kemi filluar për buxhetin.

GANI KOCI: Ne si Komision kemi ardhur në përfundim, duke pasur parasysht kërkesën e Qeverisë, përkatësisht të Kryeministrit për procedura të përshpejtuara për miratimin e buxhetit dhe konkluzioni i Komisionit është ky:

Komisioni ka shqyrtuar paraprakisht dhe ka amenduar Projektligjin për buxhet dhe autorizimin e shpenzimeve prej 1 janarit 2008 deri më 31 dhjetor 2008. Është një gabim në tekstin, është 21 dhjetor, por duhet të jetë 31 dhjetor, dhe Komisioni për Buxhet është i gatshëm të veprojë sipas vendimit që do të marrë Kuvendi mbi bazë të kërkesës së shtruar nga Qeveria e Kosovës. Dua, paraprakisht, t'ju them, i kam thënë edhe zotit Pacolli në Komision, ne draft buxhetin e kemi marrë më 9 nëntor 2007 nga struktura e kaluar qeveritare. Duke pasur parasysht kohën e Qeverisë së re në rishikim të buxhetit, Qeveria e re nuk ka bërë projekt të ri të buxhetimit, por ka rishikuar dhe ka ripozicionuar, të them ashtu, vlera të caktuara me ndryshime shumë të vogla. Nuk qëndron aspak arsyeja se ne nuk e kemi pasur draft buxhetin në dorë dhe s'kemi pasur mundësi që të shikojmë atë ose të japim vërejtje në të. Çështja është kjo që, Komisioni për Buxhet është i gatshëm ta miratojë me një seancë, me dy seanca, brenda një dite të përshpejtuar, varësisht nga vendimet e Kuvendit.

KRYETARI: Faleminderit! Kam një sqarim për Ganiun dhe për të tjerët. Aleanca Kosova e Re nuk ka qenë në mandatin e kaluar, prandaj nuk e kanë pasur atë Projektligj për buxhetin e vitit 2008.

Sipas radhës, fjalën e ka Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar zoti Kryetar, zoti Kryeministër, anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Proceduralisht kërkesa nuk ka shkuar në rregull për arsye se Kryeministri nuk mund t'ia kërkojë Kuvendit kërkesën për shqyrtim dhe miratim të buxhetit, por kjo shkon përmes grupit parlamentar. Kjo është e para.

E dyta. Kur shtrohet një çështje urgjente, sipas Rregullës 29, arsyetohet urgjenca e asaj rregulle dhe unë kërkoj nga Kryeministri që para Kuvendit ta arsyetojë urgjencën. Sepse, dihet se vonesa, në të vërtetë, ka ngjarë për shkak se është vonuar konstituimi i Kuvendit si dhe formimi, përkatësisht zgjedhja e Qeverisë. Prandaj, zoti Kryeministër, a mund ta arsyetoni kërkesën për urgjencën e buxhetit?  
Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka Sabit Rrahmani.

SABIT RRAHMANI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!  
I nderuari Kryeministër,

Unë flas në emër të tre deputetëve të Partisë Demokratike të Ashkalinjve të Kosovës, të cilët e përkrahin kërkesën e Kryeministrit për miratimin e Projektligjit për buxhetin 2008. Njëkohësisht shfrytëzoj rastin ta përshëndes zotin Behgjet Pacolli, i cili na uroj festën kombëtare. Në të ardhmen, dhashtë zoti që ashkalinjtë të kenë arsye për dy festa – në muajin shkurt- Ditën e Flamurit Kombëtar dhe të Pavarësisë, që do ta shpallim tash.  
Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka Kryeministri, zoti Thaçi. Më falni, fjalën e ka zëvendëskryeministri, zoti Kuçi.

HAJREDIN KUÇI: Ne i kemi ndarë punët. Në pyetjet e vështira përgjigjet Kryeministri, të lehtat unë.

Zonja Gjylnaze Syla e bëri me të drejtë pyetjen. Besoj që në fillim tentuam ta japim një sqarim shkurtimisht. Ju e keni parë në letër që ne i jemi drejtuar Kryetarit të Kuvendit dhe ai e ka gjetur mënyrën si të procedohet. Besoj se e ka diskutuar në Kryesinë e Kuvendit dhe më pastaj e ka vënë këtu. Obligimi ynë, do të thotë, ka qenë t'i drejtohem Kryetarit të Kuvendit.

E dyta, besoj se u tha në fillim. Për shkak të asaj që Udhëzimi Administrativ i zotit Ruecker vlen që shpenzimet e buxhetit mund të bëhen deri më 29 shkurt dhe nga 1 marsi ose duhet ta kemi buxhetin e konsoliduar të Kosovës të miratuar nga Kuvendi, ose një urdhëresë tjetër administrative. Pra, me qëllim që ky Kuvend të ushtrojë autoritetin e vet dhe të miratohet buxheti në Kuvendin e Kosovës, kemi menduar se është urgjencë, është në kuptimin e përshpejtuar. Po e them shumë hapur, në ditët në vijim, zhvillimet që do të jenë, me siguri që do të jemi më pak të koncentruar në buxhetin e Kosovës, më shumë në punë tjera.  
Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti zëvendëskryeministër! Lus deputetët dhe regjinë që të përgatiten për votim për shmangien nga Rregullorja e Punës.

(Ndërprerje e shkurtër)

Po ishte e qartë, sepse deri më tash folëm për shqyrtimin e Propozimit për shmangien e afateve nga Rregullorja e Punës së Kuvendit për shqyrtim dhe miratim të Projektligjit të buxhetit të Kosovës për vitin 2008. Do të thotë për t'u shmangur mbi bazën e Rregullës 61 të Rregullores së Punës të Kuvendit dhe ne deri tash folëm dhe të gjitha diskutimet u përfunduan...

(Ndërprerje e shkurtër)

Lus deputetët dhe regjinë edhe një herë, sepse kërkesa është e deputetëve, jo imja. Urdhëro, zoti Shatri!

HAKI SHATRI: Faleminderit shumë! Ka mbetur një pjesë e pasqaruar, zoti Kryetar. Meqenëse ne, në bashkëbisedë me grupet parlamentare u pajtuam që miratimi të bëhet me procedurë të shkurtuar kohore, por kërkesa është që të jetë e qartë në dy lexime. Këtë po e kërkojnë deputetët dhe këtë duhet ta dinë kohën e leximit të dytë. Kryesia e Kuvendit le ta caktojë në pajtim me rregullat që i ka në fuqi.  
Faleminderit!

(Ndërprerje e shkurtër)

KRYETARI: Të nderuar deputetë, ne e kemi votimin e parë. Nëse është nevoja, votojmë edhe njëherë. Urdhëroni! Fjalën e ka deputeti Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit Kryetar!

Unë kërkoj që të nxirret në rivotim, sepse unë personalisht nuk kam arritur të votoj. Është buxheti, është njëri prej vendimeve kryesore brenda këtij viti. Asgjë tjetër nuk është procedurale. Çështja është që të na mundësohet, të konfirmohet votimi në këtë rrafsh.  
Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, lus deputetët që edhe njëherë të përgatiten për votim. Kërkoj që edhe regjia të përgatitet për votim.

Votojmë tash. Faleminderit!

Ju njoftoj për rezultatin e votimit. Konstatoj se me 85 vota me elektronikë dhe 1 me dorë, do të thotë 86 deputetë kanë votuar “për”, “kundër” 10 dhe 2 abstenime.

Kuvendi miratoi Propozimin për shmangien e afateve procedurale me rastin e procedimit, të shqyrtimit dhe të miratimit të Projektligjit për buxhetin e Kosovës për vitin 2008.

Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj se pas miratimit të kësaj shmangieje procedurale, vazhdojmë me procedimin e shqyrtimit të parë të Projektligjit për buxhetin e Kosovës për vitin 2008.

Ndërsa, në seancën e radhës, që do të mbahet, pas një pauze, do të procedohet me shqyrtimin e dytë të Projektligjit për buxhetin e Kosovës për vitin 2008.

Tani ftoj Kryeministrin e Kosovës, zotin Hashim Thaçi, që të bëjë prezantimin e Projektligjit për buxhetin e Kosovës për vitin 2008.

**KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI:** I nderuari, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,  
Zonja dhe zotërinj,  
Të nderuar ministra,

Kam nderin që në emër të Qeverisë së Kosovës të paraqes sot Projektligjin për buxhet për vitin 2008.

Ashtu, sikur e dini, për shkak të ndërrimit të legjislaturës dhe të nevojës për rishikim, ky projektligj është vonuar për procedim, por kemi kërkuar që sot të shqyrtohet dhe miratohet në Kuvendin e Kosovës, pasi tanimë është miratuar nga Qeveria e Kosovës dhe nga Këshilli Ekonomik Fiskal. Shpreh mirënjohjen dhe respektin tim dhe të Qeverisë për mirëkuptimin dhe mundësinë që kjo të procedohet sot.

Të nderuar deputetë,  
Miratimi i buxhetit të Kosovës për vitin 2008 nga ana e Kuvendit të Kosovës përbën dokumentin parësor të politikës financiare, programin e të ardhurave, por edhe shpërndarjen e burimeve financiare në funksion të një zhvillimi më të shpejtë dhe të qëndrueshëm ekonomik dhe social të Kosovës.

Projektpropozimi i të hyrave dhe shpenzimeve për vitin 2008 është produkt i një procesi cilësor, të një niveli të lartë, gjë që në të ardhmen do të ndikojë në përmirësimin cilësor të funksionimit të institucioneve të Qeverisë dhe të mirëqenies qytetare.

Të nderuar deputetë,  
Gjatë miratimit të buxhetit të Kosovës për vitin 2008 kemi parashtruar tri orientime kryesore. Si do të ndikojë miratimi i buxhetit të Kosovës në stabilitetin makroekonomik, në alokimin e resurseve, në efikasitet dhe në shpërndarjen e buxhetit, në aspektin e drejtësisë në shpërndarje?

Të nderuar deputetë,  
Kemi trashëguar një projektbuxhet dhe kemi vlerësuar se duhet bërë rishikimi profesional i tij nga Qeveria e Kosovës.

Procesi i rishikimit të Projektbuxhetit është karakterizuar nga një rritje e ndjeshme e parametrave demokratik të hapjes, të transparencës së gjerë dhe të konsultimit të çdo niveli të agjencionit buxhetor dhe atë nga poshtë – lart. Buxheti i Kosovës për vitin 2008 synon të ketë rolin e një instrumenti parësor financiar për të mundësuar arritjen e

objektivave më të rëndësishme të parashtruara nga ana e Qeverisë së Kosovës. Nga ana tjetër, shërben si një bazament solid për periudhën afatmesme.

Ndryshime të mëdha do të bëjmë gjatë rishikimit të buxhetit në qershor dhe në përgatitjen e tij për vitin 2009, si kornizë afatmesme. Pra, buxheti do të rishikohet edhe një herë në qershor të këtij viti. Me këtë rishikim kemi përfshirë të moshuarit me rreth 16 milionë euro- për rritje të pensioneve për grupin e pensionistëve kontributdhënës. Jemi kujdesur për rritjen e pagave për mësimdhënësit e kualifikuar me ndarje prej rreth 6 milionë euro dhe kemi shtuar fondin për ndërtimin e shkollave, fillimisht për nxjerrjen e atyre nxënësve që ende mësojnë në kontinierë anekandë Kosovës dhe për fillimin e ndërtimit të shkollave të reja anekënd Kosovës, dhe fillimin e informatizimit të të gjitha shkollave në Kosovë, pra kompjuterizimin e të gjitha shkollave në Kosovë. Janë përfshirë edhe kujdesi për pakica si dhe mjete për institucionet e reja dhe kohën që po kalon Kosova në ditët e para dhe menjëherë pas pavarësisë. Është ndarë 1 milion euro vetëm për funksionimin e Zyrës për komunitete që është vendosur, është formuar, është hapur dhe fillon së funksionuari nga sot. Njëkohësisht, kemi alokuar 14.6 milion euro shtesë për projekte rrugore, duke llogaritur edhe 12.5 milion për bashkëfinancim nga komunat.

Në anën tjetër e shprehim zotimin tonë se ato rrugët të cilat janë premtuar, do të fillojnë Prishtinë – Hani i Elezit dhe natyrisht Merdare – Morinë. Kemi ndarë edhe pjesë për funksionimin e ndërmarrjeve publike dhe disa ndryshime të tjera, të cilat besoj ministri Shala do t'i thotë më në detaje, dhe ju keni tanimë draftin e Projektligjit për buxhet të cilin do ta diskutojmë. Jo vetëm ministri Shala, por të gjithë ministrat janë në dispozicionin e sqarimeve, të debatit, të plotësimeve dhe për dhënien e të gjitha informacioneve shtesë të cilat janë të domosdoshme edhe për ju, si deputetë, për aprovimin e buxhetit.

Të nderuar deputetë,

Në veçanti, Buxheti për vitin 2008 siguron:

Së pari, një rritje të dukshme të të hyrave 1 miliardë e 27 milionë euro dhe është rezultat i masave të parapara në administrimin financiar dhe të efekteve të pritshme të pakos së re fiskale. Kjo rritje e buxhetit të Kosovës është programuar që të nxisë rritjen ekonomike dhe zhvillimin më dinamik të sektorit privat.

Së dyti, rritja e të hyrave buxhetore në radhë të parë mbështetet nga politikat e reja fiskale që do të përmbliidhen në paketën e ligjeve të reja, që do të duhej të aprovohen sa më parë.

Reforma strukturore në administratën tatimore dhe doganore, e që ka nisur të japë efekte në përmirësimin e administrimit dhe të ndërtimit të një administrate moderne fiskale.

Së treti, rritja realiste e disa shpenzimeve buxhetore do të përqendrohet në alokimin e atyre prioritetëve që janë më urgjente për funksionimin e Kosovës si shtet modern, si

dhe për rritjen e efikasitetit të përdorimit të financave publike dhe, së fundi, me rritjen e investimeve kapitale të drejtuara në projekte prioritare, që do të mundësojnë efekte maksimale për një rritje të qëndrueshme ekonomike dhe për një zhvillim të harmonizuar ekonomik.

Të nderuar deputetë,  
Zonja dhe zotërinj,

Jem të vetëdijshëm se buxheti i këtij viti nuk është i mjaftueshëm që t'i mbulojë të gjitha nevojat për investime publike dhe për rritjen më të madhe të pagave. Nevojat janë të shumta dhe të mëdha, mirëpo ato patjetër duhet të harmonizohen me prioritetet më urgjente me kapacitetet e agjencioneve buxhetore, në mënyrë që ky buxhet të përdoret në mënyrë sa më racionale dhe sa më efektive.

Buxheti i vitit 2008 do të mund të shpenzohet në mënyrë transparente dhe të gjitha agjencionet buxhetore duhet të japin llogari para Qeverisë, Parlamentit dhe tatimpaguesve për mënyrën e shpenzimit të buxhetit të tyre. Tatimpaguesit kosovarë, që mbushin arkën e buxhetit të Kosovës, në të ardhmen shumë të afërt do të binden se mjetet e tyre nuk do të mund të përdoren për përfitime personale dhe për shpenzime të panevojshme, por ato do të jenë në funksion të zhvillimit ekonomik dhe të ngritjes së standardit jetësor të të punësuarve, të pensionistëve dhe të çdo qytetari të Kosovës.

Prioritet mbi prioritetet pas pavarësisë do të jetë fillimi i zgjidhjes së problemeve të shumta ekonomike dhe të atyre sociale.

Me këtë buxhet jemi të vetëdijshëm se nuk mund t'i zgjidhim të gjitha problemet në periudhën afatshkurtër, por thellësisht besoj se shfrytëzimi racional dhe efektiv i buxhetit të propozuar do të ndikojë në iniciimin e një rruge të re të progresit zhvillimor.

Mjetet tona vetanake janë shumë të kufizuara për t' zgjidhur problemet tona të grumbulluara ekonomike dhe sociale gati dy dekada. Zgjidhja e vetme do të jetë krijimi i një ambienti të sigurt dhe perspektiv ekonomik në shtetin e Kosovës, me qëllim të tërheqjes së investimeve të huaja direkte dhe të korporatave të mëdha multinacionale.

Të nderuar deputetë,  
Zonja dhe zotërinj,

Investimet nuk do të vijnë derisa ne si Qeveri nuk sigurojmë plotësisht ambient dhe stabilitet politik, ekonomik, derisa ne nuk e ndalim korrupsionin, dukuritë negative dhe përderisa ne nuk garantojmë siguri të plotë për investitorët e huaj në Kosovë. Zero tolerancë ndaj korrupsionit kudo dhe nga kushdo që paraqitet si dhe ndaj atyre që e heshtin, e fshehin apo e mbrojnë. Ky është zotimi im, ky është zotimi i Qeverisë, ky është prioritet i Qeverisë së re të Kosovës. Definitivisht, në Kosovë do të fillojë të funksionojë ligji.

Të nderuar deputetë,

Qeveria e Kosovës synon që të ndërmerr këto masa gjatë këtij viti:

1. Implementimi i buxhetit kapital nga Buxheti i Kosovës, nga mjetet e privatizimit, trustit pensional të Kosovës, ndërmarrjeve publike, përmes investimeve shtesë kapitale në masë të konsiderueshme do të rritet kërkesa agregate dhe e njëjta në mënyrë të tërthorët do të shtojë të hyrat buxhetore.
2. Zvogëlimi urgjent i konsumit publik.
3. Fillimi sa më parë i aksionit për zvogëlimin e mundësisht edhe ndalimin e ekonomisë informate, të zezë, që gëlltitë një pjesë të konsiderueshme të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës.
4. Zgjerimi sa më i madh i bazës tatimore, që duhet të jetë detyrë e Administratës Tatimore të Kosovës për të kompensuar zvogëlimet e të hyrave nga doganat që do të ndodhë në vitet e ardhshme CEFTA dhe liberalizimi i tregtisë.
5. Ndërmarrja e masave urgjente për zvogëlimin e deficitit shumë të madh të bilancit të tregtisë së jashtme.

Të nderuar deputetë,

Ju ftoj si Kryeministër i Kosovës, si Qeveri e Kosovës që t'i jepni vërejtjet dhe kontributin tuaj të cilat do të shikohen me kujdesin më të madh dhe seriozitetin më të lartë. Ato vërejtje dhe sugjerime të inkorporohen dhe, natyrisht, ju ftoj edhe ta votoni. Nuk kemi kohë për të humbur. E përmendi një deputet, do të duhej të diskutonim diçka tjetër, por edhe asaj tjetres i vjen koha, ashtu siç është planifikuar, prandaj ju falënderoj për kontributin tuaj. Tani, me siguri, fjalën do ta marrë ministri i Ekonomisë dhe Financave, Ahmet Shala, i cili në detaje do t'i paraqesë të dhënat shtesë për buxhetin e Kosovës për vitin 2008.

Kaq ishte nga ana ime, si Kryeministër i Kosovës, në aspektin e përgjithshëm, tani në detaje edhe ministri Shala, edhe ministrat e tjerë, edhe zëvendëskryeministrat do t'ju informojnë, do t'ju përgjigjen pyetjeve, sugjerimeve, rekomandimeve. Ju falënderojmë edhe për ndonjë këshillë, për ndonjë sugjerim.

Ju faleminderit! Buxheti është i të gjithëve, për të gjithë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, zoti Kryeministër!

Fjalën e ka ministri Ahmet Shala.

AHMET SHALA: Ju faleminderit, zoti Kryeministër! Unë kam, gjithashtu, kënaqësi të qëndroj para Kuvendit në këtë moment historik.

I nderuari zoti Kryetar,

Të nderuar deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

Fillimisht dua t'ju informoj se buxheti për vitin 2008 është përgatitur mbi bazën e projeksioneve makro - fiskale për periudhën 2008 -2010 të përgatitur nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave.

Pra se t'ju jap informata mbi projeksionet e indikatorëve kryesor makro- fiskalë, me lejoni që shkurtimisht t'ju informoj mbi performansën aktuale të ekonomisë së Kosovës.

Zhvillimet e përgjithshme ekonomike, sipas të dhënave më të fundit për vitin 2007, tregojnë se bruto produkti vendor ka qenë në kufi prej 3,5 deri në 4%. Megjithatë, duhet thënë se ekonomia lokale që përjashton efektet direkte të donatorëve, ka vazhduar të shtojë një rritje dhe ajo sillet prej 4 deri në 5%.

Kontribuuesit kryesor të kësaj rritjeje kanë qenë konsumi privat, investimet dhe eksporti. Si rezultat i rritjes së çmimeve në tregun botëror gjatë vitit 2007, indeksi i çmimeve të konsumit, i cili është indikatori kryesor e ecurisë së çmimeve, ka shënuar një rritje të konsiderueshme diku 4,5%, dhe kontribuuesit më të mëdhenj që kanë shkaktuar këtë inflacion kanë qenë çmimet e produkteve ushqimore dhe çmimet e naftës dhe të derivateve të saj. Duke pasur parasysh që ekonomia e Kosovës varet shumë nga importet, atëherë lëvizjet e këtyre çmimeve në tregun botëror janë reflektuar në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe në tregun tonë të brendshëm.

E përmendi edhe Kryeministri, tregtia e jashtme në vitin 2007-2006 ka pasur disfavor, faktikisht, sikurse që do të ketë edhe në vazhdim. Mbase edhe një rritje prej 30% nuk mjaftojë edhe për pesë vitet e ardhshme të vijmë deri te një bilanc i duhur. Kjo ka bërë që në terma relativ, bilanci tregtar të përmirësohet, por është shtuar edhe importi, kështu që, megjithatë, nuk kemi një bilanc të qëndrueshëm, i cili do të nevojitej të barazonte dhe të stabilizonte tregun e Kosovës. Më vonë do të shohim se cilat do të jenë masat.

Në anën tjetër, shpenzimet buxhetore janë rritur prej 3,5%, duke arritur vlerën prej 657 milion eurosh. Një brengë me të cilën ne tashmë kemi filluar të merremi, në të kaluarën është nënshpenzimi i kategorisë së mjeteve për shpenzime kapitale, përkatësisht aftësia e dobët e realizimit të projekteve investuese kapitale, e si pasojë është paraqitur edhe paraqitja e suficiteve buxhetore në vitet e kaluara.

Do të jemi shumë të përkushtueshëm që këtë brengë së bashku me ju, të nderuar deputetë, ta tejkalojmë. Ne i kemi marrë disa masa. Unë para tri javë dite, komform kompetencave që i kam, kam lëshuar Urdhëresën administrative e cila mundëson fillimin e procedurave për iniciimin e tenderëve para se t'i kemi mjetet në xhiro-llogari dhe natyrisht që kjo do ta shkurtojë procedurën diku për një 50 ditë, të paktën.

Kemi identifikuar format tjera, ndër to edhe plotësimin e Ligjit mbi prokurimin dhe së shpejti, bashkë me ju këtu, do të amendojmë. Besoj se do ta gjejmë përkrahjen tuaj që të amendohen disa nga elementet të cilat kanë shkaktuar, jo vetëm ngadalësimin e ekzekutimit të projekteve kapitale, por edhe monitorimin e dobët të ekzekutimit të tyre.

Theksova edhe më lartë se Buxheti për vitin 2008 është bazuar në projeksionet makro-fiskale dhe në linjë me prioritetet e Qeverisë. Ekonomia si tërësi pritet të shënojë një rritje edhe më të madhe në vitin 2008, e më pas edhe në vitet vijuese. Atë parashikim e mbështesim në analiza dhe masa reale të cilat janë shprehur në mënyrë të butë edhe në buxhetin e projektuar.

Produkti vendor në vitin 2008 parashihet që të shënojë një rritje prej 5%, ndërsa ekonomia lokale diku 6,5%. Faktorët kryesorë që pritet të ndikojnë në këtë rritje do të jenë investimet private dhe atë publike, eksporti dhe konsumi privat. Në të njëjtën kohë, gjatë vitit 2008 dhe viteve të mëvonshme të hyrat buxhetore pritet të shënojnë në rritje të mëtutjeshme. Të hyrat totale buxhetore pritet të rriten diku mbi 5% duke arritur vlerën prej 860 milion eurosh.

Në anën tjetër, kemi bërë një rritje të konsiderueshme të shpenzimeve buxhetore me theks të veçantë mbi kategorinë e shpenzimeve kapitale të cilat do të bëjnë të mundur përmirësimin e infrastrukturës së përgjithshme. Si rezultat, kjo do të bëjë, faktikisht, zhvillimin më të mirë të mirëqenies shoqërore, sidomos përmes zhvillimit të sektorit privat.

Buxheti i vitit 2008 po ashtu parasheh financimin e aktiviteteve që dalin nga Pakoja e Ahtisarit, ndërsa ne kemi ndarë rezerva të mjaftueshme që do të shërbejnë për qëllime të likuiditetit në raste të jashtëzakonshme që, mbase, mund të mos ndodhin. Uroj që të mos ndodhin! Ju siguroj që këto parashikime makro – fiskale janë bazuar në vlerësime profesionale dhe janë bazë shumë e fortë dhe mbështetëse për Buxhetin 2008.

Buxheti që kërkojmë të aprovohet nga Kuvendi është një hap i mirë për funksionimin normal të Kosovës. Ai lëviz Kosovën në drejtim të duhur për të zhvilluar me përmirësime afatgjate që do të jenë të nevojshme për të filluar në shtetin e ri të Kosovës, duke bërë balancin e shpenzimeve me përmirësimet në ekonomi. Ky buxhet ndihmon në sigurimin e stabilitetit ekonomik, në rend të parë përmes përmirësimeve të infrastrukturës, energjisë, rendit e ligjit, ngritjen e mirëqenies së minoriteteve, por edhe të të gjitha strukturave të tjera shoqërore politike në Kosovës dhe të sferës tjetër sociale, gjithnjë duke ruajtur disiplinë fiskale.

Ky buxhet, për shkak të të hyrave të kufizuara nuk mund të ofrojë zgjidhje për të gjitha problemet me të cilat ndeshemi aktualisht, por ndërmerr hapat e parë drejt themelimit të rrugës që duhet ta ndjekim. Ai siguron financim më tepër se buxheti që kemi trashëguar, sidomos për shkolla të reja për fëmijët tanë, siguron financim shtesë për sigurimin e barërave të nevojshme për ruajtjen e shëndetit të popullatës sonë dhe shton fonde për projekte rrugore që do të jenë jetike për përmirësimin e transportit dhe të mundësive tona për lëvizje të mallrave dhe të njerëzve në Kosovë dhe përreth saj.

Në buxhetin e këtij viti janë paraparë 16 milion euro për rritjen e pensioneve për grupin e pensionistëve kontributdhënës, atë që e përmendi edhe zoti Kryeministër. 1,4 milion euro për mbushjen e detyrimeve që burojnë nga ligji për kategori të veçanta.

Gjithashtu janë përfshirë edhe 6 milion euro për pagesat e mësimdhënësve të kualifikuar.

Këto mjete janë vetëm fillimi i zgjidhjes së shumë çështjeve sociale me të cilat ballafaqohet Kosova. Ne do të vazhdojmë të adresojmë këto probleme, atëherë kur të kthehemi në rishikimin dhe hartimin e kornizës afatmesme të shpenzimeve, e cila fillon tani në mars, me rishikimin e gjashtëmujorit të buxhetit 2008, që e planifikojmë në qershor, si dhe, natyrisht, me fillimin e rishikimit, përkatësisht përgatitjes së Buxhetit 2009 që fillon në tri javët e ardhshme, e i cili do të vazhdojë, natyrisht.

Këto investime janë jetike në kohën kur do të jemi në hapat e parë në Kosovën e pavarur, por edhe në këta hapat e fundit të një fillimi të ri duhet të jemi të ekuilibruar në veprimet tona, në mënyrë që t'ju mundësojmë miqve tanë, donatorëve kryesorë dhe të tjerëve, të na ndihmojnë në perspektivat dhe sfidat tona afatgjate.

Ky strukturim i kujdesshëm i Buxhetit të Kosovës do të ndihmojë në përmirësimin e të hyrave tona, duke krijuar kështu të ashtuquajturin - cikël i drejtë. Më lenoni tani t'i jap ca shifra më detale. Buxheti i rishikuar përfshinë financimin shtesë prej 20 milionëve, siç e thashë e dhe më herët, prej tyre 14,6 milion për projektet rrugore, 12,6 milion prej tyre janë në bashkëfinancim me komunat, 750 mijë euro për ndërtimin e shkollave të reja, 300.000 euro për fondin e shpërblimeve në dogana. Besoj që ky është një fond i qëlluar për të stimuluar kontrollin e rreptë dhe kujdesin për qytetarët ndaj mallrave të kontrabanduara, dhe disa projekte, nën ombrellën e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim.

Janë përfshirë disa propozime që lidhen me statusin, natyrisht, siç është, e kemi përmendur disa herë, Njësia antiterroriste në Shërbimin Policor të Kosovës; Fondi për reforma të qeverisë lokale, sipas propozimit të Ahtisarit, dhe fondet për t'u mundësuar ekipeve sportive të marrin pjesë në garat ndërkombëtare.

Me iniciativën edhe të miqve tanë dhe, natyrisht, me prioritetet që i kemi në Qeveri, ne, fare në fund, pasi që e ka aprovuar Këshilli Ekonomik Fiskal, jemi marrë vesh dhe konsideroj që është shumë e qëllueshme që të ndajmë një fond të veçantë pranë Zyrës së Kryeministrit, 1 milion euro, një fond ku donatorët kryesorë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe të tjerët, Komisioni Evropian, më vonë, janë të interesuara të bëjmë një fond të veçantë për komunitete dhe kthim pranë Zyrës së Kryeministrit, ku do të jetë një fond për trajtimin e problemeve të minoriteteve. Presim që ky fond në vitet në vijim të ketë një shumë sinjifikante që do të ndihmojë, përveç problemeve që trajtohen nëpër ministritë përkatëse dhe nëpër komuna përkatëse, në mënyrë të veçantë ndonjë projekt i cili ka rëndësi të veçantë dhe ne kemi shprehur gatishmërinë që të vejmë 1 milion në dispozicion, ndërsa pjesën tjetër shtesë, pra të paktën për aq, do ta japin edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Meqenëse duhet ta rrumbullakoj, atëherë po eci përpara. Ka pasur shumë kërkesa të tjera, që janë dorëzuar për t'u shqyrtuar gjatë përgatitjes së buxhetit 2008, të cilat nuk kanë mundur të përfshihen. Gjithmonë do të jemi të kujdesshëm edhe me shpenzimeve

operative dhe me dialog të përhershëm me partnerët tanë, sidomos para Konferencës së donatorëve. Me Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Botërore, Komisionin Evropian, USAID dhe më donatorët e tjerë do të përpiqemi që të gjejmë formulat e qëndrueshme për t'i zgjedhur ato probleme në mënyrë të qëndrueshme dhe afatgjate.

Jemi të vetëdijshëm për nevojat dhe kërkesat nga segmentet e caktuara dhe jam i sigurt që do të gjejmë formula, që me rishikimet që i përmenda do t'i zgjidhim.

Në këtë kohë historike, natyrisht, kemi nevojë edhe për buxhet të fuqishëm dhe ne besojmë që ky buxhet është i tillë. Mund mos të jetë i përsosur, por mendoj se është më i miri i mundshmi në këtë situatë. Prandaj, i nderuari zotëri Kryetar, deputetë të nderuar, kërkoj nga ju që sot ta aprovojme këtë buxhet, i cili do të mundësojë adresimin dhe zgjidhjen e prioriteteve tona. Unë do të jem në dispozicionin tuaj për sugjerime, kritika dhe, natyrisht, përgjigjet besoj që do të jenë të shkurta dhe adekuate. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, zoti Ministër!

Sipas radhës, fjalën e ka kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, zoti Gani Koci.

GANI KOCI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe njëherë përshëndetje Kryeministrit dhe ju tjerëve,

Vërtet, nevoja po do që të ngutemi dhe do të ngutemi edhe në fjalimet tona. Ne si Komision sikur e kemi përfunduar punën në shqyrtimin e këtij Projektbuxheti dhe po ju lajmëroj paraprakisht, po ju informoj paraprakisht se ne i kemi përgatitur edhe amendamentet në pjesët ku duhet ndryshohet dhe ato amendamente i ka miratuar Komisioni për Buxhet, kështu që ne kemi shkuar një hap më përpara, ndoshta.

Qeverinë duhet ta përgëzoj për kohën që e ka pasur kaq të shkurtër dhe të na e sjellë një Projektbuxhet të rishikuar, që po të shikohet në detaje, ndoshta nuk ka ndryshime as në strukturën e të hyrave, por as në atë të shpenzimeve, në kategoritë e shpenzimeve, dhe veçanërisht duhet të them një qëndrim timin, ndoshta personal, që nuk na ka ndodhur deri me tani, që në kategorinë e shpenzimeve kapitale të kemi në rritje 100%, dhe në të gjitha kategoritë e tjera përfitojnë ndoshta grupe të veçanta të shoqërisë, por në këtë kategori të investimeve kapitale përfitojnë të gjithë dhe për këtë dua të përgëzoj Qeverinë.

Një çështje që e ka preokupuar Komisionin për Buxhet dhe Financa në këtë mandat, por edhe në mandatet e tjera, është te kategoria, siç quhet, e fuqive rezervë, që Buxhetit të Kosovës i ka marrë një shumë të caktuar dhe deri me tani asnjëherë, as si Kuvend, nuk di si Qeveri ose ministri, nuk kemi pasur raporte për mënyrën e shpenzimeve të parasë publike dhe insistojmë që, kësaj radhe, Qeveria dhe ministri për Ekonomi dhe Financa vërtet të vejnë relacione të duhura me këto fuqi të rezervuara, që së paku në këtë rast të na informojnë për mënyrën e shpenzimeve të buxhetit.

Është karakteristike që, ndoshta është thënë vetëm për KEK-un që ka marrë shuma të caktuara, shuma marramendëse nga paratë publike dhe nuk kemi pasur një raport të shpenzimeve të atyre mjeteve. Tani kemi parë këtu, është diskutuar shumë, se ka një vlerë që dedikohet, qoftë si shpenzim buxhetor, ose në formë të kreditimit, diku prej 79 milionëve, dhe është sugjerim i Komisionit që, vërtet, Qeveria dhe Ministria të jenë shumë të kujdesshme në raport me realizmin e këtyre mjeteve buxhetore.

Në përfundim, kemi pasur shumë kërkesa nga agjensionet rregullative, kërkesa të veçanta, që në rishikim t'i rrisim buxhetet e tyre. Në shumicën e rasteve nuk kemi mund t'i marrim parasysh këto kërkesa për shkak të kohës. Është kërkesë dhe rekomandim i Komisionit që për të gjitha këto kategori, për të gjitha këto organizata buxhetore që kanë pasur kërkesa për shtimin e buxhetit të tyre, të trajtohen në pjesën e dytë gjatë rishikimit të këtij buxheti që do të miratohet dhe të merren parasysh edhe rekomandimet e Komisionit, por edhe kërkesat e atyre agjencioneve. E keni në material një rekomandim se cilat agjencione është dashur të trajtohen, por Komisioni nuk ka mundur t'i trajtojë. Kam një kërkesë, që në emër të Komisionit, në kuadër të këtij miratimi në parim dhe të leximit të dytë të këtij Projektbuxheti, të shqyrtohet edhe Projektbuxheti për Agjencionin, për Zyrën e Rregullatorit të Energjisë Elektrike dhe për Agjencionin e Rregullatorit të Telekomunikacionit, sepse sipas ligjeve të tyre, ligjeve që i rregullojnë këto fusha në aspektin e financimit, buxhetet e tyre i miraton Kuvendi, si buxhete të ndara veç, por, në fund të fundit, ato i nënshtrohen Ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe, në fund, jemi marrë vesh që edhe buxhetet e tyre të futen në tabelat e shpenzimeve buxhetore të buxhetit të përgjithshëm. Prandaj, kërkoj që në këtë kuadër t'i kemi parasysh edhe këto dy agjencione, dy organe rregullative, sepse kemi mjaft probleme rreth projektimit dhe të miratimit të buxheteve të këtyre agjencioneve rregullative. Është një kërkesë që Qeveria të mendojë, që qoftë me ligj ose me rregulla të tjera të posaçme, të bëjë një rregullim, një unifikim të mënyrës së trajtimit të këtyre agjencioneve në aspektin e buxheteve. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Koci! Tani është radha e shefave të grupeve parlamentare. Sipas radhës, fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës.

RAMË BUJA : Edhe njëherë përshëndetje, nëse nuk u bë shumë me këto përshëndetje të shpeshta, për të gjithë ju prezentë në sallë,

Unë nuk kam çka i shtoj asaj që tha zoti Gani, por ai foli për pjesën e Komisionit dhe unë duhet ta shtoj vetëm atë pjesën tjetër, si Grup Parlamentar, se ne me atë shikim të përshpejtuar që kemi bërë, natyrisht, në rrethana të tjera do të kishim pasur edhe vërejtjet tona, edhe sugjerimet tona për zëra të ndryshëm buxhetor, por natyrisht, meqë jemi të ndërgjegjshëm për veprime që duhet t'i bëjmë të përshpejtuara, ne e mbështesim këtë buxhet dhe vota jonë është “për”.

KRYETARI: Ju faleminderit zoti Buja! Nga Lidhja Demokratike, zoti Hakai Shatri.

HAKI SHATRI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar Kryeministër, anëtarë të Qeverisë,  
Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes demokratike të Kosovës përkrah në parim aprovimin e Projektligjit për Buxhetin për vitin 2008, me pjesët përbërëse të tij, tabelat 1 deri në 4, duke pasur për bazë dy çështje kyçe: aktualitetin politik që po zotëron në Kosovë dhe, bashkërisht me të, domosdoshmërinë për sigurimin e Buxhetit për funksionimin normal të institucioneve të Kosovës. E dyta, për Grupin Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, është më lehtë të përkrahë aprovimin në parim të këtij dokumenti, me qenë se në çështjet kyçe ky version përmban politikat dhe përmbajtjen e versionit të buxhetit të përgatitur nga Qeveria e Kosovës, për të cilin, siç dihet, Lidhja Demokratike e Kosovës ka qenë në pushtet, version pra, të cilin e kemi dorëzuar në këtë Kuvend në nëntor të vitit 2007.

Mendoj që do të ishte korrekte që kjo të theksohet, qoftë nga Kryeministri, qoftë nga ministri i Financave, sepse ky është një realitet, i cili për deputetët e këtij Kuvendi duhet të potencohet dhe të vihet në pah.

Cilat janë anët pozitive të këtij dokumenti? Buxheti i respekton parametrat e kornizës afatmesme të shpenzimeve dhe prioritetet e përcaktuara në këtë dokument, i cili është dokument obligativ dhe konkretizohet me buxhetet vjetore të aprovuara në këtë Kuvend. Ky dokument, Buxheti për vitin 2008, konkretizon me propozim të alokimeve të buxheteve, për prioritetet, pra për sektorët që janë të përcaktuara me prioritet dhe, si të tilla, për ne janë të pranueshme dhe duhet të përkrahen, në parim.

Në këtë buxhet janë siguruar mjetet për pagat e arsimit, të rritura në shtator të vitit 2007, pra vazhdimi në vitin 2008, rritja e pensioneve për ish pensionistët nga 40 në 75 euro, si dhe sigurimi i mjeteve për mbulimin 100% të obligimeve që dalin ndaj familjeve të luftëtarëve dhe të dëshmorëve dhe, ajo që është e fundit, janë siguruar mjetet falas për nxënësit e shkollave të ciklit të ulët, të arsimit fillor, që është obligim në bazë të Ligjit për arsimin fillor dhe të mesëm.

Prioritetet e përcaktuara në KASH janë ruajtur dhe janë konkretizuar në alokimet e propozuara në investime, në prioritate të përcaktuara, siç janë: energjia, infrastruktura rrugore, ku kryesisht hyjnë dy autostradat më të mëdha që kalojnë nëpër Kosovë, dhe në ndërtimin e objekteve të arsimit, pra në ndërtimin e objekteve shkollore.

Kemi edhe disa vërejtje në parim. Të hyrat, të cilat kryesisht janë bërë, jo duke u mbështetur në parametrat makro-ekonomikë, por si një deklaram që e ka bërë Administrata Tatimore dhe Shërbimi Doganorë, janë shtuar për 45 milion euro.

Të hyrat vetanake nga Qeveria janë shtuar 13 milion euro. Po flas në krahasim me versionin e parë. Kurse të hyrat vetanake nga komunat janë zvogëluar për 8 milion euro dhe të hyrat e njëhershme, 10 milion kanë qenë të parapara, janë hequr fare. Kjo do një koment të shkurtër. Është në rregull që janë rritur të hyrat, por zvogëlimi i të hyrave vetanake të komunave ngulfat iniciativën e komunave për zgjerim të bazës materiale

dhe sipas rregullave në fuqi, janë shumë më të favorshme të hyrat vetanake të komunave, sepse ato kurdo që i realizojnë ato të hyra, kanë mundësi që t'i procedojnë në procedurë të shpenzimit të tyre.

Është një çështje tjetër. Të hyrat janë rritur, kurse kufijtë e shpenzimeve kanë mbetur në nivelin e mëhershëm. Pra, kemi projektuar një suficit me paramendim, suficit që sillet, sa kam mundur të llogaris, rreth 75 milion euro, pra kemi projektuar suficit. Çka do të thotë kjo? Do t'i tërheqim disa para nga ekonomia dhe nuk do t'i kthejmë me proces të shpenzimit buxhetor. Kjo nga aspekti i makroekonomisë është pak sa e dëmshme, kur marrim parasysh që në Projektbuxhet janë paparë rezervat e domosdoshme të cilat duhet të ruhen në çdo vend: 50 milion euro si rezervë e domosdoshme për fillimin e punës në vitin e ardhshëm, 35 milion euro për procedimin e borxheve të Kosovës, në qoftë se ato do të fillojnë të paguhen në këtë vit. Pra, kemi projektuar edhe një shumë prej 75 milion eurosh suficit.

Këto janë vërejtjet tona parimore, të cilat ne dëshirojmë me procedurë t'i diskutojmë, të propozojmë mundësinë e ndryshimit të tyre, por si grup parlamentar jemi të gatshëm që në afatin kohor të kërkuar ta japim kontributin tonë, që buxheti të miratohet me kohë dhe institucionet tona mos të mbesin pa buxhet për shkak të procedurave në aspektin kohor. Ju falënderoj shumë për mirëkuptim!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Jemi shumë të vetishëm se ky buxhet i paraparë për vitin 2008, jo që nuk premtonte zhvillim të përgjithshëm të ekonomisë kosovare, por as për së afërmi nuk i përmbush nevojat e shumta që i ka Kosova dhe sektorët mjaftë të ndijshëm të saj, sidomos në investimet kapitale në shëndetësi, në arsim, në kulturë, në sport, por edhe në fushat e tjera.

Megjithatë, duke pasur parasysh dhe duke e kuptuar drejt situatën në të cilën ndodhet sot Kosova, dhe nevojën që ky buxhet të miratohet në afatin sa më të shpejtë kohor, Grupi Parlamentar i AKR-së në parim mbështet këtë buxhet, duke mos anashkaluar asnjëherë edhe mundësitë që ne t'i paraqesim vërejtjet tona si dhe të japim kontributin tonë në drejtim të përplotësimit të nevojave që mund të ketë ky buxhet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Makolli!

Fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, edhe një herë zoti Kryetar!

Zoti Kryeministër,

Deputetë të nderuar të Kuvendit të Kosovës,

Do të flas shumë shkurt për 3 ose 4 çështje. E para, do të jetë një shënim që duhet ta mbajmë sot, e dyta, është një vështrim realisht i yni, dhe, e treta, është një pyetje në esencë.

Shënimi është ky:

Ne sot kemi votuar dy herë për një çështje radhazi. Do të thotë, kryetari i Kuvendit e ka parë rezultatin e një votimi prej 68 votave, ka kërkuar edhe një votim tjetër. E kuptoj se ndoshta ka qenë e domosdoshme për shkak se disa deputetë kanë qenë duke fjetur dhe herën tjetër i sugjeroj Kryetarit të Kuvendit që t'ju thotë deputetëve të zgjohen dhe të votojnë, e jo të votohet dy herë për një çështje, sepse është praktikë shumë rrallë, të mos them që nuk ndodh kurrë nëpër kuvende që të votohet dy herë radhazi për një çështje e cila nuk ka kaluar.

Një vështrim është shumë interesant...

KRYETARI: Ardian, për sqarim, edhe herën e parë ka kaluar.

ARDIAN GJINI: Me 68 vota nuk kalojnë 2/3. OK, faleminderit! Është votuar 2 herë, atëherë.

Vështrimi është ky:

Ne kërkuam që t'i jepet kohë Kuvendit që të diskutojë për buxhetin, që ta shqyrtojë pak më gjatë dhe kthehet duke pasur parasysh se buxheti duhet të kalojë shpejtë. Është shumë e vërtetë, e kuptojmë këtë aspekt, e kuptojmë Qeverinë. Mirëpo, ka pasur nevojë për më shumë kohë.

Arsyeja është kjo:

Kryeministri i Kosovës me gjenoricitet nga tha: - i bëni vërejtjet dhe sugjerimet sot, dhe do t'i inkorporojmë. Tani shikoni. Përfundon leximi i parë, Kryetari i Kosovës na jep diku 15 minuta pauzë ose një gjysmë ore dhe atëherë inkorporohen për një gjysmë ore në gjithë Buxhetin e Kosovës vërejtjet dhe sugjerimet tona dhe Qeveria kthehet me sugjerimet tona. Kjo është arsyeja pse ne lypëm kohë. Duhet të merren parasysh sugjerimet e deputetëve. Kësaj radhe nuk po merren. Unë sinqerisht shpresoj që Qeveria për 15 minuta do të jetë një gjendje t'i inkorporojë sugjerimet e deputetëve në Buxhetin e Kosovës.

Çështja tjetër është se u tha që ka rritje buxhetore në 1.27 miliardë. Ministri Shatri tregoi se 1.27 miliardë ka qenë Buxheti i projektuar edhe prej Qeverisë së kaluar. Çështja tjetër është një pyetje dhe kjo do të jetë e fundit për sot. Ministri i financave, zoti Shala, tha se bruto produkti nacional i Kosovës do të ketë rritje prej 5% sivjet. Unë e kam një pyetje, duke pasur gjithë respektin, si në aspektin akademik, ashtu edhe në atë profesional, ashtu edhe si ministër, por zotin Shala do ta pyes: A ka dallim mes fjalës rritje prej 5%, që dikush prej nesh do ta kuptonte si një rritje sa është sot, edhe 5%, që

do të thotë do të ishte bërë 9 ose 10 ose 11, e ku ta dijë unë, apo ka dashur të thotë që bruto produkti nacional do të rritet në 5%. E kisha pyetur ministrin të na tregojë a do të arrijë në 5% dhe cila do të jetë diferenca në mes asaj që e ka trashëguar, që e ka marrë sot, dhe ku do të arrijë rritja e bruto produktit nacional, apo do të realizohet dëshira e secilit kosovar që të ketë një rritje plus 5% dhe do t'ia kalojmë edhe Kinës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Gjini!

Fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të LDD-së zoti Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Ne, si Grup Parlamentar e kemi akceptuar nevojën për përshpejtimin e procedurave. Kjo është e para, gjë që dallon prej asaj që tash kemi hyrë në një pjesë tjetër të debatit për buxhet, ku do të flasim.

E para, lirisht mund të themi se gjithë ata që kanë qenë optimistë se për ndryshimet të cilat do të pasojnë nga kjo garniturë qeverisëse, me këtë planifikim mund të binden për një gjë, se ambiciet e kësaj Qeverie nuk dallojnë prej asaj të kaluarës. Kjo u shpreh edhe nga shumë deputetë këtu. Prandaj, edhe njëherë kjo demonstroi se kjo Qeveri nuk është në nivelin e përgatitur për të absorbuar dhe shfrytëzuar kapacitetet dhe resurset të cilat i posedon vendi ynë Kosova.

Një gjë tjetër që është anakronike, që ndodh këtu te ne, është që bisedojmë për buxhet, bisedojmë për planifikim, kurse në të njëjtën kohë nuk e kemi të njohur programin qeveritar. Do të thotë, planifikimi i kësaj Qeverie bëhet jashtë asaj që do të ishte shumë normale, shumë parimore dhe shumë e drejtë nga një strukturë qeverisëse, do të thotë programi dhe plani i kësaj Qeverie.

Në anën tjetër, nëse kjo është e përballueshme nga këndi politik, edhe ne si opozitë, duke pasur në konsideratë krenarinë nevojën që e shtron procesi politik, duke pas në konsideratë se edhe ne, edhe partitë opozitare në planin e interesit nacional do të jemi partner, mirëpo qasjen që ka manifestuar kjo strukturë qeverisëse tash si Qeveri, mirëpo edhe dje si opozitë, por edhe në procesin elektorale dallon shumë prej asaj që është planifikuar këtu. Pra, është një diskrepancë e madhe prej asaj që është proklamuar dhe në anën tjetër që sot po debatojmë dhe po diskutojmë këtu për këtë dokument.

Unë do t'i përmendi vetëm dy çështje, ndërsa profesionistët tjerë nga Grupi Parlamentar në detaje do të bisedojnë më shumë.

Keni planifikuar shpenzime më të larta për mallra dhe shërbime se Qeveria e kaluar, ndërsa e kundërta është deklaruar deri më tash.

Dhe e dyta, niveli, pra planifikimi i të hyrave nëpër komuna është më i vogël se sa për atë planifikim që e ka pasur Qeveria e kaluar. Do të thotë, këtu pra kemi të bëjmë me diçka që tjetër është proklamuar, tjetër është deklaruar, është publikuar shumë herët dhe me një politikë e cila nuk korrespondon me realitetin faktik, që e kemi këtu përpara. Dhe, lirisht

këtu mund të them që ambiciet e kësaj Qeverie nuk dallojnë prej ambicieve të Qeverisë së kaluar. Sfidë për këtë Qeveri do të jetë t'i harmonizojë ambiciet e veta me këtë planifikim buxhetor. Kjo do të jetë sfida më e madhe e kësaj Qeverie. Ju faleminderit!

KRYESUESI XHAVIT HALITI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Xhezair Murati.

DŽEZAIR MURATI: Poštovani predsedavajući, premijeru, kolege, Ja, evo u ovom drugom obraćanju danas, mogu da kažem da sam obradovan u ime triju manjinskih zajednica koje predstavljam sada u Parlamentarnoj grupi, a i u Predsedništvu, da je od danas počela da radi pri Kabinetu premijera Kancelarija za zajednice. To kažem, predstavlja za nas i, nadam se, za sve vas jednu veliku i značajnu uinformaciju, tako da ono što je zamislio premijer, odnosno nova Vlada, nadamo se da će ta Kancelarija da postigne efekat koji je zamišljen, da će biti transparentna i da ćemo u svakom slučaju jednoga dana biti primljeni u toj Kancileriji, videti na koji način će premijer popuniti, i mi ne sumnjamo da će ona da postigne svoj efekat.

Drugo, što želim da kažem je, gospodo, u prethodna dva mandata imamo loša iskustva kada je u pitanju Ministarstvo za povratak i zajednice. Ono se sada zove Ministarstvo za zajednice i povratak. Nije slučajno promenjen naziv, međutim sve do danas to Ministarstvo radi kao Ministarstvo koje predstavlja samo jednu zajedncu. Nadamo se da će Vlada shvatiti ovo što želim da kažem, i da to Ministarstvo zaista postane Ministarstvo za zajednice, da u njemu budu predstavljeni u političkom stafu i u ostalom, dakle, predstavnici svih zajednica u prvom redu Bošnjaka, Turaka, Roma koje predstavljamo, a i ostalih.

Drugo, prilikom planiranja budžeta, Nacrata konsolidovanog budžeta za 2008. godinu, kada je u pitanju to Ministarstvo, ima dosta neodređenih projekata za koje ne znamo kojim zajednicama su namenjeni. S toga, apelujem na Vladu, na zamenike, ministra, premijera, jer sigurno on ne može uvek da se bavi ovim stvarima, da se u pojašnjavanju i preciziranju projekata vodi računa i o ostalim zajednicama a ne samo o jednoj. Ja istinski, na jedan krajnije korektan način iznosim ovu primedbu, i mi bismo želeli da u sredinama gde živimo u većem broju, bude ulaganja koja su usmerana i prema jednoj zajednici koja živi u najvećem broju u severnom delu Kosova, tako da efekti budu prema načelu fer raspodele, a ne da neko bude forsiran, kako je to do sada bilo, i tako dalje.

Drugo, kada su u pitanju predviđena sredstva u Ministarstvu za saobraćaj i telekomunikacije, ja bih ovde pomenuo jedan problem koji smo u više navrata iznosili, čak smo u Nacrtu zakona o medijima jedan amandman donjeli, jer je do sada u sredinama gde žive predstavnici moje zajednice, bio je nametnut danak, porez, harač, kako hoćete, od 3,5 eura za TV signal RTK koji ne primamo i nakon osam i po, odnosno devet godina u oslobođenom Kosovu, mi ne primamo RTK, dakle mrežu RTK, nego neke druge propagande televizijske stanice, a plaćamo pretplatu, zamislite. Mislim da je nekorektno, odnosno da ako se deo sredstava koja su bila odvajana od naših građana, kada bi se upotrebio u releje, onda bi moglo od tih sredstava da se naprave antene i releji, jer je krajnije vreme da građani, predstavnici naših zajednica, odnosno moje Bošnjačke zajednice gledaju signal svoje države, i da za to plaćaju, a ne

da plaćaju ono što ne gledaju. Mislim da je krajnje vreme da se o tome povede računa. Mi nemamo krajni cilj da ne plaćamo TV pretplatu, nego da je plaćamo ali da tu uslugu koristimo.

Takodje, spomenuću da je u pretodnom mandatu bilo igradjeno nekoliko puteva u Prizrenskoj i Dragaškoj opštini koji nisu dovršeni. Ja se nadam da će se smoći sredstava da oni budu završeni, jer će zub vremena učiniti da kasnije više sredstava u to ulažemo.

Kada je u pitanju Ministarstvo kulture, ja bih ovde izneo nešto što smo i u pismu premijeru, prilikom naših dogovora spomenuli. Mislim da bi takodje veoma efektno bilo ako bi se u Prizrenu, koji je centar nekoliko manjinskih zajednica, odnosno maltene svih brojnih manjinskih zajednica napravio jedan kulturni centar koji bi u ovom vremenu pospešio integrisanje manjinskih zajednica u novo kosovsko društvo. Mislim da sa obeju strana, da ne govorimo o stranama, postoji velika potreba radi očuvanja identiteta kulturnog nasledja, običaja, foklora i da ne nabrajam još, i tako dalje, i tako dalje.

Kada je u pitanju obrazovanje, ja bih takođe spomenuo još jedan problem koji smo ovde takođe u ranijim mandatima iznosili, a to je da još uvijek kasnimo sa izdavanjem udžbenika iz nacionalnih grupa predmeta. Ministar naš novi je upoznat sa time, tako da treba možda malo ažurirati štampanje knjiga iz grupe nacionalnih predmeta, a više pažnje usmeriti na prevođenje udžbenika koji su iz prirodnih predmeta, kako bi bili kvalitetniji prevodi, kako bi na vreme stizali i kako ne bismo počeli školske godine bez udžbenika.

I, evo, da završim diskusiju. Ja bih još i Ministarstvo zdravstva takođe zamolio, jer imamo nekoliko započetih zdravstvenih objekata i nadam se da će u ovoj godini biti sredstava kako bi se oni konačno završili. I, eto, iz moje diskusije vidite da mi u načelu, uz primedbe koji smo izneli, prihvatamo predlog Nacrta budžeta za ovu godinu, želeći da on uspešno bude ostvarivan. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit, zotëri Murati! Për fjalë është paraqitur deputeti Slobodan Petroviq.

SLOBODAN PETROVIĆ: Gospodine predsedavajući,  
Uvaženi premijeru, ministiri,  
Dame i gospodo poslanici,

Imao sam nameru da odustanem od diskusije da bi proces išao što brže, ali sam u jednu ruku prozvan, jer je prozvano Ministarstvo čiji je ministar iz naše stranke, i samo bih želeo u jednoj minuti da kažem za rad istine da to ministarstvo za mesec dana svog rada prepolovilo je budžet, odnosno prepolovilo je troškove koje je imalo prethodno Ministarstvo, što je veliki uspeh, naravno uz podršku cele Vlade. I ono što želim da vam kažem jeste da to Ministarstvo čini 108 ljudi, od toga Ministarstvo je procenilo da treba još manji broj ljudi, i od tih 108 ljudi -20% su Srbi.

Absolutno vi znate da Samostalna liberalna stranka promovise jednu ideju i bori se za interese svih gradjana Kosova, bez razlike na veru, naciju a pogotovo na stranku, ali mi imamo takav problem da je u to Ministarstvo bila korupcija najveceg moguceg razmera. Ja ocekujem da ce Vlada i svi mi zajedno da damo podršku ministru koji je krenuo u jednu realizaciju projekta koji je zacrtala Vlada, a koja ce imati za cilj da vrati one ljude koji zele da se vrata na Kosovu i zajednicama koje zive na Kosovu da im omoguci što bolji zivot. I, ono što je tema sastanka, odnosno tema diskusije, jeste da s obzirom da smo mi deo Vlade i da je logično da čemo predlog Vlade podržati, želim samo da vam kažem da postoji jedna izreka koja kaže: „Kada se dva slona tuku, strada trava“. U ovom slučaju, srpski poslanici su trava. Ne bih želeo da kvarimo nikakve procese, i želim sasvim jasno da kažem da smo svesni situacije koja dolazi i svesni smo da budžet nije radi budžeta, znači brzina budžeta jednostavno, gospodine premijeru, ja mislim da je pre svega brzina donošenja budžeta upravo zbog torte koja je spremna i absolutno mi smo svesni toga, mi živimo na ovom području, nemojte da imate na ... da mi nismo svesni toga i svakako podržavamo predlog Vlade. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani, sipas renditjes, në radhë janë deputetët e paraqitur. Unë dua që t'ua tërheq vërejtjen, me qenë se ne kemi votuar që buxheti të kalojë në procedurë të shpejtë. Janë paraqitur deri më tani rreth 15 deputetë dhe ju kisha lutur që ata që janë të përgatitur për të thënë diçka lidhur me buxhetin, të diskutojnë dhe të mos na inponohen diskutimet në bazë të debatit ose të diskutimeve që bëhen njëri me tjetrin. Në qoftë se vazhdon kështu, atëherë dua t'ju them që tani u bënë 16 të paraqitur, nga 10 minuta sipas Rregullores, bëjnë 160 minuta dhe duhet ta kemi parasysh kohën dhe përpjekjen tonë që sot ta kalojmë buxhetin. Megjithatë, ne po fillojmë dhe në qoftë se ka ndonjë propozim për ta shkurtuar, do ta shqyrtojmë. Faleminderit!

Për fjalë është paraqitur deputeti Fatmir Rexhepi.

Urdhëro, zoti Hamiti!

Zoti Sabri Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Të lutem, kolegu Haliti. Unë po shoh që në mënyrën e adresimit të problemit po krijojmë konfuzione edhe kur s'po duam të krijojmë konfuzione. Unë insistova edhe më herët, prandaj ndodhi ajo çudia e dy votimeve. Precizoni problemet, a do të ketë lexim të dytë sot, apo tjetër ditë? Tregonu deputetëve, sepse deputetët nuk po e kuptojnë çka po ndodhë! Nëse ka shpejtim të tillë, mund të kërkonin nga deputetë që në leximin e parë të mos harxhojnë shumë kohë. Atë mund ta bëni. Por nëse nuk është ajo, ju s'keni të drejtë askujt t'i thoni mos ta marrë fjalën, qofshin 3 orë, qofshin 15 orë.

Prandaj, është mirë që problemet të sqarohet bukur, të dihet sa është leximi i parë, a do të jetë leximi i dytë para të 26-it, sepse keni kujdes, kërkesa e qartë e Kryeministrit në formë të shkruar na vjen në Parlament që është mirë para të 26-it të shkojë te Përfaqësuesi Special. E artikuluar nga zëvendëskryeministri sot ishte që buxheti të jetë i aprovuar para 1 marsit. Këto ne i dëgjuam me shkrim dhe me gojë. Të precizojmë a është sot leximi i parë dhe leximi i dytë. A do të mbledhet Kryesia dhe ta caktojë në një ditë tjetër, të tregohet. Nëse është lexim i parë, ka të drejtë çdo deputetë të flasë. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Hamiti për përpjekjen për t'u sqaruar. Më duket që të gjithë deputetët e dinë se qëllimi është që sot t'i kalojmë të dy leximet. Pas pauzës, e cila do të bëhet, nëse seanca e re do të hapet dhe qëllimi ynë është që të mësohemi të punojmë më gjatë, me procedurë më të përsheptuar në mënyrë që t'i realizojmë obligimet tona. Për atë arsye edhe e thashë, për atë arsye është votuar që të ndryshojë, do të thotë t'i shmangemi procedurës së Rregullores sot. Mendoj që nuk ka asgjë të keqe që ua përkujtova deputetëve dhe unë nuk jam ai që mund t'ua marrë fjalën, nuk jam ai që mund t'ua shkurtoj afatin e diskutimit, por vetëm ua tërhoqa vërejtjen. Faleminderit!

Për fjalë është paraqitur Fatmir Rexhepi.

FATMIR REXHEPI: Përsëndetje! Faleminderit, zoti kryesues!  
Përsëndetje për kolegët deputetë,  
Kryeministrin dhe qeverinë,

Më lejoni që në këtë debat të jap vlerësimet dhe sugjerimet e mia si deputet lidhur me draftbuxhetin e ofruar nga Qeveria e vendit. Që në fillim them se i jap përkrahje në parim këtij draftbuxheti, sepse në pjesën më të mirë të saj përmbush synimet programore të cilat kanë qenë edhe projekt i vet Qeverisë, përmbush sidomos të hyrat e planifikuara përmes të cilave do të realizohen edhe financimi i veprimtarive të institucioneve shtetërore, sepse kemi një rritje të dukshme në krahasim me vitin e shkuar. Në mënyrë të veçantë përmbush synimet të pjesa e investimeve kapitale prej 371 milion, të cilat pra, me pjesëmarrjen e tyre në buxhet do të mundësojnë dhe do të shkojnë në funksion të zhvillimit dhe të ndërtimit të infrastrukturës, por edhe të vetë rritjes ekonomike. Ndoshta nuk përmbush atë pjesën tjetër tek të ardhurat sepse për vetë Qeverinë do të jenë sfida e madhe kërkesat që do të shtrohen pas pavarësimit të vendit, kur kemi në pyetje pagat dhe mëditjet për institucionet dhe punëtorët në sektorë të ndryshëm dhe me këtë sfida mendoj që do të ballafaqohet Qeveria, por kjo i mbetet, do të thotë, fazës tjetër.

Nga ajo që e tha Kryeministri, ekspozë, gjegjësisht ftesa për debat, unë do të veçoj me këtë rast dhe do të shfrytëzoj rastin që të shpreh mospajtim për disa sektorë, sidomos në fushën e investimeve, apo ndarja jo e drejtë e mjeteve për investime kapitale në tri fusha të cilat do t'i përmendi, si në vijim:

Vërejtja ime e parë parimore ka të bëjë me investimet e programuara në sferën e arsimit, gjegjësisht në objektet shkollore. Unë mendoj që shuma prej 35.400.000 euro, përveç ristrukturimit të planifikuar mendoj që këtu është dashur të përfshihet edhe një objekt shkollor në komunën e Gjilanit, sidomos në qendër të qytetit për faktin se mësimi zhvillohet në 4 ndërrime dhe besoj se të rralla janë qendrat e qyteteve në Kosovë ku kemi aq numër të madh të nxënësve dhe mendoj, në qoftë se ka mundësi, kjo të ndryshohet dhe të kemi financimin, gjegjësisht planifikimin edhe të një objekti në qendër të qytetit.

Një mospajtim tjetër në parim do ta kisha shprehur lidhur me investimet e planifikuara për ujë dhe sistemet e furnizimit. Unë mendoj që fondi prej 2.800.000 eurosh është shumë i vogël. Për të gjitha qendrat e vendit tonë, aftësimi dhe rehabilitimi i rrjetit është i domosdoshëm. Unë mendoj se duhet të shikohen disa qytete në vendin tonë, të cilat

kanë pasur krizë më të madhe me ujë. Janë vitet që kanë ikur dhe nëse ju kujtohen edhe Ferizaj, edhe Suhareka, edhe Gjilani, edhe Vushtrria, ndoshta edhe qytetet tjera, pra për mos rehabilitimin e rrjetit në mungesë të burimeve, në qoftë se 100 litra ujë në sekondë ka qenë burimi ,ato 50 deri 60% janë humbur për shkak të rrjetit dhe nuk kanë mundësi, pra, të kenë furnizim të mjaftueshëm, prandaj krizat janë paraqitur. Unë mendoj që në këtë sektor duhet të ketë një fond më të madh të mjeteve në mënyrë që të investohet ose të fillohet me disa nga investimet në nyjat kryesore të cilat do t'i ndihmonin këto qytete.

Po ashtu vërejtja ime në parim ka të bëjë edhe me një projekt që e ka harruar Kryeministri bashkë me kryetarin e Gjilanit, që e ka të partisë së vet, bashkë me mua që jam deputet i Gjilanit. Atë që e kemi folur çdo ditë atje me qytetarët e Gjilanit lidhur me ujërat e zeza, i kemi filluar fushatat atje dhe i kemi mbaruar me premtime se diçka do të bëjmë për këtë qytet, gjegjësisht për qytetarët e Gjilanit. Janë 3-4 vite që ky problem është i pranishëm në atë shkallë sa pasojat do të jenë të mëdha. Me ardhjen e sezonit veror unë kujtoj që atje edhe era edhe epidemia edhe gjithçka do të jenë të pranishme në atë qytet të Gjilanit. Kështu që ndarja e një pjese të mjeteve në shumë prej 1 milion e 200 a 300 mijë euro për një fazë emergjente, jo për të rregulluar krejt sistemi, se ai kushton 5-6 milion, është më se e domosdoshme. Dhe unë mendoj që këtë ftesë t'ia bëjë Kryeministrit që këtë ta ndryshojë gjatë asaj pauze që parashihet.

Vërejtja ime e fundit parimore ose mospajtimi im si deputet ka të bëjë me pjesën e investimeve në infrastrukturën e rrugëve. E lus Kryeministrin edhe ministrin e Transportit, zotin Limaj, që ta marrë tabelën para vetes dhe në qoftë se e kanë, të shikojnë se si është bërë planifikimi dhe ndarja e këtyre mjeteve, ku janë paraparë afërsisht 121 milion euro ose 90 milion euro për këtë vit dhe pjesa tjetër për vitet që janë këtu vitet 2009 dhe 2010. Aty është rruga Prishtinë – Kaçanik, rruga Prishtinë – Pejë, Prishtinë – Mitrovicë, Prishtinë – Mutivodë dhe ndërtimi i rrugëve të reja në bashkëpunim me komunat dhe fondi tjetër. Po ta analizoni këtë çka është shkruar këtu, atëherë unë e kisha lutur edhe Kryeministrin, edhe ministrin që ta bëjnë një korrigjim të domosdoshëm. Kjo tregon se 1/3 e territorit të Kosovës për vitet në vijim nuk e ka asnjë investim. Gjeografi, pra, prej Prishtine në perëndim, prej Prishtine në jug, prej Prishtine në veri është krejt në rregull dhe unë e përkrah atë pa asnjë dilemë. Por, të harrohet pjesa lindore e vendit pa asnjë investim, unë ju kisha lutur ta merrni e ta shikoni dhe në qoftë se nuk është kështu, unë ju kërkoj falje. Të ndodhë që asnjë aks rrugor prej Prishtine në Gjilan, prej Ferizaji në Viti, prej Gjilani në Kamenicë ose edhe kur i shtohen kësaj me mijëra qytetarë që vijnë nga Presheva e Bujanovci dhe në këto arterie rrugore të mos planifikohet asgjë në këtë strategji të ndarjes së mjeteve, mendoj që është me pasoja politike, ekonomike dhe zhvillimore. Unë besoj që mund ta korrigjoni këtë. Nuk do të kemi të drejtë morale as Kryeministri as unë, as ministri ta marrim rrugën për atë drejtim në qoftë se kjo nuk ndryshon. Nuk jam lokalist, por merreni dhe shikoni se unë kujtoj që është një gabim. Nuk kemi të drejtë ne përderisa me mijëra qytetarë ose biznese kontribuojnë në buxhetin e Kosovës me miliona, qoftë nga të hyrat e brendshme, qoftë nga të hyrat kufitare, të mos kenë një rrugë nesër të ndërtuar ose të rehabilituar që është planifikuar deri në vitin 2010. Jemi në koalicion qeveritar, unë ju bëjë thirrje juve që brenda asaj pauze ta ndryshoni, përndryshe sinqerisht po ju them se as ju, as unë s'kemi çka kërkojmë si deputetë as si qeveritar në atë trevë të territorit tonë.

Unë mendoj që ftesa që e bëri Kryeministri korrespondon me kërkesën time të tashme. Urdhëroni dhe korrigjoni, mendoj që keni mundësi, prandaj ju bëj ftesë që të korrigjohet kjo. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zotëri deputet!

Sa për saktësim dua t'ju njoftojë lidhur me paqartësinë që u duk që ishte dhe interpretimi që e ka bërë Kryetari i Parlamentit, meqenëse u konsultova edhe me procesmbajtësit, dua t'ju them decidivisht se si e ka thënë Kryetari.

Pas miratimit të shmangies nga procedura e Rregullores, decidivisht e ka thënë: "Ju njoftoj se pas miratimit të kësaj shmangie procedurale vazhdojmë me procedimin e shqyrtimit të parë të Projektligjit për buxhetin e Kosovës për vitin 2008". Ndërsa në seancën e radhës, që do të mbahet sot pas pauzës, do të procedohet me shqyrtimin e dytë të Projektligjit për buxhetin e Kosovës për vitin 2008. Tani më lejoni që me kërkesë të Qeverisë, të ministrave dhe të Kryeministrit, t'i shpall 15 minuta pauzë në Kuvend. Faleminderit!

KRYESUESI XHAVIT HALITI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Zef Morina.

ZEF MORINA: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuari Kryeministër, ministra,  
Kolegë deputetë,

Nëse bëjmë një analizë të projektbuxheteve të viteve të kaluara, gjegjësisht të qeverive të kaluara, mendoj që ky projektbuxhet është shumë më i avancuar dhe shihet se dita ditës institucionet shtetërore po e marrin formën ashtu si kërkohet.

Mendoj që është për t'u lavdëruar për shumë gjëra, por ato që unë i kam fokusuar kanë të bëjnë, pikërisht, me ndarjen e mjeteve, duke pasur parasysh që mjetet e buxhetit, gjegjësisht të taksapaguesve, të qytetarëve, janë orientuar kryesisht në investime kapitale. Mendoj që ky është një sinjal shumë i mirë që, vërtet, taksapaguesve do t'u kthehen mjetet në një mënyrë ashtu si kërkohet, që të kenë një jetë më të lumtur dhe vërtet edhe Kosova të jetë në një nivel shumë më të lartë të zhvillimit në përgjithësi.

Vërejtjet e mia janë kryesisht në projektbuxhetet të cilat janë përcjell nga agjencitë rregullative, për shembull nga KPMM, Zyra e Rregullatorit të Energjisë, ART, e kështu me radhë. Sikur këto agjencione bëjnë pjesë jashtë kornizave apo jashtë faktorëve të përcaktuar të vetë Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe të institucioneve të Kosovës. Ne edhe në komisionin funksional e kemi biseduar. Vërejtjet të cilat ne i kemi dhënë në Komision kanë qenë, ndoshta, vështirë të inkorporohen, por është mirë t'i themi këtui dhe në këtë mënyrë të mos bëhet praktikë që në të ardhmen të përsëritet e njëjta gjë. Vërejtje kryesisht janë dhënë lidhur me mënyrën e shpërndarjes së mjeteve dhe fokusimin e tyre kryesisht në paga dhe mallra e shërbime. Marrim si shembull Zyrën e Rregullatorit të Energjisë ku janë të punësuar 33 punëtorë. Vetëm për paga kërkohen rreth 400 mijë euro, që donë të thotë, në mesatare i bie mbi 1.100 euro për një punëtor.

Ne e dimë që nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës sa është mesatarja e të ardhurave për një nëpunës apo për një punëtor të këtyre agjencioneve.

E njëjta gjë vlen edhe për ART dhe KPMM. Ajo që më shqetëson më shumë është ndarja apo kërkesa për mallra dhe shërbime. Në të vërtetë, edhe qëndrimi i Qeverisë është që këtu të limitohet sa më shumë, duke pasur parasysh se për çdo vit, pothuaj se secila agjenci apo secila ministri nga viti në vit ndërron, qoftë mobile, qoftë automjete, qoftë gjëra të cilat mendoj se janë të panevojshme. Si shembull po marr ART-në, ku kërkohet që për mallra e shërbime të shpenzohen mbi 400.000 euro, që janë sa dy herë pagat e këtyre punëtorëve. Për këta 30 punëtorë kërkohen 222.000 euro, ndërsa për mallra e shërbime 400.000 euro. Këto janë vërejtje, të cilat ne në Komision i kemi bërë, por nga Komisioni i Buxhetit nuk janë përfillur sa duhet. Unë mendoj, duhet të kemi kujdes, të bëhet një rivlerësim ose të merret një qëndrim që së paku, pagat dhe mjetet të cilat përdoren për këto gjëra të jenë në koordinim me të gjitha pagat që bëhen nga ministratë dhe Qeveria.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Sylja, le të përgatitet Agim Veliu.

GJYLNAZE SYLA: I nderuari zoti kryesues,

I nderuari zoti Kryeministër, ministra,

Deputetë të nderuar,

Jam veçanërisht e privilegjuar për të diskutuar për një detyrë të rëndësishme, siç është shqyrtimi i Projektligjit për buxhetin e Kosovës për vitin 2008. Që në fillim dëshiroj të theksoj rëndësinë e madhe që ka buxheti për kualitetin e jetës së qytetarëve në Kosovë. Krahësuar me buxhetin e kaluar, buxheti i 2008-ës ka 300 milionë më shumë. Do të thotë, buxheti i tërësishëm, siç e tha edhe Kryeministri, është 1 miliard e 27 milion euro. Kjo është shumë e kënaqshme, por jo e mjaftueshme për nevojat të shumta që i ka populli i Kosovës.

Nga materiali i ofruar vlerësoj se nuk ka ndonjë ndryshim nga drafti i buxhetit të hartuar nga Qeveria e kaluar, ashtu siç pretendon Qeveria e tashme se ka një rritje të buxhetit prej 44 milionë eurosh. Në të vërtetë, ka vetëm planifikim për rritjen e të hyrave për 44 milionë euro, me çka zvogëlohet deficitin që ishte paraparë nga Qeveria e kaluar, kurse buxheti mbetet i njëjtë. Prandaj, këtë buxhet e kam emëruar- buxhet pa efekt.

Ky emërim është relevant, meqë buxheti i Qeverisë tregon se si Qeveria planifikon t'i shfrytëzojë resurset e saj, pa objektivat e politikave të saj. Çka do të thotë kjo? Nga njëra anë, Qeveria deri më sot nuk ka paraqitur programin e saj qeverisës edhe pse, sipas rregullave në fuqi, që në ditën e zgjedhjes së saj është dashur ta paraqesë para Kuvendit të Kosovës Programin e Qeverisë. Prandaj, si mund të ketë parashikim apo rishikim dhe menaxhim të mirë të buxhetit pa definimin e politikave paraprake dhe të prioritetëve përkatëse të secilit sektor qeveritar? Mungesa e programit qeveritar e pamundëson realizimin e ndryshimeve të shpejta që sot janë të nevojshme. Nga ana tjetër, në bazë të pasqyrave të paraqitura në Projektligjin për buxhetin për vitin 2008 del se të hyrat janë,

kryesisht, nga doganat. Më saktë, të hyrat nga tatimet janë 752,26 milion euro. Nga këto mjete, të mbledhura kryesisht në kufi janë diçka më shumë se 561.000.000 euro, kurse tatimet e brendshme 204.000.000 euro. Kjo tregon se buxheti nuk siguron qëndrueshmërinë ekonomike dhe financiare.

Duke i shqyrtuar me kujdes pasqyrat e paraqitura buxhetore, kam tri vërejtje kryesore të përgjithshme.

E para, unë thjesht nuk po shoh në këtë buxhet objektiva të Qeverisë. Pra, nuk ka koncept për rritjen e buxhetit ose për përdorimin e dobishëm të tij. Objektivi tjetër, pos krijimit të perceptimit se po bëhen ndryshime të mëdha, nuk po shoh këtu.

E dyta, nuk po shoh ulje të theksuar të shpenzimeve të administratës, që do të ndikonte në riorganizimin buxhetor, e me këtë s'ka as konsolidim.

E treta, nuk parashihen financime për projekte zhvillimore. Si mund të ketë rritje të ekonomisë dhe zgjerim të bazës buxhetore nëse nuk ka investime? Këtu shquaj projektet e agrobiznesit dhe të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Të nderuar deputetë.

Më këtë rishikim unë vlerësoj se janë bërë tri ndryshime kryesore. Njëri është rritja 7 milionë euro për KEK-un; 6 milionë euro për arsim dhe për infrastrukturën rrugore 14.600.000 euro, që natyrisht ne e përgëzojmë Qeverinë për këtë hap. Mirëpo, a është e mjaftueshme kjo? Lidhur me këtë, unë do t'i shtroj tash vërejtjet e veçanta në tre sektorë, në sektorin e edukimit, të shëndetësisë dhe të buxhetit të AKM-së.

Edhe pse është paraparë një rritje e pagave të arsimtarëve, shtrohet pyetja se a është kjo e mjaftueshme në një kohë kur na presin sfida aq të mëdha dhe kur duhet të ketë të rinj të cilët do të jenë mjaftueshëm të përgatitur për investimet e reja dhe kur duhet të zhvillohet kreativiteti i shoqërisë. Po ashtu kjo është e nevojshme për shkak të qëllimit të anëtarësimit në organizatat dhe institucionet ndërkombëtare financiare si: Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar. Nuk ka rritje të pagave të personelit mjekësor dhe ju e dini se në qoftë se nuk ruhet shëndeti nuk ka as punë dhe pëson ekonomia, në qoftë se numri i të sëmurëve është më i madh. Me fjalë të tjera, do ta përmbledh në një vërejtje: mungon alokimi i fondeve për investime në arsim dhe shkencë, si dhe në grante konkurruese në fushën e arsimit dhe të shëndetësisë.

Duke rritur të ardhurat, rriten mundësitë e punësimit. Nuk ka mënyrë se si do të përmirësohet kualiteti i jetës së qytetarëve të Kosovës, prandaj çështjen e programit të qeverisë dhe të politikave të sektorëve të veçantë duhet kuptuar si nevojë dhe çështje urgjente. Sa i përket AKM-së, në qoftë se e hapni materialin do të shihni se thotë që janë 2 të punësuar, kurse buxheti i ndarë i AKM-së është 92.741.000.euro. Konsideroj se ne si Kuvend asnjëherë nuk e kemi pasur raportin e Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit, vazhdimisht i kemi ndarë parat për Agjencionin, kurrë nuk e kemi ditur si janë shpenzuar meqë nuk ka pasur raport. Prandaj, mendoj se Qeveria duhet ta marrë në konsideratë këtë

dhe t'i alokojë këto fonde në arsim dhe shëndetësi, aty që është prioritarë deri në momentin që AKM-ja do t'ia dorëzojë raportin Kuvendit se si i ka shpenzuar të hollat.

Zyra e Kryeministrit ka 5.057.000 euro, nga të cilat 3.474.000 janë për mallra dhe shpenzime, ose më saktë 3.065.000 Zyra e Kryeministrit, kurse shpenzimet kapitale 200.000.

Unë e dëgjova me shumë vëmendje ministrin e Ekonomisë dhe Financave, që tha, nëse e kam kuptuar mirë, diku 1 milionë janë paraparë për të gjitha ato shpenzimet që i përmendi. Unë kishar dashur ta di ku do të shkojnë 2 milionë të tjera, meqenëse jam përpjekur t'i gjejë në këtë pasqyrë, por nuk i kam gjetur.

Prandaj, në fund, për shkak të të gjitha vërejtjeve që i përmenda, konsideroj se nuk arrihen objektivat, pasi objektivat nuk janë paraparë dhe nuk do ta votoj buxhetin. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Fjalën e ka deputeti Agim Veliu, le të përgatitet Besa Gaxherri.

AGIM VELIU: Faleminderit, kryesues!

U tha këtu edhe nga parafolësit se buxheti është dokumenti më i rëndësishëm vjetor që miraton Kuvendi i Kosovës, i cili mundëson funksionim normal të institucioneve dhe të shtetit në përgjithësi, për çka unë pajtohem. Mendoj që secili nga deputetët duhet të angazhohet që të miratohet sa më shpejtë dhe sa më mirë. Po ashtu, u tha se nuk ka ndryshime të mëdha në strukturën e shpenzimeve, çka do të thotë se ka. Pajtohem që nuk ka ndryshime në atë shumën totale të buxhetit si ka qenë e projektuar kjo edhe nga Qeveria e kaluar, por është një fat i mirë që ky buxhet i këtij viti është më i madh dhe sigurisht Qeveria do të ketë mundësi të realizojë projekte më tepër sesa në të kaluarën, që unë mendoj se është mirë dhe është një përparim.

Po ashtu, një prej parimeve gjatë hartimit të buxhetit, u tha, është shpërndarja e drejtë e buxhetit, i cili parim unë nuk po shoh se është respektuar. Unë po e përmendi vetëm shpërndarjen që e ka bërë Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për investime kapitale. Kolegë deputetë, merreni listën e shpërndarjes së projekteve të infrastrukturës dhe do ta shihni se çfarë shpërndarje është bërë. Sigurisht, ju këtë e keni në material dhe nuk e di dhe nuk jam i sigurt se për këtë kohë kaq të shkurtër a janë respektuar procedurat e kërkuara për përzgjedhjen dhe futjen e një projekti në listën e investimeve kapitale, sepse atje sigurisht kërkohen disa kushte, disa kritere. Duhet që të jetë një lokacion, duhet që të merret një leje ndërtimi. Po ashtu duhet që të ekzistojë një projekt për ndërtimin e shkollës, e tjera e tjera, për çka besoj se Ministria këto i ka parasysh.

Po ashtu, u përmend edhe një shumë prej 6 milionësh për ngritje të pagave. Unë mendoj se kjo shumë duhet të sqarohet. Është fjala për rritjen e pagave që ka ndodhur në vitin e kaluar prej shtatorit dhe kjo shumë prej 6 milionësh është shumë e cila garanton pagesën e kësaj rritjeje për këtë vit, kështu që të mos kemi ndonjë paqartësi, kjo është ajo rritja që ka ndodhur vitin e kaluar.

Nuk e vërejta se a ka hyrë blerja e teksteve falas, ashtu si e kërkon Ligji për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit prej klasës së parë deri në klasën e pestë. Në lëmin e trajtimit të ujërave të zeza, do të ishte mirë Qeveria të mendoj, të ketë parasysh projektin për pastrimin e ujërave të zeza në liqenin e Batllavës, sepse liqeni është furnizuesi me ujë të pijes për disa komuna dhe ai liqe, sigurisht, edhe ju keni informacione se me të madhe është i rrezikuar nga ndotja.

Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit. Deputetja Besa Gaxherri, le të përgatitet Adem Salihaj.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Shumë të nderuar kolegë deputetë,

Zoti Kryeministër me Kabinetin tuaj,

Tash, diskutimi, pasi që votuam për ndryshimin në procedurë, po i bie si të shkruash në akull e ta kthesh prej diellit, po megjithatë unë ndiej obligim ndaj votuesve e mi që ta them mendimin tim. Zoti kryeministër, që të gjithë e kemi parasysh situatën aktuale politike dhe ndoshta historike që po kalojmë. Por, ju lutem, ky proces nuk fillon në muajin shkurt 2008. Unë nuk mund ta arsyetoj kurrësi thyerjen procedurale që edhe buxheti, një dokument shumë i rëndësishëm, krucial për Kosovën, të miratohet me këtë procedurë të këtillë dhe nuk mund të pajtohem që duhet të hymë ta aprovojmë buxhetin e konsoliduar të Kosovës ku Qeveria ende nuk ka sjellë programin e vet. Ne nuk e dimë realisht, vetëm gjatë fushatës çka kemi dëgjuar, se çka keni planifikuar apo vërtet këto janë në kundërtënie me vetë fushatën e juaj me këtë buxhet të cilin ne e kemi pasur krejt 2-3 ditë në duar, apo kemi pasur mundësi ta shqyrtojmë. Pse duhet të vijmë në këtë situatë që të thirremi në pavarësi dhe ta miratojmë buxhetin pa e shqyrtuar dhe kujt po i konvenon kjo? Ligji, siç e thashë, pra, i buxhetit të Kosovës, që ka të bëjë me parane publike të Kosovës, po shqyrtohet sot në Kuvend duke shkelur të gjitha procedurat ligjore. Natyrisht, kjo materie i ka mbi 200 faqe që është dashur të studiohen mirë. Komisioni i Buxhetit u takua dy ditë dhe të jam e singërtë që ne nuk kemi hyrë fare ta shqyrtojmë si material, por kemi shkuar krejt në parim me shumicë votash kanë ardhur disa amendamente që janë sot këtu.

Kjo materie, apo ky material ka ardhur pa tabelën e buxhetit, domethënë pa dokumentin e rishikimit të vitit 2007, por edhe pa dokumentin i cili na jep të kuptojmë se çfarë ndryshimesh apo ndërhyrjesh janë bërë në materialin që e kishte lënë të hartuar ish-Qeveria, pra, për buxhetin e vitit 2008. Nuk kemi pasur një dokument, as ta shohim, bile për së shpejti, pasi që është procedura shumë e shkurtuar, për të parë se çka është ndryshuar prej atij buxheti në këtë buxhet.

Unë nuk dua t'ju marr kohë kolegë të nderuar, sepse tashmë diskutimi nuk ka kuptim të hyjmë nëpër secilën vijë buxhetore, por ta keni parasysh se vetë Komisioni i Buxhetit nuk ka mund ta shqyrtojë qysh duhet këtë material, apo këtë buxhet. Unë vetëm po e theksoj buxhetin e gjithmbarshëm 1.027.000.000. Ta keni parasysh në kuadër të këtij buxheti që është ndarë për tri shtylla – organizatat buxhetore, pra institucionet e përkohshme qendrore, në organizatat buxhetore të fuqive të rezervuara dhe për

organizatat buxhetore të komunave. Ta keni parasysh që prej 1.027.000.000 vetëm 184 milionë euro ndahen për kuvendet komunale. Në kuadër të këtyre mjeteve, vetëm 43 milionë e 900 e diçka euro janë investime kapitale për kuvendet komunale. Dhe, natyrisht, 664 milionë e 562 euro për organizatat buxhetore të institucioneve qendrore dhe 205 milion e 599 euro për organizatat buxhetore të fuqive të rezervuara. Kjo jep për të kuptuar se qysh e kemi orientuar buxhetin e Kosovës dhe çka është bërë ndryshim gjatë kësaj kohe.

Krejt në fund, dua t'i siguroj qytetarët e Kosovës se në këtë projektbuxhet nuk parashikohen premtimet e fushatës parazgjedhore, siç ishin: ulja e tatimit, ngritja e pagave, subvencionet në bujqësi, implementimi i kontratës kolektive e shumë premtime të tjera. Fatkeqësisht, edhe në këtë buxhet KEK-ut i dhurohen 97 milionë euro, AKM-së mbi 100 milionë euro, pa sqaruar dhe pa na ardhur asnjë projekt konkret se pse ndahen këto mjete nga buxheti, nga taksat e qytetarëve të Kosovës. Unë nuk kam, ose thashë edhe më herët, nuk dua të hyj tash për secilën organizatë buxhetore apo vijë buxhetore, por ne e kemi ditur edhe më herët se një buxhet i tillë nuk ka mundësi për t'u ndryshuar, sepse analizat makrofinanciare nuk kanë lejuar, bile-bile unë po them se edhe për 3-4 vjet s'ka mundësi të ndryshohet një buxhet i tillë. Por, t'ju them të vërtetën edhe unë si ekonomiste, kur dëgjoja për të gjitha ato projekte që na i keni thënë gjatë fushatës, nisja të pyesja veten, athua paska ndonjë mundësi që unë s'po e dija se mund të realizohen këto. Andaj, unë mendoj se duhet të flasim shumë më pak, të veprojmë më shumë dhe të jemi më korrekt dhe më konkret me qytetarët e Kosovës.

Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Adem Salihaj, le të përgatitet deputetja Safete Hadërgjonaj.

x

ADEM SALIHAI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Ne i kemi 35 ditë prej ditës kur është zgjedhur kjo Qeveri dhe i kemi 71 ditë prej ditës kur janë certifikuar zgjedhjet dhe ende s'e kemi programin e kësaj Qeverie para nesh. Në fakt, këtu tashmë po fillon ndërtimi i një bazamenti të një godine shumë të rëndësishme, ndërkohë që nuk e kemi projektin dhe vizionin e asaj godine, e ky do të ishte programi i Qeverisë së Kosovës. Ky projekt i buxhetit nuk dallon aq nga ato të qeverive të mëparshme. Unë kam përshtypjen sikur këtë projektbuxhet e ka hartuar Qeveria e mëparshme dhe jo kjo e tashmja. Ne dëgjuam këtu dy ekspozë të dy ministrave të financave dhe unë jam shumë kureshtar ta di cili është vërtet autori i vërtet i këtij projektbuxheti. Mendoj se Qeveria është tepër e preokupuar me improvizime dhe një prej atyre improvizimeve është edhe miratimi i këtij projektbuxheti sot, me një procedurë shumë të shpejtë dhe të shkurtuar dhe nuk po merret shumë me çështjet esenciale që i takojnë asaj, para se gjithash, me programin e saj.

Sa i përket Projektit të buxhetit, në projekte të veçanta të ministrive shihet se ka favorizime të mëdha të rajoneve dhe po vazhdon ajo tradita e madhe që secili ministër t'i orientojë investimet në rajonin e tij. Unë dëshiroj të bëj vërejtje veçanërisht për rajonin e

Ferizajt në sferën e arsimit dhe infrastrukturës rrugore, sepse ka tepër pak investime. Janë paraparë pak investime për shkolla, por, sigurisht, gjendja më e keqe e shkollave në Kosovë është në Ferizaj, ku ka diçka, përafërsisht, gjysmë metri katror për nxënës dhe ora mësimore zgjatë vetëm 30 minuta. Mendoj se është dashur të merret parasysh kjo dhe të punohet pak më tepër në përmirësimin e kësaj infrastrukture. Në infrastrukturën rrugore ka edhe më pak investime, e të mos flas për probleme të tjera. Ferizaj ka problem tepër të madh me ujë dhe, me sa kam parë unë, nuk ka asnjë lloj investimi në atë drejtim.

Nuk e gjeta këtu projektin e madh të Partisë, që është në pushtet, për pajisjen e shkollave me kabinete të informatikës. Unë i propozoj Kryeministrit që ato fotografitë e bukura që ishin gjatë fushatës t'ua dërgojë shkollave që së paku ta shohin si duhet një kabinet i informatikës. Ne, ndoshta, mund ta votojmë këtë buxhet, por do ta votojmë jo pse ju keni bërë një punë shumë të mirë, por pse na keni zënë në zgrip kohor dhe ndërgjegjja jonë nuk lejon që të krijojmë mundësi të ngecjes së procesit të madh që e kemi përpara.

Dhe, në fund, kam edhe një propozim. Në vend të dy leximeve që po ia bëjmë sot, në këtë formë, ne sot t'ia bëjmë 3 lexime këtij buxheti dhe secili ta shoh që ne jo vetëm që i respektojmë të gjitha procedurat, por jemi në gjendje t'i tejkalojmë edhe ato.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Safete Hadërgjonaj, le të përgatitet Lutfi Haziri.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuari zoti Kryeministër,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Në fillim desha të them që kjo procedurë e shpejtuar që u bë sot për miratimin e buxhetit për arsye të cilat i dhanë shumë mirë anëtarët e Kabinetit qeveritar, nuk po ndodh për herën e parë, për arsye se ne një procedurë të tillë e kemi përdorur edhe me rastin kur kemi miratuar buxhetin e vitit 2006, domethënë në dhjetor të vitit 2005. Domethënë, kemi shkuar me një procedurë të shpejtuar në miratimin e buxhetit, prandaj nuk është hera e parë, është edhe një herë tjetër që është përsëritur dhe është hera e dytë që ne për shkakë, kuptohet, të arsyeshme, po shkojmë me procedurë të shpejtuar.

Vendimet të cilat i ka marrë Kryeministri dhe Qeveria që të kontrollohet çdo rrjedhë e parasë së shpenzuar nga pushteti qendror dhe lokal, janë një sinjal i fuqishëm se po bëhet një shkëputje nga arroganca e shfrytëzimit të mjeteve për luks qeveritar. Po bëhet një shkëputje nga sistemi i shpërdorimit të parave të taksapaguesve dhe po vihen bazat e një sistemi të mirë të menaxhimit të mjeteve. Rivlerësimin, që e ka bërë Qeveria, ka dhënë shenjat e para se buxheti do të orientohet në zhvillimin e vendit, se buxheti do të jetë në favor të mirëqenies dhe se me politikat e saja buxhetore do t'i japë fund keqpërdorimit, keqmenaxhimit dhe korrupsionit. Vetë fakti i fokusimit të buxhetit në investime kapitale, ku nga 189 milionë euro të planifikuara në vitin 2007 këto investime janë rritur në 371 milionë euro në këtë vit, si dhe orientimi i mjeteve për ndërtimin dhe rindërtimin e shkollave, në ndërtimin e infrastrukturës, do të thotë se kjo Qeveri do të angazhohet dhe do të investojë në të tashmen, por edhe në të ardhmen e Kosovës dhe mjetet do të orientohen vetëm drejt qytetarëve, e jo më për individët dhe grupet e interesit.

Rritja e buxhetit në Ministrinë e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit nga 35 milionë euro në 101 milionë euro dhe rritja e shpenzimeve kapitale nga 24 milionë euro në 89 milionë euro, tregon vendosmërinë e Qeverisë për t'i bërë realitet prioritetet e veta programore. Apo rritja e buxhetit në Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe Teknologjisë nga 33 milionë në 53 milionë, e sidomos rritja e shpenzimeve kapitale nga 16 milionë në 35 milionë euro, është tregues i mjaftueshëm se Qeveria do të realizojë premtimin e saj që nxënësit më nuk do të mësojnë në kontejnerë dhe pa mjete të nevojshme për punë.

I përmenda vetëm këto dy raste për të theksuar se politikave të verbëta që kanë reflektuar në uljen e efikasitetit ekonomike, në zhvillimin e ulët të kapaciteteve njerëzore dhe në cilësi të ulët të jetës, gradualisht do t'u vije fundi. Desha të theksoj edhe një gjë, sepse u diskutua këtu shumë rreth asaj rritjeje që është bërë për 6 milionë të shpenzimeve tek mallrat dhe shërbimet dhe unë dua t'ua rikujtoj deputetëve që të shikojnë rritjen e shpenzimeve për 2.500.000 euro, pikërisht në Ministrinë e Shëndetësisë për vetë faktin që qytetarët tanë të mos mbesin pa mjete dhe pa barna esenciale, problem me të cilin jemi ballafaquar me vite të tëra.

Jam e bindur se me një qasje të re të menaxhimit të financave, që ka filluar Qeveria, ne do të kemi mundësi që me rastin e rishikimit të buxhetit të jemi dëshmitarë të një rritjeje të performancës së Qeverisë në mbledhjen e tatimeve dhe taksave, do të kemi një rritje të buxhetit, e cila do të pasohet nga rritja e shpenzimeve publike, si rritja e investimeve, mbështetja sociale që gradualisht do të reflektohet edhe në rritjen e pagave në arsim, shëndetësi, të pagave të TMK-së, të policisë, e të tjera.

Koha e shkurtër që ka pasur Qeveria në dispozicion për të bërë rishikimin e buxhetit është e kuptueshme, që çdo gjë nga buxheti, i cili është hartuar, pothuaj se gjatë një viti, të ndryshohet në tërësi dhe t'u përshtatet politikave programore të Qeverisë së re. Megjithatë, po vërehet që Qeveria po ecën me hapa të matshëm për t'i luftuar dukuritë negative, keqmenaxhimin, keqpërdorimin, sidomos keqpërdorimin e mjeteve në ndërmarrjet publike. Ndarja e mjeteve për AKM-në dhe sidomos orientimi i mjeteve në ndërmarrjet publike, në KEK, në ujë e mbeturina, në ngrohje qendrore, nuk konsideroj se është bërë në mënyrë të arsyeshme, sepse asnjë nga këto ndërmarrje nuk ka reflektuar pozitivisht në kryerjen e shërbimeve në favor të qytetarëve dhe si pasojë e kësaj qytetarët janë detyruar të paguajnë fatura të dyfishta.

Hapat e guximshëm që po i bën Qeveria në luftë kundër aferave korruptive, mbeten obligim dhe detyrë e Qeverisë t'i vazhdojë edhe në luftë kundër evazionit fiskal, ekonomisë informale dhe kontrabandës që do të reflektojnë dukshëm në rritjen e buxhetit. Unë konsideroj se ky buxhet duhet miratuar dhe ne t'i japim mundësi Qeverisë që t'i realizojë projektet e veta programore dhe të reflektojë pozitivisht në jetën e qytetarit të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Lutfi Haziri, le të përgatitet deputeti Xhevdet Neziraj.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Zoti Kryeministër, anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Ajo që po diskutohet nga disa kolegë tonë me fjalor, kryesisht, le të themi edhe të publikut, por kryesisht që vijnë si gjenerim i mediave dhe i proceseve në të cilat ka kaluar Kosova edhe përmes procesit të fundit zgjedhor, mendoj që ky Kuvend duhet ta ruajë autoritetin dhe ta përdorë edhe terminologjinë që është adekuate, qoftë ajo edhe lidhur me debatin për buxhet. Procesi buxhetor në Kosovë, sipas ligjit në fuqi, fillon në fund të muajit shkurt dhe kësaj here na ka zënë në zgrip, sepse ne po e miratojmë një buxhet të domosdoshëm për shkak të procesit që ka kaluar Kosova dhe ministri i Ekonomisë dhe Financave do të jetë i detyruar paralelisht me zbatimin e këtij buxheti, të fillojë dizajnimin e procesit për vitin e ardhshëm.

Procesi buxhetor është shumë i gjatë, është nëntëmuor. Kalon nëpër iniciativa qarkore, debate, kërkesa, në të gjitha organizatat buxhetore dhe vjen në fund për miratim, çfarë po ndodh me ne këtu. Ai nuk është rishikuar për dy javë, as për tri javë. Ai është rishikuar në kuptimin e partnerëve që qeverisin bashkë, t'i vendosin prioritetet, t'i vendosin angazhimet tona të përbashkëta. Dhe, jo si reagim, por si kërkesë, ministri i Ekonomisë dhe vetë Kryeministri e ka përmendur gjatë gjithë kohës deri në këtë fazë, që ne jemi të interesuar të vendosim një disiplinë fiskale në Kosovë. Ligji e kërkon, standardet e kërkojnë këtë në Kosovë. Si pjesë të angazhimeve deri në këtë vit është arritur disiplinimi fiskal për këtë shkallë që e kemi. Duhet të punohet në ecje e sipër edhe më shumë dhe sado që e quani keqmenaxhim, mosmenaxhim, apo mosarritje, unë mendoj se krejt lidhet me atë që është kriteri kryesor i harxhimit të mirë të buxhetit përmes një discipline buxhetore fiskale të domosdoshme që autoritetet ekzekutive e kanë, por legjislativi e ruan të drejtën ta kontrollojë se a është duke u zbatuar ose jo kjo disiplinë fiskale.

Parametrat dhe kornizat buxhetore janë të njëjtë, sepse brenda këtij viti gjithë ky debat i madh duhet të kalojë edhe nëpër një negociatë të veçantë që besoj Kryeministri nuk e ka pasur të lehtë që Fondi Ndërkombëtar Monetar dhe organizatat e tjera partnere që kanë autoritetin për të kontrolluar dhe vendosur këto parametra në Kosovë, si pjesë e obligimeve që Kosova ka marrë me letren e qëllimit të mirë, sigurisht se ka vlerësuar që në rishikim të vendosë prioritetet, të bëjë shpërndarje, ashtu siç e ka bërë, gjë që u përmend nga shumica e deputetëve.

Unë do të ndalem në dy shtylla kryesore. Është e vërtetë që janë rritur investimet kapitale, në krahasim me draftin e fundit që është miratuar, por është e vërtetë e madhe dhe nuk është asnjëherë turp të thuhet që janë rritur edhe shpenzimet operative për 16 milionë euro. Nëse thuhet me krenari nga një deputet që në këtë rast do të bëhet “partizan” i një vendimi të mirë, duhet, po ashtu, të dihet qartë se shpenzimet operative janë rritur, 16 milionë nuk janë para të vogla në Kosovë, në krahasim me buxhetin, por kanë qenë të domosdoshme për Qeverinë. Nuk janë bërë vetëm sa për t’u bërë, Qeveria e ka parë të arsyeshme, i ka vendosur dhe këto shpenzime janë rritur paralelisht me kërkesat e tjera që Qeveria ka vlerësuar, nën një.

Nën dy, projektet janë në përputhje me premtimet apo me angazhimet programore të qeverisjes. Meqë unë si deputet i takoj Partisë e cila është partnere qeverisëse aktualisht, mund të them lirisht që pjesa e prioritetëve në këtë angazhim është inkurajuese për ne dhe besojmë që ky buxhet, këto korniza buxhetore do të arrijnë ta përballojnë realizimin, por frika ime kryesore, si pjesë e eksperiencës në ekzekutiv, ka të bëjë me kapacitetet harxhuese. Qeveria nuk ka kapacitete të mjaftueshme që brenda një viti buxhetor ta harxhojë buxhetin prej 1 miliard euro. Kapacitetet njerëzore, të cilat menaxhojnë, duke i shkurtuar procedurat e prokurimit, duke bërë gjithçka tjetër që ka në dorë Qeveria dhe legjislativi, do të jetë e paimagjinueshme që të arrihen shpenzimet, të arrihen projektet kapitale të udhëhiqen me këto kapacitete aktuale që i ka Qeveria. Në tabelë buxhetore nuk kam parë investim të Qeverisë për ndërtim të kapaciteteve njerëzore, të domosdoshme, qofshin ato të brendshme, qofshin ato alternative që Qeveria ka të drejtë t'i angazhojë, në mënyrë që t'i udhëheqë projektet e mëdha.

Nën tre, kjo është sfida kryesore, ne mund ta quajmë keqmenaxhim, por në anën tjetër, kur nuk ke kapacitete të mjaftueshme t'i harxhosh mjetet buxhetore për atë që kemi pasur, unë mendoj se më shumë duhet të orientohemi në drejtim të kapaciteteve sesa në fjalor, fjalor tjetër që ne përdorim.

Nën katër, njëra nga procedurat që kërkohet, e unë besoj se do të kem sqarim, meqë kemi ulje të hyrave vetanake, në kurrizin e qytetarit asnjë qeveri nuk mund të bëjë llogari. Po edhe vitin e kaluar, mendoj për vitin 2007, tendencat kanë qenë përmes një ulje të shkaktohet stabilizim të hyrave vetanake dhe tendencë rritje e të hyrave vetanake komunale, si pjesë e garancioneve për investime të mundshme nga autoritetet komunale. Meqë kemi një ulje të ndjeshme, unë shpresoj se Komisioni për Buxhet ku janë të përfaqësuar kryetarët e komunave, sipas çelësit, që ligji e kërkon, e kanë pasur fjalën e vet, në mënyrë që të mos kenë, se edhe ashtu e kanë thesin e shqyer, buxhetin mjaft të zbehtë. Komunitetet e kanë kaluar këtë pjesë të procedurës.

Nën pesë, Zyra e Kryeministrit, me vendim tashmë të publikuar, do ta ketë edhe Zyrën për Komunitete. Dua ta di qartë a kemi të bëjmë me dy buxhete që po ndërtohen paralelisht, sepse Ministria e Komuniteteve e ka një buxhet për interesa të komuniteteve. Kthimi dhe Komuniteti janë dy përgjegjësi kryesore të kësaj ministrie. Nëse Zyra e Kryeministrit ka marrë përgjegjësi specifike dhe i duhet buxhet specifik për t'i mbuluar disa nga interesat e komuniteteve, mendoj që duhet të largohet dilema e buxheteve paralele për interesa të caktuara që mund të vendosen këtu. Mosdallimet në drafte, mendoj se kryesisht ka të bëjë me kriteret që procesi buxhetor duhet të kalojë.

Fjala ime në pjesën e fundit ka të bëjë me fuqitë e rezervuara. Pas 122 ditëve, fuqitë e rezervuara, me buxhet, me staf dhe me probleme i kalojnë Qeverisë dhe Parlamentit. Mendoj që atë buxhet është obligim që Qeveria ta bartë, është obligim, sepse mirëmbajtja, furnizimi, shërbimet, gjithçka që duhet, pavarësisht dyshimeve që mund t'i ketë dikush, Qeveria është e obligueshme të ndajë buxhet, t'i stabilizojë shërbimet e domosdoshme vitale, kapitale në Kosovë. Por duhet të përgatitet t'i bartë tash, pas periudhës së tranzicionit, të gjitha këto probleme, angazhime dhe detyra apo përgjegjësi shtetërore që i takojnë dhe i bartin si pjesë të drejtës së udhëheqjes me disa shtylla të

sovrانيتيت, qofshin ato të ministrive të reja që vijnë dhe i rrisin edhe ato shpenzime, që janë paraparë, natyrisht.

Njëri nga prioritetet që unë kam pritur të ndodhë, është shëndetësia, e cila nuk ka marrë shumë, përkundër një tendence të rritjes së ndjeshme, qoftë sa i përket furnizimit me barna për qytetarët, që është thënë se duhet gjetur një formulë që rastet apo klientët tanë, domosdoshëm, si pjesë e shërbimeve, të jenë të furnizuar, qoftë sa i përket stabilizimit të sistemit shëndetësor në Kosovë, e cila ka probleme serioze.

Shpresoj se ky buxhet, jo vetëm që do të miratohet, por të fillojë të zbatohet shumë shpejt, sepse vonesat buxhetore shkaktojnë avari të mëdha brenda organizatave buxhetore, brenda institucioneve të paimagjinueshme që nuk mund të riparohen lehtë gjatë vitit buxhetor.

Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit zoti deputet! Xhevdet Neziraj e ka tërhequr diskutimin. Fjalën e ka deputeti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Përshëndetje, zoti kryesues,

Zoti Kryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ndoshta pak si të përgjithësuara i tha nja dy çështje zoti Haziri, që unë kam menduar t'i them, vetëm do të specifikoj se është e vërtetë që nga version i parë, që kam pasur rast ta shoh, këto shpenzime që u përmendën janë të ngritura. Unë, ndoshta, po elaboroj shumë shkurt, ku prej 16 milionëve i kemi 1 milionë për paga, 6.6 milionë për mallra e shërbime dhe 9 milionë euro për transfere dhe subvencione. Domethënë, kjo është pak nga ajo që është thënë, sikur është një kundërshti me atë që realisht është në dokument ose në projektbuxhet. Po ashtu edhe te mundësia, kur flasim për transparencë të ndryshimi i listës së prioritetëve, sigurisht ka qenë një kohë shumë e shkurtër, nuk ka pasur mundësi dhe është shumë e qartë që të ketë një transparencë me rastin e ndërrimit të prioritetëve, rirreshtimi i tyre dhe qasjes ndoshta edhe sa duhet adekuate të trajtimit të gjithë hapësirës njësoj me projekte që do të realizohen. E kam fjalën për investime kapitale, duke mos abstrahuar sigurisht nevojën që çdo pjesë e Kosovës ka nevojë të realizohen projekte të natyrave të ndryshme.

Më lejoni të them edhe këtë që unë dua të përshëndes atë që është iniciativë apo vendim të shkurtimi i procedurave për realizim të projekteve. Unë them me përgjegjësi të plotë që kanceri i komunave në këtë rast, posaçërisht, është kjo tek procedurat, por edhe tek agjencitë e tjera buxhetore. Ne të gjithë dimë të gjithë që me muaj të tërë, të mos them, nëse duhet të përsëritet një procedurë, dështon një tenderim, atëherë shkojnë 4-5 muaj dhe këtu çalojmë dhe kemi rrezik të humbjes së mjeteve, nëse mund të thuhet.

Do të doja të them që nga të hyrat vetanake që janë paraparë për komunat, që të zvogëlohen ose të limitohen, diku e kemi parë atje për 8 milionë – nga 38 në 30, mendoj se kjo nuk do të duhej të ndodhë. Kjo do të duhej të kthehet, së paku, atje ku ka qenë fillimisht. Po ashtu, për zotin ministër do të doja edhe në formë të pyetjes edhe të them

atë se a do t'i pengojë ky limitim ose ky kufizim komunat kur thuhet se iks komuna mund të mbledhin, po e zëmë 10 milionë e jo 15 milionë euro të hyra vetanake, që për mendimin tim është gabim të bëhet një kufizim i tillë ose një limitim, aq më tepër kufizim në shfrytëzimin e këtyre mjeteve po qe se komuna – akëcila komunë, nuk është me rëndësi, mbledhë më shumë të hyra vetanake.

Unë po ua them një shembull nga përvoja që një praktikë të tillë e kam kundërshtuar edhe në kohën kur e kam udhëhequr Prishtinën dhe gjithë qeveria komunale e kemi udhëhequr, do të thotë e kemi kundërshtuar. Po e zëmë, ka qenë e caktuar vitin e kaluar që të hyrat vetanake të komunës së Prishtinës të limitohen në 7 milionë euro, ndërkaq planifikimi ynë ka qenë 12 milionë euro. Unë, po ju them se ne kemi realizuar 12 milionë euro, do të thotë 100% , ose 100% nga ajo që e kemi planifikuar. Nëse vazhdon kjo praktikë që të kufizohen komunat në të hyrat vetanake, nuk mund të kufizohen në grumbullimin, por, ndoshta, mund të kufizohen dhe të pengohen në realizimin e projekteve ose në shfrytëzimin e këtyre mjeteve. Mendoj se kjo nuk do të duhej të ndodhë. Ministri ose Qeveria duhet të dalë me një vendim ose të marrë një vendim përkatës që së paku, nëse kanë më shumë të hyra vetanake, komunave t'u lejohet që ato mjete t'i shfrytëzojnë pa pengesa, përkundrazi, t'u ndihmohet.

Thënë shkurt, nëse komunat tona nuk mund t'i përkrahim sa duhet, së paku, të mos i pengojmë në procedura dhe me limitime të caktuara.  
Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Shkumbin Demalijaj, lë të përgatitet Enver Hoxhaj.

SHKUMBIN DEMALIJAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuari zoti Kryeministër, anëtarë të pjesshëm të stafit qeveritar apo të Kabinetit qeveritar, sepse besoj se për menaxhimin funksional të dikastereve të tyre s'e kanë parë të arsyeshme të rrinë sot më gjatë kur diskutohet për buxhetin. Sot flas me zërin e arsyes, duke dashur të them se mos funksionaliteti i këtij Kuvendi shihet jo vetëm nga shkelja e procedurave qysh në start, kur populli i Kosovës nuk e diti se presidenti i tij dha dorëheqje, nuk e paraqiti dorëheqjen para Kuvendit, por edhe u rizgjodh, mirëpo kryesisht edhe sot e shohim këtu. Gjithashtu, siç është thënë edhe në fillim, se kjo Qeveri dhe ky koalicion është i panatyrshëm, shihet me rastin e diskutimeve që sot deputetët e pozitës marrin mbi 95% të kohës së diskutimit. Kjo natyrshëm flet për mundësinë se vetë pozita nuk është e përgatitur të menaxhojë me resurset dhe me popullin e me qytetarët e saj, për çka ka marrë obligimet. Kështu që, si deputet i opozitës, në këtë rast, flas edhe jam i balancuar në qëndrimin politik tonin si Grup Parlamentar i AKR-së dhe qëndroj pas diskutimit të zotit Pacolli që tha : - Ne do të miratojmë këtë projektligj të buxhetit, por këtë nuk do ta bëjmë për hir të partisë opozitare, por për hir të qytetarit të Kosovës që PSSP-ja të mos ketë nevojë që të marrë vendime për vazhdimin e mundësisë të harxhimit të mjeteve buxhetore nga Qeveria e Kosovës dhe mekanizmat e saj pa projektligj. Edhe një herë flas me zërin e arsyes që të jepet mundësi që deputetëve të opozitës t'iu jepet rasti që të diskutojnë lidhur me këtë mundësi. As 5% e kohës nuk na jepet neve. Edhe

atëherë fjalimet tona thirren si historike apo qëndrime të tjera, sido që t'iu duken, mirëpo në këtë rast nuk e shoh të arsyeshme.

Kisha pasur dëshirë që në këtë rast të shihet qartazi se pozita e ka mundësinë për të manovruar si të dëshirojë. Pra, nuk ka pasur nevojë që të ngrehim Komision parlamentar për çështje buxhetore, sepse, kryetari i Komisionit sot thotë se Qeveria ka hartuar një projektligj shumë të mirë, por ai e quan draft se sigurisht synimi i tij është të jetë pjesë e Kabinetit qeveritar dhe besoj se interpretimet që bëhen këtu në kuadër të gjuhës parlamentare që duhet të përdoret, iu kanë përzier, mirëpo them se nuk është qëndrim i Komisionit Parlamentar. Besoj se kur paraqiten qëndrimet e Komisionit Parlamentar në Kuvendin e Kosovës, duhet të jetë qëndrimi i Komisionit Parlamentar, jo i individëve të caktuar apo duke shfrytëzuar hapësirën si kryetar i Komisionit të dalë të flas para Kuvendit.

Në këtë rast, për të mos iu shmangur gjithë kësaj në diskutimin, në kërkesën e tij, zoti Kryeministër thotë se ne do të luftojmë tregun informal të punës. Unë nuk e shoh se mund të luftohet kjo, sepse neve nuk jemi të përgatitur për ta luftuar atë se ka radhë të mëdha të fëmijëve që janë të qytetarëve të Kosovës që sot shesin nëpër rrugët e Kosovës dhe këtë duke e parë në thellësi kur thotë se ne do të krijojmë fonde për arsim. Duhet specifikuar se sot për krijimin e fondeve duhet mirë të shqyrtojë dhe të rishikojë se a i lejon Ligji për menaxhimin e politikave fiskale dhe politikave publike. Atje duhet shthurur njëherë atë mekanizëm, të ketë të drejtë për krijimin e fondeve dhe të disa fondeve që janë me rëndësi, që janë shtyllat kryesore të shtetit të Kosovës, sepse edhe po kemi mundësi të flasim për shtet, që janë: Fondi Pensional i Kosovës, Fondi për Mbrojtjen e Fëmijëve, Fondi për Nxitje të Punësimit, si dhe fondet e tjera, dhe, në fund, organizimi dhe mundësia e hartimit të kontratës së re kolektive. Flitet se në këtë projektligj buxhetor janë të ndara 1 milionë euro për pushimin e lehonisë, ndërkaq unë e shoh si të jashtëligjshme, sepse marrëveshjes kolektive në tetorin e vitit të kaluar i ka kaluar afati, kështu që deri më tani janë shkelur të gjitha të drejtat dhe mundësitë që punëdhënësit dhe punëtorët, do të thotë sindikatat dhe Oda Ekonomike të kenë qasje në shtetin e tyre, sepse edhe me ish- marrëveshjen kolektive kanë qenë të shkelur, sepse garantuese ka qenë Qeveria. Qeveria mund ta mbikëqyrë edhe implementimin e ligjit e jo të garantojë për implementimin e tij. Ndoshta s'do të mund të dukem edhe aq lokalist, mirëpo e shoh se unë vij nga komuna e Deçanit, e shoh se janë bërë disa shkurtime të pipit, do të thotë të projekteve prioritare që kanë ardhur këtu. Do të thotë, janë shkurtuar ato mundësi. Është detyrë e Qeverisë t'i rregullojë sa më shumë dhe të ketë qasje drejt krijimit të mundësisë së implementimit të projekteve që kanë ardhur. E shoh një rrugë që duhet të asfaltohet dhe është komplet në menaxhimin e Qeverisë së Kosovës, që lidhë Deçanin me Maznik dhe del në rrugën që lidhë Klinën me Gjakovën. Janë ndarë mjete vetëm për një kilometër rrugë prej Lumëbardhit deri në Maznik, por e di shumë mirë se kërkesa është, sepse e njoh mirë mekanizmin që ka ndërtuar atje buxhetin. Kërkesat vazhdimisht kanë qenë që komplet të asfaltohet kjo rrugë që lidhë Maznikun me Deçanin, që është një rrugë 7 kilometra dhe Qeveria e Kosovës ndan mjete vetëm për një kilometër rrugë sa për t'u arsyetuar se do të bëjë diçka. E di që projekti është i hartuar për deri në fund. Kështu që janë edhe mundësitë e tjera, janë disa rrethoja të shkollave, besoj se ajo komunë dëshiron dhe ka nevojë dhe meriton të ketë një trajtim tjetër, duke

filluar që nga fshati Strelle, ku lidhen rrugët transicionale për shkak të mundësisë së lirimit dhe të mos bllokimit të komunikacionit që lidh magjistralin Pejë-Deçan-Gjakovë. Kisha kërkuar edhe një herë që, t'i jepet mundësi deputetëve të opozitës, sepse pozita nuk është konstruktive në këtë rast, prandaj nuk mund të flasim më tutje.

Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti dhe ministri Enver Hoxhaj, le të përgatitet Enis Kervan.

ENVER HOXHAI: Të nderuar zonja dhe zotërinj,

I nderuar kryesues i Kuvendit,

I nderuar Kryeministër, ministra,

Të nderuar deputetë,

Mendoj se, vërtet, debatin qysh e kemi, sa i përket buxhetit është në përputhje të plotë me frymën që dominon në Kosovë, me nevojat që i kanë qytetarët e Kosovës, por edhe mënyra se si është planifikuar buxheti, për mendimin tim, reflekton edhe nevojën direkte të çdo qytetari. Unë kisha bërë përpjekje që ta kam një qasje tjetër dhe po synoj që të jem shumë konkret.

E para, në fushën e arsimit në vitin 2005 i kemi pasur 23 milionë, në vitin 2008 i kemi 53 milionë. Ma merr mendja që, pa shifra të tjera, kjo ilustron se cili është dallimi, po ky është edhe progres i krejt Kosovës.

Kjo çështje ndërlidhet me diçka tjetër. Nganjëherë, kur debatohet për buxhet, ne mendojmë në formë sasiore, në shifra, në numra. Më e rëndësishme është se si përdoret buxheti. Ministria e Arsimit e ka buxhetin më të madh, meqë për Qeverinë e Kosovës, për Kryeministrin Thaçi, arsimi është prioritet kombëtar. Për atë arsye buxhetin e kemi më të madh sesa ka qenë i projektuar. Pjesë e kësaj është që për Qeverinë e Kosovës, arsimi është çështje ndërsektoriale. Nuk është punë vetëm e Ministrisë së Arsimit. Nëse e kemi parasysh një matje teknike, nga 7 mbledhje të qeverisë, në 4 mbledhje të Qeverisë është debatuar për arsim, për çështje konkrete. Kolegët e tjerë ministra do të duhej t'ju informojnë për cilat çështje të tjera është debatuar. Në 7 mbledhje, 4 sa i përket arsimit. Po përmenden shumë gjëra, të cilat unë i shënova me vëmendje. Po më lejoni që të jem jashtëzakonisht i shkurtër në cilësinë e ministrit. Ne kemi vendosur në një seancë të Kuvendit në 2007 që arsimin fillor dhe të mesëm ta bëjmë prioritet kombëtar. Ajo ka qenë vija. Unë shoh këtu shumë kolegë, atë vijë e kemi ndjekur me ngulm që kjo të ndodhë. I kemi dhënë përparësi infrastrukturës shkollore se s'ka reforma në arsim nëse nuk ka hapësirë shkollore dhe për ne hapësira shkollore është thjeshtë gjëja më e rëndësishme e cila do të duhej të ndodhë. Unë nuk e kam ndërmend të polemizoj se vërtet e kam ndërmend të marr shënime për çdo kërkesë që ju e keni si deputetë dhe çmoj çdo kërkesë dhe çdo sugjerim që del.

Tek shpërndarja e objekteve shkollore, më lejoni t'i përmendi 3 kritere që janë edhe të Bankës Botërore. Shkollat në kontejnerë. Shkollat në kontejnerë unë i kam gjetur. S'i kam shpërndarë në kontejner, i kam gjetur. Shkollat e amortizuara të cilat mund ta rrezikojnë shëndetin e nxënësve, ato unë i kam trashëguar. Shkollat në shumë ndërrime,

ato unë i kam trashëguar, kështu që shpërndarja ka ndodhur në përputhje me këto kritere. Po edhe një gjë tjetër, që po ju lus të gjithëve ta keni në vëmendje. Ka komuna të cilat nuk kanë vend ku të ndërtojnë shkolla. Deputetin Rexhepi e lus le të ma gjejë vendin në Gjilan, shkollën e ka këtu. Deputetin Salihaj e lus le të më gjejë vendin në Ferizaj, shkollën fillore e ka të ndërtuar. Komunitat nuk kanë vend ku të ndërtojnë shkolla. Kjo është gjendja e vitit 2008, që ne, si Qeveri e Kosovës e kemi marrë.

U përmend çështja e pagave të arsimtarëve. Një pjesë e madhe e njerëzve debatojnë për pagat e arsimtarëve, pa kuptuar në thelb ku është shqetësimi kryesor i arsimtarëve. Shqetësimi kryesor i tyre ka qenë dhe mbetet sistemi linear i pagave, shuma po – sistemi linear i pagës. Dikush i cili punon 30 vjet e merr pagën e njëjtë sikur ai që ka filluar punën nga shtatori. Prandaj, është prioritet i Qeverisë që përmes sistemit të dallimeve pozitive në pagë, thjeshtë të rritet paga e arsimtarit. Është projekti shumë serioz, besoj se në një seancë të veçantë së bashku me donatorët më të mëdhenj ndërkombëtarë do t'ju informojmë për një gjë të tillë. Po këtu është dallimi. Nëse përmendim pagat e arsimtarëve, atëherë duhet ta godasim në thelb, për çfarë kategorie të arsimtarëve po mendojmë, si duhet të zgjidhet problemi. U përmend pastaj çështja e shkencës, e arsimit të lartë. Problemi është aty shumë i thjeshtë, cilësia në arsim dhe mësimdhënia. Dhe ne kemi bërë hapat e parë që, thjeshtë, cilësia në studim dhe mësimdhënie të ndodhë. Kryeministri Thaçi e përmendi që në qershor do të ketë rishikim të buxhetit. Sillni vërejtjet me shkrim dhe ekziston mundësia që çdo vërejtje që ju e keni, thjeshtë, ta përmirësojmë.

Një gjë duhet ta kemi parasysh që, për hir të transkriptit, që vërejtjet me shkrim, pastaj, vërtet, duhet të vijnë nëpër ministri, ose në Zyrë të Kryeministrit, sidomos sa i përket fushës së arsimit, sepse është prioritet kombëtar i të gjithëve, me qëllim që t'i jetësojmë ato kërkesa të cilat ju i keni karshi Qeverisë së Kosovës.

Faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT: Faleminderit, zoti Hoxhaj! Fjalën e ka Enis Kërvan.

ENIS KERVAN: Faleminderit, zoti Kryetar. Është mirë të më quani Kervan.

Sayın Başkan, Bakanlar, Milletvekilleri ve konuklar

Bugünkü oturumun gündeminde diğerleri arasında “Kosova Ortak Bütçesi ve 1 Ocak-31 Aralık 2008 döneminde öngörülen harcamalar” da yer almaktadır.

Kosova Genel Bütçesi Yasa Tasarısı hazırlanırken olumlu sonuçlarla birlikte, bazı önemli noktaların gözden kaçtığına işaret etmek istiyorum. Bu yüzden bazı öneri ve uyarıların dikkate alınması gerekir. Tasarının I, II, III ve IV bölümleri ve B,C ve D tabelaların da tamamlanması gereklidir.

Kültürel Mirası konusuna gelince Kosova Kültürel Miras Kurulu'nun rahat çalışabilmesi için bütçeden yeterince katkı görmemesi, muhakak ki zorluklara yol açacaktır. Şunu da

hatırlamamız gerekir ki Kosova'daki K lt r Mirası mekanlarının korunması ve tamiriyle, Kosova'nın genel t rizmine katkı sunarak t ristleri celbedecektir.

K lt re Kurumsal destek konusuna yer ayrılan 4. b l mde, azınlık toplulukların multi-etnik belediyelerde k lt r n yařatılmasına destek sunulacađı ileri s r l yor. Ancak bu giriřimin hayata ge irilmesi ve s z konusu K lt r Merkezi'nin oluřması ve ona uygun bir binanın inřa edilmesi  nkořullardan biridir. T rk ve diđer toplulukların reva g rmesi ve yařatılması i in  nkořul olarak bu t r merkezlerin oluřması ve ona dahil kiřilerin rahat  alıřabilmesi i in b t  e planlamasının buna uygun olarak yapılması gerekir.

Yasa Tasarısında gen  nesillerin geliřmesi, ayakta kalabilmesi, desteklenmesi ve entegrasyonu i in  ng r len masrafları saptarken, Kosova halkının genelini gen  nesilin oluřturduđunu bilerek onların faydalı etkinlikleri adına daha b y k miktarın da ayrılması gerektiđini bilmeliyiz.

Ayrıca emeklilik sistemi konusunda da daha duyarlı davranarak, mađdur durumda olan bu kiřilerin onlara layık řartları yaratmamızı d ř n rs k, b t  de daha uygun bir konuma layık olduklarını unutmamalıyız.

Toplumun kalkındırılmasında  nemi a ısından tartıřılmaz bir ehemiyeti gerektiren Eđitime gelince, sahip olduđu deđer ve etkisi dolayısıyla bu alanın  zel b t  ye ihtiya  duyduđu da bir ger ektir.  rneđin, T rk topluluđunun eđitimdeki en b y k sorunu aslında, T rk e ders kitaplarının d ř k tirajı, bu kitapların yeterince basıma verilmemesi ve  zel b t  ye sahip olmamasından ileri gelmektedir. Bundan bařka Arnavut a ders kitaplarının T rk eye  evirisindeki gerileme ve bunun da paraya bađlı olması, T rk  đrencilerini dezavantajlı duruma s r klemekte ve bu sorunu bileřik kılmaktadır.

Yasa Tasarısında yer alan IV Tablo'ya g re, 150.000 euro tutarında Prizren belediyesinde T rk topluluđunun kullanımına verilecek bir okul binasının inřa edilmesi  ng r lm řt r. Oysa bize g re bununla birlikte, T rk e ders kitaplarının basılmasına adanacak  zel bir b t  den bir miktarın ayrılması bence řarttır. Kaldı ki 150 bin euro ile b yle bir ilkokul binasının inřaatı da olanaksızdır. Bu tutar sadece Prizren'in Ortakol semtindeki "Abd l Frařeri" ilkokuluna 4 dersanelik ek bina inřaatı i in  ng r lm řt r, dahası bu ek bina projesinin T rk topluluđuna adanmasına rađmen, bu binada eđitim, olumlu bir adım olarak, sadece T rk  đrencilerine deđil bu semtin genel  ocukların kullanımına adanmış olacaktır. T rk  đrencileri her zaman olduđu gibi bundan b yle de diđer halk ve topluluklara mensup  đrencilerle okullarını paylařmak istedikleri i in sadece T rk okulu adına projeye ihtiyacın olmadıđını d ř n yoruz. Prizren'de T rk topluluđunun en yođun yařadıđı Kurilla semtindeki "Motrat  iriyazi" ilkokulu binasına, 4 dersanelik bir ek binanın inřaatı i in de ek b t  nin  ng r lmesi gerekir.

**KRYETARI:** Faleminderit!

Nj  sqarim, n se nuk e ke mbiemrin K rvan, mund t  shkosh ta ndryshosh n  administrat . Fjal n e ka Driton Tali.

DRITON TALI: Zoti Kryetar,  
Të nderuar deputetë,  
Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Atë që desha ta them fillimisht, disa deputetë në forma të ndryshme vetëm se e prekën, por pasi që u lajmërova, atëherë kisha për ta cekur edhe një çështje që mbase në mënyrë direkte nuk ka të bëjë me këtë që po flasim këtu, por në mënyrë indirekte. Por, pasi edhe zoti Kryeministër e ka përmendur disa herë, po edhe zoti ministër Shala, që komplimente, ka filluar të na bëhet patriot e t'i ruaj asetet e Kosovës, përkundër disa muajve më parë, kur mbase atëherë ishte si qytetar i Shqipërisë e s'donte të përzihej në punët e brendshme të Kosovës në ruajtjen e aseteve, po mendoj, gjatë procesit të famshëm të privatizimit.

Sidoqoftë, çështja është për Trustin e pensioneve. E kam një pyetje gjithmonë duke pasur parasysh natyrën e Trustit të pensioneve dhe kompetencat e Parlamentit dhe të Qeverisë, por mendoj se Trusti duhet të dalë publikisht me të dhënat e asaj se sa ka humbur në investime gjatë këtyre thyerjeve të burzave ndërkombëtare, ta dimë konkretisht se sa është fondi tash. Mendoj se ky do të jetë edhe mësimi i fundit për bordin strategjik atje se treg të sigurt, ekonomi të sigurt s'ka, kështu që ato para le t'i sjellin në Kosovë, sepse ekonomia e Kosovës është po aq e sigurt sikurse edhe ekonomitë e tjera dhe të mos përdorin si alibi josigurinë apo fragjilitetin e ekonomisë kosovare, sepse megjithatë thjeshtësia e ekonomisë kosovare del të jetë më e sigurt se kompleksiteti i tregjeve ndërkombëtare ku veç po shihet se janë kah shkojnë llom atje.

Ta shfrytëzojnë atë që desha ta them, ta shfrytëzojmë autoritetin tonë dhe të drejtën si përfaqësues të kontributpaguesve që Trusti të dalë me atë se sa para i ka humbur në këto trazirat financiare që po zgjasin tashmë 7 – 8 muaj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Zylfije Hundozi, le të përgatitet Armen Zemaj.

ZYLFIJE HUNDOZI: Zoti Kryetar,  
Zotëri ministra,  
Kolegë deputetë

Nëse analizohet me vëmendje Projektligji për buxhetin, nuk është e vështirë të kuptohet se ai nuk të jep shpresë se do të ketë zhvillim ekonomik ose përparim në jetën e përditshme të qytetarëve të Kosovës, edhe pse gjatë fushatës elektorale është premtuar shumë. Janë premtuar ndërrimet, por nëse krahasohet me buxhetin e vitit të kaluar, ndryshimet janë vetëm kozmetike. Po duket që Kryeministri me qëllim nuk na ka prezantuar programin e Qeverisë në Kuvend, sepse jo vetëm opozita, por edhe qytetarët nuk mund t'ia zënë për të madhe që nuk po i realizon premtimet. Tek e fundit, fushata përbëhet prej premtimeve.

Në krahasim me buxhetin e vitit të kaluar, buxheti i këtij viti është rritur, gjegjësisht pjesa shpenzuese e tij është rritur më së shumti. Prej kësaj rritjeje, për shëndetësinë janë ndarë vetëm 4 milionë më tepër, edhe pse gjendja në këtë sektor mbetet e rëndë.

Në mandatin e kaluar kemi diskutuar shumë herë për vështirësitë me të cilat po përballlet shëndetësia kosovare, së bashku deputetët e pozitës dhe opozitës. Gjendja ka qenë shumë e rëndë sidomos në Qendrën Klinike Universitare dhe tani në buxhetin e ri, në vend që të rritet buxheti i saj, ai është zvogëluar prej 17 milionëve, sa ka qenë në vitin e kaluar, në 13 milion sivjet. Pa marrë parasysh që ministri i Shëndetësisë është zotuar që do t'ia kthejë shkëlqimin dhe efikasitetin në punë që e ka pasur kjo qendër klinike dikur, por me këtë buxhet stagnimi i saj është i garantuar dhe pacientët kosovarë do të vazhdojnë të shkojnë në spitalet e Beogradit dhe të atyre në regjion, e bashkë me ta edhe eurot e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës.

Por, nuk është çështja vetëm te Qendra Klinike Universitare, sepse përmirësime të buxhetit ka pak në përgjithësi edhe pse është bërë përpjekje që të bëhet spostimi i mjeteve buxhetore prej investimeve kapitale në mallra dhe shërbime, ku i rritet sektori farmaceutik buxheti për 25%, por edhe më tutje me këtë rritje nevojat që i kanë institucionet shëndetësore për barëra dhe material tjetër shpenzues të thjeshtë nuk do t'i kalojë 50%. Për materiale më të sofistikuar, siç është materiali për punën në aparatin e koronografisë, nuk mund të shpresojmë asgjë. Kjo gjë edhe u vërtetua në realitet, sepse pas punës disajavëshe, për shkak të mungesës së materialit, ky aparat sot nuk funksionon më.

Është premtuar rritje e rrogave të punëtorëve shëndetësorë, por nga materialet e dhëna vërehej se gjendja është e njëjtë si në vitin 2007, rrogat janë shkruar veç, e kujdestaritë veç, në mënyrë që të duket se sivjet vija buxhetore për paga dhe mëditje është më e madhe, por në realitet ajo nuk është rritur as për 1 cent. Pa rritje të pagave të punëtorëve shëndetësorë, pa u investuar në zhvillimin e resurseve humane në shëndetësi, në Kosovë nuk do të ketë shëndetësi të mirëfilltë pa marrë parasysh se a lavdërohet dikush se do ta përmirësojë gjendjen edhe pse me punën e rëndë që e bëjnë punëtorët shëndetësorë me paga aq të vogla zgjojnë vetëm respekt, por edhe durimi i tyre ka kufi.

Kryeministri na tregoi disa mënyra se si po planifikon ta rris buxhetin në të ardhmen. Për arsye se të gjithë e kemi të qartë se ky buxhet nuk mjafton për një jetë normale të qytetarëve të Kosovës, dhe pasi që jemi zotuar se do të jemi opozitë konstruktive, do të jap disa propozime të cilat do t'ia rrisim Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

Në Projektligj mund të vërehet se për AKM-në janë ndarë 92 milionë, për energji 84 milionë, për KOST-in 15 milionë, gjithsej 205 milionë.

Propozimi im është që ndërmarrjet e mëdha publike, siç është KEK-u, PTK, KOST-i të privatizohen. Me të hollat e privatizimit të këtyre ndërmarrjeve do të rritet buxheti, nuk do të ketë ndarje buxhetore për këto institucione, do ta largojmë korrupsionin dhe keqmenaxhimin në to. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja Hundozi!

Fjalën e ka Armend Zemaj, le të përgatitet Adem Hajdaraj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne që kemi punuar në Draftbuxhetin për vitin 2008, si anëtar të Komisionit në dy ditët e kaluara e kemi pasur me të vërtetë vështirë, e cekën edhe kryetari i Komisionit që ta shikojmë për secilin pozicion aty ku duhet të ndërhyjmë apo ta kemi të qartë planifikimin e buxhetit për vitin 2008. Ndërsa, unë pak jam kureshtar duke i dëgjuar parafolësit e tjerë. Anëtarët e Komisionit, nuk e di a isha unë aty ato dy ditë, apo mungoja, sepse këtu thanë, mos të them për 90%, diçka tjetër në krahasim me vendimet edhe me ato çka kemi diskutuar ne për dy ditë radhazi. Më vjen keq nga disa deputetë, sepse disa s'e kanë pasur fjalën.

Unë nuk do të ndalem shumë në shqyrtimin e Projektligjit për buxhetin e këtij viti për secilin pozicion, por do të theksoja dy vërejtje. Ato i kam paraqitur edhe në Komisionin për Buxhet e Financa ku Qeveria e tanishme është zotuar për luftimin e korrupsionit dhe rritjen e të hyrave, ndërsa në anën tjetër agjencionet të cilat e kanë për detyrë këtë, nuk janë benificuar në krahasim me agjencionet e tjera, ku hyjnë Administrata Tatimore e Kosovës, Agjencioni Antikorrupsion, Auditori gjeneral, etj.

Ndërsa, një vërejtje ka qenë edhe është dashur të theksohet, këtu nuk është ministri i Rinisë, Kulturës dhe Sportit, është buxheti shumë i varfër për rininë kosovare duke marrë parasysh që 70% e kësaj popullsie në Kosovë janë nën moshën 30 vjeçare. Me atë buxhet, i cili është ndarë, nuk mund të shohim apo nuk mund të kemi mbrojtje, zhvillim apo përkrahje të rinisë në Kosovë. Do ta dëshiroja që Kryeministri dhe Qeveria këtë ta kenë parasysh në rishqyrtimin e buxhetit që do të ndodh në 6 mujorin e ardhshëm.

Lidhur me një çështje tjetër, nuk është ministri i Transportit këtu, do të dëshiroja një sqarim që kërkon ndoshta edhe një debat më të gjerë. Duke marrë parasysh prioritetet të cilat janë kërkuar për ndryshim, aty është kërkuar ndryshimi i një projektit të cilin ne në tetë vitet e fundit e kemi quajtur projekt nacional, kjo është rruga Deçan – Kozhnjer, që lidhet edhe me Plavën.

Ju lutem, këtu është kërkuar që ky projekt të hiqet, i cili është projekt i bartur. Unë do të kërkoja një sqarim. Ne e dimë që ka pasur probleme politike rreth kësaj rruge, por ne besojmë që me shpalljen e pavarësisë së Kosovës do të zgjidhet edhe ajo çështje, ndërsa me sa jam në dijeni, është gjetur edhe zgjidhja anësore që të zhvillohet ky projekt. Ju faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit, Armend!  
Fjalën e ka Adem Hajdaraj.

**ADEM HAJDARAJ:** Përshëndetje zotëri Kryetar,  
Përshëndetjet të gjithëve në sallë, edhe anëtarëve të Kabinetit, ndonëse nuk janë një pjesë e madhe, ikën dolën, po përshëndetje nga unë,

Desha të them vetëm nja dy çështje që më duken janë me peshë. E para, unë e përkrah dhe do të votoj për këtë buxhet duke pasur parasysh, siç kanë vënë në dukje edhe shumë të tjerë, momentin, situatën. Çështje tjetër që desha të vë në dukje është se unë nuk po

them se këtu është analizuar mirë Projekti i buxhetit, kanë punuar komisionet e të gjitha, po të mos shkojmë në atë praktikën e mëhershme se nëse e kemi ministrin nga një anë, nëse kemi Kryeministrin nga një anë, atëherë edhe projektet shkojnë më shumë aty. Kjo të mos ndodhë as sa i përket arsimit, shkollave, as rrugëve, por as fushave të tjera, sepse po ju them nga periudhat e mëparshme, nëse ka pasur Gjakova një kryeministër ose një udhëheqës, Gjakovës i kanë shkuar të gjitha të hollat ose ndonjë komune tjetër.

Prandaj, e kam bindjen se nuk është analizuar sa duhet nga Qeveria e sotme, më tepër është mbështetur në ato të parat dhe kjo shihet, sipas mendimit tim, në radhë të parë për sa u përket komunave.

Shihni ju lutem, për shembull, Prizreni totalin e ka 5 milion e 382 mijë. Sa i përket Prishtinës dihet se është qytet i madh dhe ka shumë popullatë. E di, jam i vetëdijshëm se këto janë bazuar në numrin e banorëve dhe nëse e marrim numrin e banorëve, pavarësisht se janë regjistrimet e hershme, nuk janë bërë regjistrime kaherë, Peja do të vinte menjëherë pas Prishtinës e Prizrenit, do të thosha. Mirëpo, gati 5 herë më shumë ka buxhet Prizreni se sa Peja, të zëmë, ose për shembull Mitrovica ka vetëm 1 milion e 382 mijë. Ne e dimë se në çfarë gjendje është Mitrovica, qysh është. Do me thënë, nuk duhet të mbështetemi në regjistrimet e mëhershme, po të shikojmë gjendjen përafërsisht aktuale si është, sepse komunat mbeten pa buxhet në një situatë jashtëzakonisht të rëndë. Unë e di Peja, për shembull, sa ka vuajtur këto vite sa i përket buxhetit.

Ose Podujeva, për shembull, ka 2 milion e 701 mijë euro në krahasim me Pejën që ka rreth 1 milion e 300 e sa mijë euro. Do të thotë, prapë më bën të dyshoj se rajonizimi luan një rol të rëndësishëm, cili rajon e ka udhëheqësin atij i shkon edhe buxheti. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Adem!

Fjalën e ka Berim Ramosaj, le të përgatitet Naser Rugova.

BERIM RAMOSAJ: Përshëndetje së pari Kryetarit të Kuvendit, Kabinetit qeveritar, Deputetëve të nderuar,

Duke marrë parasysh krejt këtë çka u tha deri tash për buxhetin, faktikisht e drejtë e deputetëve është të shikojnë, të rishikojnë edhe në aspektin joprofesional, sepse tekefundit, brengat e qytetarëve ata i bartin. Por, unë kisha për t'i shqyrtua vetëm disa çështje kryesore, edhe pse shumica nga ato që kam pasur mendjen t'i bisedoj, i thanë parafolësit e mi. Unë kisha vetëm disa çështje më kryesore.

Nëse shihet në shumat kumulative, ky buxhet qoftë nga të hyrat apo shpenzimet, në të dy shtyllat del se nuk është buxhet zhvillimor. Por, qëllim kryesor e ka financimin e kontinuitetit, sepse në aspektin kualitativ as në alokimin, respektivisht në kalimin prej një zëri buxhetor në aspektin institucional, respektivisht prej atyre që janë konsumuese te ato prodhuese, nuk ka ndryshime të mëdha. Andaj, kur e shoh në këtë aspekt, del se qëllim kryesor i këtij buxheti është financimi i kontinuitetit, kontinuitetit të varfërisë,

kontinuitetit të skamjes, kontinuitetit të ekzistimit në nivel të njëjtë, të zhvillimit ekonomikë nuk ka. Nuk ka të planifikuara as rënie të taksave, sepse gati është marrë kallëp ajo skemë programore dhe buxhetore nga viti i kaluar. Ju ka interpretuar qytetarëve të Kosovës se do të shtrihet baza tatimore, ndërsa do të ulet niveli i taksave. Nga bartësit e kësaj Qeverie nuk shihet në programin, respektivisht në këtë buxhet nuk shohim diçka të tillë. Ajo çka është më e keqja, 80% e të hyrave në këtë buxhet shihet se prapë do të inkasohen nga kufiri, qoftë nga të ardhurat që vinë nga doganat, qoftë nga TVSH-ja e mbledhur në kufi, që në fakt nuk është pjesë e natyrës zhvillimore. Në qoftë se na fillojmë ende në këtë formë të mbledhim taksat në kufi, faktikisht i dëmtojmë bizneset. Për atë pjesë të kapitalit të bizneseve të cilat i paguajnë qysh më parë para transaksionit, para shitjes, respektivisht para një gjenerimi të të ardhurave, faktikisht është dëmtim i buxhetit, dëmtim i komunitetit biznesor, të cilin gjë ju nuk e keni dëshmuar më herët, të cilën gjë e keni apeluar që ka qenë një kontinuitet, respektivisht një buxhet, një qeverisje e dobët, andaj nuk po shoh këtu kurrfarë dallimi në këtë çështje. Ende ju në këtë buxhet planifikoni që 80% e të hyrave të mbledhen në kufi.

Te aspekti se sa do të ndikojë ky buxhet në rritjen e parametrave makro-ekonomike, unë mendoj se ajo rritje ekonomike që ishte në vitin e kaluar që e lamë diku 3 deri 4%, edhe pse nuk është shumë i sigurt ky indikatorë, unë mendoj se me këtë buxhet nuk garantoni rritje më të lartë.

Andaj, kërkoj nga Kryeministri apo nga Kabineti qeveritar me këtë buxhet çka dëshiron të arrijë, t'u tregojë deputetëve, të na tregojë edhe ne si opozitë a dëshiron rritje të normës së shtimit ekonomik, a do të ketë rritje të GDP-së, a do të ketë shtim të zhvillimit, do të thotë çka garanton ky buxhet, në qoftë se shikohet nga aspekti zhvillimor, e në qoftë se mendon të mbajë kontinuitet, ajo është diçka tjetër. Pa përceptione negative, po e them edhe një herë, të gjithë ata që kritikojnë këtë buxhet sot, qoftë pozitiv, qoftë opozitiv, ata në fakt janë në anën e programit qeverisës të Qeverisë Thaçi, të gjithë ata që ua bëjnë qefin që është fjala për një buxhet të mirë, ata në fakt po luajnë letrën e kontinuitetit të një qeverisje të kaluar, andaj ta kuptoni qartë këtë. Ky buxhet, zoti Thaçi, do të jetë kufizim për ty, ky do të jetë pengesë për programin tuaj qeveritarë në qoftë se do ta paraqesësh ndonjëherë. Për aq sa di, në fushatën tuaj, në prononcimet tuaja keni programe shumë ambicioze, qoftë të natyrës ekonomike, qoftë të natyrave të programeve sociale. Të jesh i bindur, ky buxhet do të jetë kufizim. Andaj ne që e kritikojmë këtë buxhet ne e shohim me një qasje të tillë. Në qoftë se keni planifikuar rritje të mirëqenies, në qoftë se keni planifikuar rritje të investimeve kapitale, në qoftë se keni planifikuar rritje të numrit të shkollave apo edukacion më të mirë, në qoftë se keni planifikuar shëndetësi më të mirë, ky buxhet nuk ju garanton. Ky është buxhet i kontinuitetit, bile, bile unë kam menduar që Qeveria aktuale, Qeveria Thaçi, ka dal publikisht para opinionit se është një Qeveri në aspektin e superstrukturës në aspektin e teknostrukturës, në aspektin e profesionalizmit nivel më i lartë. Se do të bini ju në këtë nivel dhe të mbron një buxhet dhe një politikë zhvillimore nga e kaluara, këtë nuk kam mundur ta paramendoj, por kjo do të jetë çështje e juaja, nuk dua të ndërhyjë në atë.

Konsideroj që buxheti është në fakt pjesë e autoritetit, pjesë e përgjegjësisë. Pa një program qeveritar, program zhvillimor, buxheti sigurisht ka për të qenë kufizim për juve,

keni për të parë që edhe në atë rishikimin që keni planifikuar, edhe këtë desha t'ju them. Rishikimin që na garantoj zoti Kryeministër, që do ta bëjë në qershor, atë s'ka nevojë të na garantojë Kryeministri, ajo është çështje ligjore, ajo do të jetë procedurë e rregullt ligjore. Mirëpo, unë dyshoj te plani i politikave investicionale, respektivisht te investimet kapitale dyshoj që mund të bëjmë diçka. Mund të bëjmë diçka ndoshta në kalimin e ndonjë zëri buxhetor nga pjesët e mallrave dhe të shërbimeve në ndonjë pjesë të caktuar, ndërsa praktika e deritashme e ecjeve, të zhvillimeve buxhetore, nuk na ka treguar se mund të bëjmë ndryshime shumë të mëdha në këtë drejtim, andaj prapë këtu dyshoj.

Zvogëlimi i të ardhurave për komuna. Në qoftë se krahasojmë buxhetin e propozuar nga periudha e kaluar dhe këtë buxhet, ju keni planifikuar të hyra nga komunat, keni planifikuar diçka në nivel më të ulët, diku afër 8 milionë. Çka tregon kjo? Komunat me këtë buxhet do t'i shndërroni në njësi komunale të cilat nuk janë të afta të gjenerojnë as ekzistencën e tyre. Ndoshta keni planifikuar që me grande t'i mbani, por në fakt atëherë komunat nuk e kanë kuptimin e njësive zhvillimore, e kanë kuptimin e njësive konsumuese që vetëm ju kërkojnë ato mjete dhe ju mund t'i mbani nën kontroll. Faktikisht nuk japin shans, edhe pse taksat mbi pronën në fakt në shumë komuna kanë qenë të larta, ndoshta jo mirë të analizuar, por taksa mbi pronën llogaritet në të ardhmen të jetë zëri kryesor i financimit të një komune, jo grantet, jo donacionet. Andaj, këtu duhet të luhet një letër tjetër në aspektin e zhvillimit, sepse me komuna të zhvilluara do të kemi edhe Kosovë të zhvilluar.

E kam edhe një çështje, për së fundi. Pse po krahasoni të kaluarën, respektivisht qoftë normat e zhvillimit, qoftë normat e ndarjeve të kaluarës, do me thënë, ministri i Arsimit që e tha, sa është ndarë për shkolla, apo ministri i Shëndetësisë, apo tjetri. Krahasoni atë me projeksione të të ardhmes. Nëse krahasojmë me të kaluarën, vazhdimisht kemi për të bërë gabime, kemi për të bërë gabime të mëdha. Andaj, 200 milionëshi që keni planifikuar të ndani qoftë për agjencione, qoftë për ndërmarrje publike, mund të jetë, këtu e përshëndes edhe iniciativën e zonjës parafolëses...

**KRYETARI:** A ke edhe shumë? Rrumbullakojë! Regjia edhe një minutë për Berim Ramosajn!

**BERIM RAMOSAJ:** Mirë, faleminderit! Të jeni të bindur që nuk jam i disponuar për leksione, por jam i disponuar t'ju ndihmojë, se po shihet se kjo qeverisje ka nevojë për ndihmë, sinqerisht po ju them. Në kuptimin e këtij 200 milionëshit, shikoni, dëshiroj këtu jo të luaj rolin e një opozitari apo të luaj rolin e një profesori, por në kuptimin se na pret një sfidë e madhe në aspektin e zhvillimit. 200 milionëshi që është planifikuar, përafërsisht, nuk jam shumë konkret, në formë të dhënieve pa projekte që në fakt ishim dëshmitarë edhe të iniciativave të fundit të Qeverisë, kishte për të qenë një kursim në investime, kursim në investime që sigurisht edhe planet e ministrit të Arsimit, edhe planet e ministrit të Shëndetësisë, edhe të tjerëve do të gjenin shprehje. Mundohuni, mundohuni të gjejmë një variant në buxhet që ato mos t'i kenë të garantuara, as AKM-ja, as PTK-ja, as KEK-u mos t'i kenë të garantuara, t'ju japim shans atyre në kuptimin investicional, do të thotë, qoftë të luajmë në letër...

KRYETARI: Faleminderit, zoti deputet!

Fjalën e ka Naser Rugova, le të përgatitet Ali Lajçi, por ju kisha lutur që të mos përsëritni se vërtet janë diku edhe 9 deputetë që kanë kërkuar fjalën, ose së paku mos e përsëritni vetveten.

NASER RUGOVA: Zoti Kryetar i Kuvendit,  
Zoti Kryeministër,  
Anëtar të Kabinetit qeveritar,  
Të çmuar kolegë deputetë,

Si duket, fillimi i punës së Parlamentit të Kosovës ka filluar me shkelje të rënda procedurale dhe me improvizime. Edhe sot kemi filluar në të njëjtën mënyrë. Të bëhemi transparentë dhe të heqim mjegullat, do t'i përshpejtojmë procedurat, do të merremi vesh si duket zotëri Kryetar. Ju si Kryetar i Kuvendit dhe Kryesia e Kuvendit keni përgjegjësi politike dhe në të ardhmen mos të zhvillojmë debate maratonike pa arritur asgjë dhe po kaloj në rendin e ditës.

Edhe ky diskutim i këtij Projektligji është një improvizim i radhës. Ky Projektligj së pari ka ardhur në Parlament pa u paraqitur programi qeveritar, pa u njohur me prioritetet e Qeverisë dhe të ministrive përkatëse. Unë nuk e di se si do të procedojë më tutje Kryeministri dhe Kabineti qeveritar kur i bën ndarjet dhe projeksionet buxhetore thjeshtë pa prioritet qeveritare.

Ky është një Projektligj i Qeverisë së kaluar me disa ndryshime kozmetike dhe pa arsyeshmëri adekuate. Por as kjo Qeveri, siç po shihet, nuk dallon shumë nga ajo e mëparshmja, sepse, tek e fundit, keni një kompozicion 60 me 40, sepse edhe me këto projeksione buxhetore na përket i njëjti refren dhe një shumë e madhe e këtij buxheti, fatkeqësisht, sipas të gjitha parashikimeve do të ngelet suficit. Dhe, miqtë tanë ndërkombëtarë që po na ndihmojnë në ecjen tonë drejt arritjes në stacionin final po na vërejnë, po bëhen qe sa vite dhe vërtet suficiti po e rëndon edhe qytetarin e Kosovës, edhe cilësinë e jetës së tij, po edhe po i shkakton probleme serioze funksionimit të institucioneve, qoftë qendrore, qoftë të nivelit lokal.

Unë dua t'i përmendi 3 - 4 sektorë të rëndësishme që ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e jetës së qytetarit të Kosovës.

Më erdhi mirë që më në fund po i kushtohet një vëmendje serioze mbrojtjes shëndetësore të qytetarit të Kosovës. Nuk kemi as zhvillim ekonomik, as zhvillim të sektorit të arsimit dhe as të lëmive të tjera pa një përkujdesje normale elementare shëndetësore për qytetarin e lodhur të Kosovës.

Mirëpo, më habit fakti që për Qendrën Klinike Universitare të Kosovës në këtë vit buxhetor është zvogëluar buxheti. Mos të harrojmë, zoti ministër i Shëndetësisë, me plotë respekt, më në fund ka ardhur një emër që e kupton këtë sistem dhe që ka autoritet politik, po, po i drejtohem edhe ministrit të Financave dhe të Ekonomisë ta rishqyrtojnë

nivelin më të lartë të përkujdesjes shëndetësore për qytetarin e Kosovës. 11.559.000 euro për programin farmaceutik.

Zotëri ministër, më gëzon fakti që 25% është rritur buxheti për sektorin farmaceutik, një nga segmentet më të dhimbshme të Kosovës së re, të Kosovës së lirë dhe unë kujtoj që nuk mund të ketë ngritje të cilësisë së shërbimeve shëndetësore pa një infuzion në sistemin farmaceutik të Kosovës. Dua të besoj që me këtë ndarje buxhetore, edhe pse nuk do të jetë e mjaftueshme dhe do të ballafaqoheni me probleme, sepse vet lista esenciale e barërave i ka specifikat e veta, bile 50% të përmbushen kërkesat e mëdha të pacientit të lodhur të Kosovës dhe kur e përkrahim, thjeshtë, po flas si deputet i opozitës, kur e përkrahim këtë projektion buxhetor, duhet të mendojmë edhe te kthimi i dinjitetit të pacientit, por edhe të dinjitetit të nëpërkëmbur të mjekut.

Po i bëjmë 9 vite në një Kosovë të lirë dhe të re dhe 8 vite në mileniumin e tretë dhe ende përballemi me probleme elementare të mbrojtjes shëndetësore të popullatës.

Zotëri ministër, në projektionet tona buxhetore ende figuron trajtimi jashtë vendit. 500.000 euro janë ndarë për trajtimin jashtë vendit. Ju e dini fare mirë se kjo shumë nuk mjafton as për 1% të kërkesave, jam i bindur që i ke mbi 2000 kërkesa në syrtarët e digasterit që ju e drejtoni.

Mirëpo, rastet më të mëdha të kësaj natyre kanë qenë të sëmundjeve kardiovaskulare dhe të kardiokirurgjisë. Pse, zotëri ministër, edhe në 8 vite në mileniumin e ri, në vitin e pavarësisë nuk ka ndarje buxhetore për ndërtimin e Klinikës së Kardiokirurgjisë, që tashmë 4 – 5 vite po diskutohet dhe është imediate. Ju kisha lutur ju dhe ministrin e Ekonomisë dhe Financave, që në vend që paratë e qytetarit të lodhur të Kosovës të shkojnë në vendet e regjionit dhe në vendet e botës së jashtme, të ndërtohet kjo klinikë, ky repart më se i rëndësishëm për nevojat e qytetarëve të Kosovës.

Një investim në kulmin e një klinike, inventarizimin e tjetrës apo pajisjet me aparaturë çfarëdo qoftë ajo, nuk do ta zbus gjendjen alarmante shëndetësore të pacientëve të Kosovës, mirëpo, as nuk do ta ngritë cilësinë e shërbimeve dhe me këtë atakohet direkt kontingjenti i rreth 14 mijë punëtorëve shëndetësorë në vend.

Duke lexuar nenin 1 të përkufizimeve të nocioneve të këtij Projektligji, zotëri ministër i Financave dhe Ekonomisë, kërkoj që të gjithë punëtorëve shëndetësorë t’ju paguhet puna shtesë sipas normativës ligjore të paraparë në këtë Projektligj. Kjo çështje një herë e mirë të futet në binarë buxhetor institucional dhe mos të diskutohet çdo 3 - 4 muaj sepse e çrregullon jo vetëm sistemin shëndetësor, i sjell probleme serioze jo vetëm Ministrisë dhe institucioneve, por shkakton konfuzion si dhe në situatat nëpër të cilat ndodhemi duhet të mendojmë mirë për këtë kategori të njerëzve që e luftojnë vdekjen dhe e kthejnë jetën.

418.001 euro janë ndarë për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Ju lutem, një qasje të tillë ndaj institucionit më të lartë të dijes në Kosovë, nuk do koment. Prapë kërkoj nga ministri i Arsimit, po edhe nga ministri i Financave dhe i Ekonomisë që të

rishqyrtohet ky pozicion buxhetor dhe të shikohet me seriozitet dhe të kemi një qasje shumë serioze ndaj institucionit më të lartë të dijës në Kosovë.

Po ashtu, edhe për Agjencionin Antikorrupsion, sepse Kryeministri i vendit po kërkon zero tolerancë, të përkrahet ky agjencion. Është një agjencion që lidhet me shumë procese në Kosovë dhe që i sjell dobi edhe qytetarit, edhe institucioneve të Kosovës.

Në ndarjen buxhetore për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në një vlerë prej 8.345.690 eurove nuk vërejtja asnjë cent për subvencionimin e prodhimeve vendore.

Zoti ministër, asnjë projekt apo ndihmë konkrete për bujqit, fermerët dhe prodhuesit e tjerë të lëmisë së agrobiznesit. Sipas këtyre projeksioneve buxhetore, as që mund të mendojmë për një zhvillim të bujqësisë dhe të agroprodhimeve. Nuk duhet të harruar se bujqësia është një nga sektorët më të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të vendit, sidomos në rrethanat aktuale nëpër të cilat po hynë vendi jonë dhe presim sfida edhe të natyrave të tjera. Dua të besoj që lidhur me programin qeveritar, që më në fund duhet të kalojë nëpër këtë Parlament, të bashkëbisedojmë dhe t'i dëgjoni edhe sugjerimet tejet të sinqerta dhe dobiprurëse të opozitës.

Për Zyrën e Kryeministrit janë ndarë 5.570.675 euro. 1 milion euro subvencione dhe transfero, do të thotë, 1 milion euro nga kodi i programit 216, që janë marrë nga autostrada. Shumë normal që ato superstradat e shumë proklamuarë është problem të ndërtohen në rrethanat aktuale që jemi dhe dua të besoj që këto alokime të mjekteve në këtë mënyrë, thjeshtë të orientohen atje ku duhet.

Zoti Kryeministër, autostrada duhet të fillohet, e dimë që ka probleme të të gjitha natyrave, janë probleme edhe të eksproprijimit pronave e tjera, po është projekt nacional...

KRYETARI: Faleminderit, zoti Naser!

Fjalën e ka Myrvete Pantina, le të përgatitet Rustem Mustafa.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit!

I nderuar Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar të gjithë të pranishëm,

Do të mundohem të jem shumë konkrete me qenë se shumë gjëra u përmendën deri më tani. Unë mendimin tim e kam dhënë edhe në Komisionin për Buxhet dhe Financa, ku jam anëtare, por megjithatë e ndiej të arsyeshme ta them mendimin tim së paku shkurtimisht edhe në këtë forum.

Në shikim të parë, kur analizojmë Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për vitin 2008, elementi i parë që bie në sy, me të cilin së paku unë jam e pakënaqur, është struktura e të hyrave buxhetore. Është kjo strukturë që përbëhet rreth 61% nga të hyrat të cilat krijohen në kufi, ndërsa vetëm 19% janë të hyra të cilat krijohen apo grumbullohen nga tatimet e

brendshme. Kjo strukturë, natyrisht, flet haptas për një ekonomi të paqëndrueshme. Qëllimi ynë, natyrisht, nuk është që të kemi një ekonomi të paqëndrueshme, por të krijojmë një ekonomi e cila mund të gjenerojë të ardhura. Këto të dhëna tregojnë faktikisht se buxheti i Kosovës krijohet ose grumbullohet nga të hyrat të cilat vinë nga importi i mallrave dhe shërbimeve nga jashtë.

Për këtë arsye, në të ardhmen duhet t'i kushtohet rëndësi që ky raport në të ardhmen të ndryshojë në favor të rritjes së të hyrave tatimore të brendshme.

Unë shumë pak dyshoj që me diskutimet ose me propozimet që i japim këtu sot ndoshta do të mund të ndryshojë shumë ndarja e mjeteve buxhetore që është bërë apo që është planifikuar. Mirëpo, së paku besoj se do të merren parasysh për planifikimin e buxhetit në vitet e ardhshme.

Ndarja e mjeteve buxhetore që e bëjmë ne tani, natyrisht që do të ketë ndikim në krijimin e të hyrave buxhetore në të ardhmen.

Propozimi im është që së paku të jemi shumë të kujdesshëm me institucionet ose konkretisht me organizatat të cilat kanë mundësi vetë të gjenerojnë të ardhura. Atyre që mund të krijojnë të ardhura nuk kemi nevojë t'ju ndajmë mjete ose të jemi shumë zemërgjerë ndaj tyre, por nëse veç na imponohet që t'ju ndajmë mjete, e kam fjalën konkretisht për KEK-un, një gjigant si është KEK-u, që ka mundësi të krijojë edhe të kontribuojë shumë në buxhetin e Kosovës, ne duhet t'ju ndajmë atyre mjete dhe kjo përsëritet vite me radhë në këtë periudhën e pasluftës, qoftë edhe në formë të kredisë, mjetet të cilat janë paraparë t'ju ndahen këtë vit.

Unë këtë pyetje e kam parashtruar edhe në Komision, por nuk kam marrë përgjigje. Së paku do të kishte qenë mirë të dimë me çfarë kushtesh do t'i lejohet një kredi prej 79 milionësh KEK-ut.

Përveç kësaj, përveç që ju ndahen këto mjete, unë kisha për të kërkuar që nga ata që ju ndahen mjete nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës të kërkohet edhe një llogari më e madhe për mënyrën e shfrytëzimit të këtyre mjeteve. Ndërkaq, ato mjete që, do të thotë, u ndahen atyre që kanë mundësi të krijojnë të ardhura, do të mund të shfrytëzoheshin shumë më dobishëm po t'u jepeshin atyre që kanë nevojë. Konkretisht, për mua një prioritet i madh për zhvillimin ekonomik të Kosovës është bujqësia.

Prandaj, e shoh shumë të arsyeshme një ndarje më të madhe të mjeteve buxhetore për bujqësi. U përmend edhe nga parafolësi, me buxhetin e vitit 2008 janë planifikuar diku mbi 8 milion. Ndoshta ato janë më të mëdha se në vitin e kaluar, por megjithatë mendoj se bujqësia e meriton edhe një ndarje më të madhe. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka Rustem Mustafa, le të përgatitet Alush Gashi.

RRUSTEM MUSTAFA: Zoti Kryetar,  
Zoti Kryeministër,

Ne e dimë sa e rëndësishme është tema për të cilën po diskutojmë sot, gjithashtu e dimë edhe kohën në të cilën po diskutojmë.

Unë vijë nga Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri dhe ne kemi bërë një marrëveshje që të bëjmë rekomandimin me shkrim dhe e kemi bërë ato dhe besoj që Qeveria do t'i ketë parasysh dhe gjatë shqyrtimit pas 6 muajve, siç thuhet, të buxhetit, do të kihen parasysh. Neve na kanë interesuar vijat buxhetore që kanë lidhje me Policinë e Kosovës dhe Ushtrinë e Kosovës. Por, edhe për këto nuk dëshiroj sot të diskutoj, mirëpo do të diskutoj për një temë tjetër që lidhet me dy vija, me vijën buxhetore dhe gjithashtu edhe me sigurinë e vendit.

Kemi biseduar edhe me anëtarët e Kabinetit të Qeverisë, edhe me Kryeministrin, por e shoh të arsyeshme ta shtroj edhe një herë këtu.

Plani ABC i KEK-ut, në këtë kohë, flas për këtë kohë, është i dëmshëm për fshatrat që jetojnë në vijën kufitare të vendit. Kërkoj urgjentisht që Kryeministri ta urdhërojë ministrin e Financave, Ministrin e Energjetikës dhe KEK-un të bëjë një organizim, ku fshatrat, nuk po flasim për kohë, pa kohë kjo duhet të jetë, që janë në vijën kufitare, jo për qytetet, por fshatrat të kanë rrymë 24 orë. E them, pa kohë, derisa Kryeministri ta shoh të arsyeshme të marrë një vendim tjetër.

Unë kam marrë informata, zoti Kryeministër, nga këto fshatra dhe mund të them me përgjegjësi të madhe se ka një kohë shumë të gjatë që në të gjitha fshatrat e vijës kufitare, siç janë: Karadaku, Gollaku, Llapi, Shala edhe një pjesë e Drenicës, bashkë nëse i bëjmë, nuk kanë rrymë më shumë se 7 në terr dhe një 1 orë në dritë. Është çështje urgjente dhe kisha dëshiruar që ta keni parasysh. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka Alush Gashi, le të përgatitet Ali Lajçi.

ALUSH GASHI: Ju faleminderit zoti Kryetar!

I nderuari zoti Kryeministër,  
Zonja dhe zotërinj deputetë,

Jam shumë i impresionuar me qasjen e opozitës dhe të deputetëve nga pozita sa i përket mbështetjes për nevojën e fuqizimit dhe të mbështetjes së financimit për Ministrinë e Shëndetësisë.

Jam i gëzuar që nga një nga prioritetet e Qeverisë së vendit tonë është mirëqenia dhe shëndeti i qytetarëve tanë. Ne, si Qeveri, kemi ardhur në një buxhet i cili pak a shumë ka qenë i korrnizuar dhe duke iu falënderuar mirëkuptimit të Kryeministrit dhe ministrit të Financave, na u ka mundësuar një ndërhyrje e lehtë buxhetore për një afat kohor, të cilin ju e dini i cili është. Ne jemi të vetëdijshëm që buxheti aktual i shëndetësisë së vendit tonë, në vullnetin më të madh mund t'i plotësojë diku afër 30% të nevojave të shëndetësisë së vendit tonë. Por, njëkohësisht duhet të jemi shumë korrekt, nëse mungojnë 70% të mjeteve për shëndetësi, është shumë vështirë të besohet se si kjo shëndetësi nuk ka mundur t'i harxhojë, 2-3 milionë kanë mbetur suficit, që do të thotë

se ne duhet këto mjete që i kemi nga taksapaguesit e vendit tonë t'i harxhojmë me shumë kujdes dhe me shumë respekt. Andaj, zonja dhe zotërinj deputetë, vendimi im ka qenë që në kuadër të rekomandimeve të Kryeministrit dhe të ministrit të financave, që ne të shikojmë se si ta funksionalizojmë këtë çka e kemi sot, se si të garantojmë që këto të holla të harxhohen në një mënyrë transparente dhe nëse ne e kemi demonstruar se nuk po jemi në gjendje me e mbajtur dhomën që e kemi, atëherë për këtë fazë ndoshta nuk ka nevojë të ndërtohet edhe një dhomë tjetër.

Ne i kemi gjetur të pa harxhuara 2-3 milionë, në kohën kur ne na mungojnë 70% të mjeteve. Andaj, në këtë fazë kemi bërë atë që është e mundshme. Ajo që dihet në opinion, është mungesa e medikamenteve, por ajo që nuk dihet shumë në opinion, është se këto medikamente nuk janë menaxhuar mirë dhe në mënyrë transparente asnjëherë.

Hallkat e keqpërdorimit prej dogane deri në depo, prej depos deri në Ministri, prej Ministrie deri në spital, prej spitali deri te pacienti, ne duhet t'i diskutojmë. Unë jam shumë i entiazmuar se kemi mundësi që këto çështje të vijnë në Kuvend. Unë e kam një program shumë të mirë për dalje nga kjo gjendje. Ne nuk mundemi të lejojmë që të hollat tona të mos shpenzohen drejt. Andaj, si shoqëri e cila hynë në fazën e tranzicionit, si shoqëri e cila është përcaktuar për transparencë dhe ekonomi të tregut, na nevojitet një qasje tjetër për shëndetësi. Ne nuk mund të lejojmë që të paguhet njëjtë si punëtori dhe ai i cili nuk punon, ai i cili saboton. Andaj, zonja dhe zotërinj deputetë, Kryeministri dhe ministri i Financave e kanë pranuar iniciativën tonë që ne të shikojmë që punëtori shëndetësor të paguhet sipas rezultateve të punës, dhe ne e kemi iniciuar këtë debat publik. Ne këtë vit do ta shfrytëzojmë për sqarimin dhe argumentimin sqë njerëzit të paguhet sipas kualitetit. Nuk paguhet njëjtë si ai i cili natë e ditë punon dhe gjatë asaj kohe investon në ngritje të dijes, paguhet njëjtë si ai i cili e saboton punën, si ai që gjatë orarit të punës nuk është në vend të punës, si ai i cili nuk e respekton taksën e tatimpaguesit. Ne duhet të insistojmë që të ketë respekt për qytetarin, që pacienti ynë ta ketë tretmanin e njeriut. Ne nuk mund të pranojmë që profitorë të ndryshëm në profesion, të lidhur me qarqe të ndryshme, ta keqpërdorin hapësirën për të cilën ne e paguajmë.

Mua më vjen mirë që opozita e ngritë çështjen substanciale të programit tonë për ndërrimin e kësaj çështjeje. Ne jemi të vetëdijshëm se buxheti i vendit tonë për të gjitha lëmitë, është diku ndoshta një e treta e buxhetit. Sa për krahasim, vendi ynë në këtë fazë ka mundësi për shëndetësi t'i ndajë 56 milion për të gjithë banorët e vet, për të gjithë vizitorët që këtu me vite vijnë marrin shërbime mjekësore, për të cilat këto nuk paguajnë. Ka pak vende në botë se ofrohet një shërbim mjekësor pa pagesë. Vendi ynë në këtë fazë këtë e bën, sepse nuk ka raporte kontraktuese. Si do të veprojmë nëse në vendin tonë, sado që financiarisht është i varfër, por ka resurse të mira natyrore, ka njerëz që punojnë shumë me shumë përkushtim për këtë vend, dhe nëse ata arrijnë që t'i regjistrojnë mbi 300 mijë automjete në vit, me një mesatare mbi 200 euro, ne duhet të bisedojmë cili është ai paketë? Sa euro munden ata ta blejnë një shërbim shtesë shëndetësor në vendin tonë. Nëse Agjensia e sigurimit e cila vjen këtu prej kahmosit, i merr ato të holla, ndërsa klienti i tij e bën një aksident për tejkalim të shpejtësisë dhe vjen na e bën një faturë marramendëse në sistemin tonë shëndetësor. Unë do të kërkoj

nga Kuvendi që të na mundësojë, që ne të kemi pak aranzhime obligatore me të. Nëse pacientët me sëmurje kronike dhe me sëmurje më të rënda, për të cilat sot dihet që janë pasoja të tymosjes së duhanit, bëjnë shpenzime enorme në sistemin shëndetësor, unë kërkoj nga Kuvendi që të më ndihmojë që të ketë një taksë të posaçme për shëndetësi.

Nëse qyteti ynë, kryeqyteti i vendit tonë, është një prej vendeve me ndotje më të madhe, jo vetëm këtu, edhe më larg, dhe një pjesë e ndotjes është edhe nga derivatet, atëherë unë do t'ju lus që të mundësoni që një përqindje e tatimit të jetë e lidhur me shëndetësi.

Nëse në vendin tonë me qindra aeroplanë shfrytëzojnë kerozinin që na djeg oksigjenin, ndërsa zotërinjtë në Aeroport marrin taksa enorme për shërbime të cilat nuk i ofrojnë, unë do t'ju lus që të mundësoni që një pjesë e atyre taksave të jetë e lidhur për shëndetësi. Ide të tilla, unë do të ofroj para këtij Kuvendi shumë të nderuar dhe unë e di që gjendja në shëndetësi në vitet e ardhshme do të jetë më e mirë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ali Lajçi, le të përgatitet Edita Tahiri.

ALI LAJÇI: I nderuar kryesues,  
Kryeministër,  
Ministër i buxhetit dhe i financës, mund të themi në mënyrë të veçantë,

Unë pash këtu një interesim shumë të mirë dhe duhet të merre, unë mendoj shumë, dy tri lëmi të cilat janë shumë të nevojshme, siç është shëndetësia, arsimi, kultura po ashtu, se shihet atje një mangësi në ndarjen e buxhetit e që vëllimi i punëve dhe i nevojave janë shumë të mëdha. Por, sidoqoftë, unë desha të ndalem, të fokusoj edhe disa nga çështjet këtu në raport me konfuzitetet e kriterëve që bëhen në ndarjen e buxhetit e sidomos komunave, grandet qeveritare etj. në disproporcion dhe kanë mbetur, si duket, ende në kornizat e vjetra dhe nuk kemi mundur të ndalemi në këtë fushë. Sidoqoftë, ne mund t'i shikojmë disa nga diskrepancat që i kemi me disa komuna, e që unë nuk do të doja të kuptohet kjo si anuesë kurrësi, por si një diçka faktike që ekziston. Ta zëmë, disa prej komunave që u thanë dhe që u përmenden, por edhe disa të tjera, duke menduar se të gjitha edhe janë ashtu tonat, të shikojmë ndarjen e buxhetit si e kemi në grandin qeveritar për komuna. Ta zëmë, Komuna e Pejës ka diku 1 milion e 600 euro, ka po ashtu edhe komuna e Gjakovës, që është mirë që i ka, po ashtu edhe ndonjë komunë tjetër. Por kemi një dallim këtu për shkak se, si duket, kanë mbetur kriteret e UNMIK-ut, që në fillim të vendosjes këtu dhe nuk është lëvizur në marrjen dhe vendosjen e kriterëve të reja kur kemi parasysh zhvillimet e përgjithshme të shoqërisë kosovare.

Unë do të thosha se këtu do një vëmendje, do një vëmendje po ashtu në përfitimet e komunave kur është fjala në inkasim, apo grumbullim të tatimit në pronë, e që shpesh disa nga komunat deponojnë më shumë, por kriteret e ndarjes pastaj janë të njëjta dhe në këtë rast ju hyjmë ne. Sigurisht, në këtë mes mund të themi shumë shpesh se Komuna e Pejës është goditur. Ne e kemi komunën më të shkatërruar në të gjitha vijat, infrastrukturore etj. Nuk është shprehur një kujdes në buxhet, sidomos në ndërtimet sociale etj. etj. që është e nevojshme. Në fushën e infrastrukturës duhet të shtohet, unë

mendoj, për shkak se kemi disa zona turistike atje që e kanë nivelin edhe kreativ, por edhe të shtojmë dinamikat atje për shkaqe edhe strategjike, siç është Rugova etj., të ndikojmë në asfaltimin e rrugëve atje, sepse është shumë i nevojshëm kthimi i popullatës, por të ndikojmë sigurisht edhe në fushat e tjera të arsimit, sidomos në pjesën e Dukagjinit, ku kemi disa shkolla që mund t'i afrohen gjendjes së mbajtjes së mësimin në kontejnerë, ta zëmë në Napolje, e në disa raste tjera.

Unë besoj se duhet të kemi një kujdes kur komunat ta aprovojnë buxhetin nga kuvendet komunale dhe kanë një kornizë buxhetore, të mos preket ajo në thelbin e saj. Ka mundësi të adoptimeve dhe të harmonizimeve, por shpesh ndodhë se edhe revidohet vendimi i kuvendeve komunale. Nuk do të duhej, mendoj unë, dhe të kemi një vëmendje në fushat e tjera, sidomos në ndarjen e interesave në grumbullimin e tatimit në pronë, që nuk ka ndodhur kështu. Në këtë mes, unë mendoj se duhet të kemi një vëmendje dhe dëshiroj që të shtohen këto kapacitete buxhetore, të përfillen këto kërkesa të ministrave, që unë mendoj janë mjaft ambicioze dhe të qëllueshme, kurse kapacitetet sa janë, të shikojmë në rishikimin buxhetor të qershorit se a mund të arrijmë edhe diçka më shumë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, zoti Lajçi! Fjalën e ka Edita Tahiri, le të përgatitet Hajdin Abazi.

EDITA TAHIRI: Zoti Kryetar,  
Zoti Kryeministër, Qeveri,  
Deputetë të nderuar,

Ishte një ditë e punës me shumë, do të thosha, ide interesante, me përpjekje të gjithëve që të rrumbullakojmë një proces sante, i cili pritet të jetë një prej kushteve që të ecin proceset përpara në drejtim të finalizimeve, të cilat, secili prej nesh kur po dalim prej kësaj salle, po i përmendim. Pra, derisa brenda po diskutojmë krejt për këto sfidat e buxhetit, sa po dalim prej dere, po pyesim: Kur do të shpallet pavarësia?

Prandaj, duke marrë parasysh kontekstin politik në të cilin po zhvillohet ky debat, dhe unë do të theksoja tranzicionet interesante, e para, tranzicioni nga një qeveri në tjetrën, tranzicioni nga protektorati në pavarësi, si dhe mundësia e rishikimit të buxheti për 6 muaj, na jep mundësinë që të jemi më konstruktiv, që sa më shpejtë ta avancojmë procesin e miratimit të saj. Në këtë kuadër, mendoj se kjo Qeveri e re ka dhënë disa prova shumë të rëndësishme në drejtimin e përkushtimit për reforma cilësore, të cilat në radhë të parë janë parë me hapat e racionalizimit të shpenzimeve qeveritare dhe me një konfirmim të qartë për zero tolerancë kundër korrupsionit.

Unë sonte dëgjova këtu disa diskutime që më tepër po i ngjajnë 100 ditëshit të qeverisjes, se sa një momenti të rëndësishëm që ta miratojmë buxhetin. Unë e kuptoj rolin e opozitës, kuptoj edhe rolin tonë si pozitë, mirëpo është një kulturë politike që thotë se duhet t'i jepen 100 ditë Qeverisë të marrë vetën, së pari, të konsolidohet, t'i kryejë punët, të dalë para nesh dhe pastaj vjen faza kur ne do të merremi me këtë çështje. Prandaj, sonte nuk u mora me buxhetin, ndonëse mendoj se në disa nga kriteret

makro ekonomike duket se janë përmbushur, mendoj se i është dhënë prioritet mjaft i mirë arsimit dhe shëndetësisë, si pika shumë të rëndësishme që po e mundojnë shoqërinë tonë, por unë mendoj që sonte është koha të ecim së bashku, edhe pozita, edhe opozita.

Shikoni, dy vjetët e kohës së negocimit për statusin, kanë qenë me të vërtetë shembull mënyra se si kemi punuar të gjithë së bashku. Po na jemi me të vërtetë para një vendimi të madh dhe këto diskutime kur harrohet që jemi në proces të vendimeve të mëdha dhe fillojmë të merremi me çështje që nuk na takojnë sot, e mund të presim tre muaj a 100 ditë, a është më shumë se tre muaj, dhe pastaj do të merremi me vlerësime dhe rivlerësime. Prandaj, kërkesa ime është që të shkojmë tutje dhe ta miratojmë, sepse mendoj se po na pret një punë e madhe menjëherë pas këtij vendimi. Ju faleminderit.

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka Hajdin Abazi, le të përgatitet Gani Buçinca.

HAJDIN ABAZI: Përshëndetje zoti Kryetar,  
Zoti Kryeministër,  
Të nderuar kolegë,

Këtu nga një parafolës u tha se kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa ka parashtruar pikëpamje ose mendime të veta kur e bëri në ekspozë të shkurtër, gjë që kjo nuk qëndron. Ato çfarë i tha kryetari, ato ishim çka jemi marrë vesh në Komisionin për Buxhet dhe Financa. Në parim, ne jemi marrë vesh për shumë pak gjëra për arsye se koha ka qenë e shkurtër. Jam njëri ndër anëtarët e Komisionit, që ndër të parët e kam bërë pikërisht vërejtjen në lidhje me kohën e shkurtër, por njëherësh kam dhënë edhe pëlqimin duke i kuptuar rrethanat në të cilat ndodhemi.

Po ashtu, edhe aspekti buxhetor për komunat që u përmend, këtë çështje e kam ngritur edhe unë, sepse vij nga një regjion ku, për shembull, buxheti për Ferizajn, Shtimen, Kaçanikun, Vitinë, Gjilanin, është thuaja se i njëjti që ka qenë dhe ka nevojë të rishikohet dhe të përmirësohet, por jemi dakorduar në parim që kjo të mbetet, qoftë në fazën e rishikimit, qoftë në buxhetimin kur ta bëjmë projektin për vitin e ardhshëm.

Është brengosëse, për shembull, kur shfrytëzohet, është e drejtë e jona, por është brengosëse kur shfrytëzohet nga njerëzit të cilët kanë qenë vetë dikur nëpër pushtete komunale dhe kanë ndrequr rrugë, të cilat pas tre katër muajsh janë prishur dhe tani këtu ngritën dhe dalin në pozita kur gjëja ka nevojë të përmirësohen ato defekte, që rrjedhimisht një pjesë e tyre janë vetë pasojë e kohës kur kanë qenë në pushtet.

Sidoqoftë, këtu duhet thënë diçka. Po kërkohet shumëçka të ndryshohet dhe të përmirësohet dhe, pa fije dyshimi, këto janë kërkesa të mira dhe secili nga ne do të dëshironte që buxheti i Kosovës mos të ishte kaq, por të ishte nja dhjetë fish më i madh dhe atëherë do të kishim pasur mundësi shumë më tepër të bënim. Për kaq sa kemi trashëguar një buxhet, është e pamundur të bëhet diçka më tepër, është e pamundur të përgjysmohet ose një e treta e buxhetit të Qeverisë së Kosovës të investohet për

investime kapitale ku do të mund të prodhohim diçka më tepër, meqë nevojat e ndryshme të të gjitha niveleve janë parashtruar.

Unë, personalisht e kam parë se në këtë Projektbuxhet është bërë një përpjekje për t'i balancuar nevojat e dikastereve të ndryshme, nevojat e komunave dhe të qytetarëve përmes këtyre projekteve.

Prandaj, nëse ka ndokush ndonjë shkopi magjik që mund të na tregojë se si ne mund të bëjmë mrekullira dhe ta shumëfishojmë buxhetin e Qeverisë së Kosovës, do të ishte mirë të na tregojë dhe të ecim sa më shpejtë përpara, t'i eliminojmë përnjëherë të gjitha pengesat që i kemi, sepse besoj se askush prej nesh nuk do ta kundërshtonte këtë. Nëse flasim dhe duam të jemi realist, atëherë do të kishte qenë mirë që ta shikojmë buxhetin më me vëmendje. Ne ndodhemi në prag edhe kur do të krijohen ministritë të reja, të paktën dy parashihen, do të krijohen institucione të tjera, por duhet edhe kjo të kihet parasysh dhe në kuadër të kësaj, mendoj se Qeveria për kaq pak kohë sa ka pasur për ta bërë këtë Projektligj të buxhetit, vërtetë është për t'u përgëzuar.

Vërejtjet dhe sugjerimet që i kemi bërë edhe në kuadër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, pra edhe nga një pjesë e deputetëve këtu, vërejtje dhe sugjerime qëllimshme dhe që do të mund të implementoheshin, do të ishte mirë që të merren parasysh me qëllim që të bëhet ndonjë përmirësim eventual që ka mundësi, dhe kështu të ecim sa më mirë përpara. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka Gani Buçinca, le të përgatitet Aziz Rexhepi.

GANI BUÇINCA: I nderuari zoti Kryetar,  
I nderuar zoti Kryeministër,  
Kabinet qeveritar dhe ju, kolegë deputetë dhe deputete,

Nuk e kisha ndërmend të inkadrohem në këtë debat se nuk e ndieja veten edhe shumë kompetent për të folur për gjërat të cilat kërkojnë njohuri të thella profesionale të fushave të ndryshme, sidomos ato të ekonomisë dhe të financave. Mirëpo, duke u inkurajuar nga debati i disa diskutantëve, edhe duke e parë se nuk rrezaton ndonjë nivel të thellë profesional, e mora guximin që edhe unë të paraqitem.

Desha të ndërlidhem vetëm me disa çështja të cilat u ngritën këtu, sidomos në çështjen e ndryshimeve të cilat po i kërkon një pjesë e opozitës se gjëja në Kosovë nuk kanë ndodhur ndryshime të cilat Partia Demokratike i ka paralajmëruar gjatë fushatës zgjedhore. Unë mund t'ju them të gjithë atyre të cilët mendojnë kështu se e kanë gabim, ndryshimet fillojnë nga koka dhe jo nga xhepi, siç pretendojnë disa, duke u nisur nga praktikat e qeverisjeve të kaluara, dhe mund t'ju them se pikërisht në Kosovë Qeveria aktuale ka vendosur disa standarde bashkë me partnerin e koalicionit qeverisës, disa standarde të cilat edhe i sublimojnë të gjitha ato ndryshime të cilat janë paralajmëruar gjatë fushatës.

Praktikat qeverisëse të cilat kanë ekzistuar më herët, kanë ndryshuar dhe kjo është mirëpritur shumë nga qytetarët dhe është shumë premtuese dhe shpresëdhënëse për të ardhmen e vendit. Kurse, sa u përket atyre të cilët i dëgjova këtu dhe thanë se ky buxhet është buxhet i kontinuitetit, i varfërisë e ku ta dijë unë, unë mund t'ju them se ata duhet, ata ekspertë duhet ta perceptojnë realitetin më racionalisht, realisht, ta perceptojnë edhe realitetin dhe ambientin ekonomik – politik në Kosovë dhe Qeveria, qysh na tha edhe kolegu i nderuar Hajdin Abazi, nuk ka ndonjë shkop magjik dhe të bëjnë ndryshime spektakulare në rritjen e buxhetit. Mirëpo, duke i marrë të gjitha masat për funksionalizimin e gjykatave, sundimin e ligjit në Kosovë, unë jam i bindur se në të ardhmen e afërt do të ketë efekte buxhetore shumë të rëndësishme në Buxhetin e Kosovës dhe këto efekte do të vijnë sidomos në periudhën e rishikimit të buxhetit.

Jam i bindur se ky Projektbuxhet, jo qysh u diskutua edhe më herët, jo se i plotëson nevojat e qytetarëve të Kosovës, por në momentin aktual është ky çka është dhe shpërndarja pavarësisht se u kritikua në mënyrë dashamirëse, ka qenë ashtu siç e kanë planifikuar ekspertët, por desha t'ju përkujtoj se kur është çështja të shpërndarja nëpër komuna dhe regjione, mos të harrojnë të gjithë ata që diskutuan se Partia, koalicioni aktual qeverisës nuk do të jetë në pushtet vetëm një vit dhe ky buxhet nuk është bërë vetëm për një periudhë gjashtëmujore, mirëpo në vitin e ardhshëm besoj që Kabineti qeveritar do të ketë parasysh e të bëjë ekuilibra në rast se një regjion ose një komunë nuk është marrë parasysh në këtë fazë.

Unë do ta mbështesë dhe ju kisha lutur që ta aprovojmë sa më shpejtë dhe të ecim përpara se na presin edhe punë të tjera, të cilat janë me interes vital për qytetarët e Kosovës.

**KRYETARI:** Ju faleminderit zoti Buçinca! Fjalën e ka Arsim Rexhepi, le të përgatitet Synavere Rysha.

**ARSIM REXHEPI:** I nderuari zoti Kryetar,  
Të nderuar kolegë deputetë dhe deputete,

Unë isha për të mirë i befasuar nga ajo që ministri i Arsimit shpërfaqti këtu para nesh, por doli sikur Ministria e Arsimit është një koncern ndërtimi. Fakt është që mungon dhimbshëm hapësira për arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë, mirëpo më la një shije të hidhur mungesa e idesë për një qasje paralele edhe në reformat e gjithmbarshme që kanë të bëjnë me arsimin, dhe jo vetëm koncentrimi i tanishëm, të thuash i tërësishëm, në zgjerimin e hapësirës arsimore. Do të duhej që paralelisht ministri, Ministria, të koncentrohen shumë në procesin e dijnxënies dhe dijemarrjes në Kosovë dhe besoj se të gjithë këtu jemi të mendimit se ai është shkërmoqur i tëri dhe niveli i tij tashmë është vajtues. Kaq sa i përket çështjes nga ajo që ka servuar për buxhet, që është paraparë për buxhetin e Ministrisë së Arsimit.

Mirëpo, çka ishte pikënisja e diskutimit tim, është se me ardhjen e kësaj Qeverie të udhëhequr nga zoti Thaçi, në pushtet, unë kam shpresuar se do të kemi një qasje tjetër edhe ndaj pjesës veriore të Mitrovicës. E dimë të gjithë se përmes instrumenteve të

ndryshme të dirigjuara drejtpërdrejt nga Qeveria e Serbisë, atje para syve tanë po ndodhë një pastrim etnik, dhe në këtë buxhet që u servua këtu, unë nuk pash një intencë të kësaj Qeverie për të ndërtuar një strategji kundër mekanizmave dhe praktikave që po i përdorë komuniteti në Veri i dirigjuar dhe i ndihmuar nga Qeveria serbe. Do të thotë, mungon një fond që do t'i ndihmonte ata dhjetëra mijëra shqiptarë që janë dëbuar me dhunë dhe padrejtësisht nga banesat, shtëpitë, pronat e tyre dhe jetojnë në Jug apo të shpërndarë në pjesë të tjera të Kosovës.

Për ministrin e Kulturës kisha pasur, po dua, po kam një prirje sot për të qenë pak lokalist. Janë këtu të dhënat se ku do të shkojë buxheti për kulturë në mirëmbajtjen e objekteve kulturore. Në Vushttri mungon një qasje pak ma fer. I kemi disa objekte shumë të rëndësishme të kulturës sonë kombëtare, kemi një kala që nuk e ka kush në Kosovë, një urë të gurit që nuk e ka kush në Kosovë, Hamamin, Shtëpinë e Zejnullah Begut e kullat përreth. Vetëm po dua t'ju them një gjë. Së paku këtu janë nja pesë objekte nga Gjakova, që nuk janë në asnjë mënyrë më të rëndësishme se ato dhe si ka qenë e mundur që të koncentrohemi kaq shumë në Gjakovë dhe ta harroni njërin nga kasabatë më të lavdishme që i ka Kosova?

Edhe diçka për zotin Kryetar të Kuvendit, është teknike, por se tha askush. Unë po e shoh një diskriminim të tmerrshëm të gjuhës shqipe në Kuvend. Ajo çka ju keni dhënë këtu përmes Qeverisë, qoftë përmes shkresave që ju na i qoni neve, është për çdo kritikë. Në dhjetë fjali të një ftese që ju na e bëni neve, janë 25 gabime. Pse nuk ndodhë kjo me gjuhën serbokroate dhe angleze. Kjo, jashtë buxhetit, të kuptohemi. Mirëpo, duhet njëherë e përgjithmonë që ky Kuvend dhe ju si Kryetar ta merrni një lektor, një lektor të gjuhës shqipe që di ta artikulojë shkrimin shqip dhe jo si këtu në tri-katër fjalë, për shembull, “ë”-të janë të harruara tërësisht, “ë” nuk ka këtu në alfabetin e Kuvendit etj. etj. Ju kisha lutur që ta keni parasysh edhe këtë vërejtje. Ju faleminderit shumë!

**KRYETARI:** Ju faleminderit!

Krejt Kosova është e lavdishme, mendoj që çështja e gjuhës dhe e gabimeve gjuhësore është e administratës, por, unë sa e di, ka lektorë Kuvendi dhe ata mirë në përgjithësi i kryejnë punët. Ata sigurisht na dëgjojnë dhe do ta kenë këtë parasysh.

Fjalën e ka deputetja Synavere Rysha, le të përgatitet Ibrahim Gashi.

**SYNAVERE RYSHA:** Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Përsëritje për Kabinetin qeveritar,

Përsëritje edhe për deputetë, përsëritjet e mbrëmjes, kuptohet!

Unë, edhe pas gjithë këtyre diskutimeve ende nuk e kam të qartë se i kujt është ky buxhet, nga kush është përgatitur, nga Qeveria e kaluar apo nga Qeveria aktuale, që mendoj se do të kishte qenë mirë në qoftë se është përgatitur nga Qeveria e kaluar, kjo aktualja ta përpunojë, sepse të paktën i ka pasur dy muaj ditë, që ka pasur mundësi ta përpunojë dhe t'ia përshtat programit. Mirëpo, kjo është një fakt që Qeverisë po i mungon programi, kjo është dëshmia më e mira, por argumenti më i mirë se buxheti nuk

harmonizohet. Të paktën, gati secili diskutues që diskutoi i kishte vërejtjet paraprake. Vërejtje më të potencuara pati ka pozita se sa nga opozita. Prandaj, shihet se Qeveria punon pa program. Shpresoj që shpejt ta miratojë programin dhe të paktën ta harmonizojë me buxhetin që, ne sot ndoshta edhe duhet ta miratojmë për hir të proceseve, kuptohet. Ajo që kam pritur të jetë në këtë dokument, në momentin kur Qeveria u formua, e mori besimin në javët e para, më konkretisht në javën e parë, doli se Qeveria e kaluar nga një analizë që u bë, ndoshta e shkurtër, doli se diku rreth 20 milionë euro janë shpenzuar më tepër, apo janë shpenzuar rreth 50 milion euro për telefona, karburante dhe mëditje. Kryeministri u zotua se ato do t'i zvogëlojë për 30 milionë euro, do me thënë ishin në pyetje 20 milion euro. Kur këtë e pjesëtojmë apo e ndajmë në vite, unë të paktën kam pritur që 6 milionë euro të kemi zvogëlim të shpenzimeve për këtë periudhë. Për vitin 2008, përkundrazi këtu na del se kemi rritje të shpenzimeve. Të paktën kjo u raportua edhe nga ministri, u raportua edhe nga anëtarët e Komisionit, që kemi rritje të shpenzimeve, mirëpo kemi edhe pozicione ku parashihet blerja e automjeteve, apo edhe shpenzimet të tjera, që në fakt po del se këto janë rritur. Kjo është një diçka që nuk po përmbushen premtimet apo nuk po funksionon diçka.

Një çështje tjetër nga ministri i Arsimit, zoti Enver Hoxhaj, u diskutua se është ndarë një shumë prej 6 milion eurosh për favorizimin e arsimtarëve dhe kjo është për t'u përshëndetur. Mirëpo, unë kam njëkohësisht një sugjerim për Qeverinë: - qysh është punuar për arsimtarët, le të punohet edhe për punëtorët e administratës, edhe për shëndetësi, sepse jemi për favorizime. Në pagën bazë të shtohet gjithsesi edhe përvoja në punë, kualifikimi, mirëpo gjithherë të ndahen mjete dhe fonde të mjaftueshme. Në këtë formë, nëse duam cilësi dhe kualitete në punë, atëherë unë kam një sugjerim që të përkrahen edhe institucionet tjera, jo vetëm arsimi. Arsimi është për t'u përshëndetur, mirëpo duhet të shkohet në hapa më tutje, Qeveria të shkojë më tutje, ta përkrahë edhe administratën, qoftë lokale, qoftë qendrore, por edhe shëndetësinë si sfera apo pjesë përbërëse të këtij buxheti.

Një problem që është i theksuar dhe vërtetë me këta 6 milionë Qeveria apo edhe ministri, më konkretisht ministri i arsimit, mund të bëjë diçka. Është fjala për 30 arsimtarë të komunës së Ferizajt, të cilët ka dy vite që përballen me problemin, sepse nuk futen në listat e pagave. Ky është një problem që e shkakton Ministria e Arsimit dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave, që nuk i pranon këta punëtorë.

Duhet të kemi parasysh se qyteti i Ferizajt ka një specifikë të veçantë sa i përket çështjes së arsimit. Përveç nxënësve që gravitojnë në qytetin e Ferizajt, në shkollat e Ferizajt vijnë edhe nxënës nga komunat e tjera, madje vijnë edhe nga qytetet e tjera të Maqedonisë, si nga Tetova, Gostivari, Shkupi, Kumanova dhe nga Ulqini. Janë një pjesë këta që e rritin numrin e përgjithshëm të nxënësve, si duket Ministria nuk e ka të qartë apo nuk po do ta kuptojë.

Unë do të kërkoja këtë, nëse mundet tash ose në të ardhmen me rishikim gjashtëmujor, që është obligativ rishikimi, të bëhet diçka dhe këta arsimtarë të futen në listën e pagave dhe të kenë të drejtë të paguhën sikurse arsimtarët e tjerë.

Nga Programi, nga ajo që e elaboroi ministri për Ekonomi dhe Financa, do me thënë atë rritjen që e kishte paraparë, profesori Ramosaj e elaboroi shumë mirë, sepse në qoftë se shkoni me atë që në doganë të rritni taksa dhe të filloni të inkasoni, unë mendoj se do t'i ngufatni bizneset, prandaj nuk e di sa do të jetë shumë e arsyeshme apo sa do të jetë produktive ajo formë që ju e mendoni. Mirëpo, prapë mendoj se sfida për këtë Qeveri do të jetë, apo do të ishte një diçka e mirë zhblllokimi i mjeteve nga fondi i AKM-së dhe nga Fondi i pensioneve apo kontributi i pensioneve, sepse nga një shtet i varfër, siç është Kosova, financohen shtetet e tjera, sepse, fatkeqësisht, këto mjete i menaxhojnë krejt të tjerët.

E kuptoj se këto fonde, ndoshta për hir të mirëbesimit apo të pasigurisë mbahen jashtë, mirëpo ne e kemi një bankë që mund ta menaxhojë këtë buxhet dhe mund të kujdeset dhe në këtë formë mund t'u jepen bankave komerciale me një kamatë shumë të ulët 4 apo 6%, që mandej ato të mbikëqyren dhe të kontrollohen. Kjo do të jetë e favorshme për ekonominë e Kosovës apo edhe do ta mbushte buxhetin e Kosovës. Mendoj se kjo është sfida që është më lehtë të tejkalohet sesa ato që na i propozon Qeveria.

Dhe, krejt në fund, ne detyrohemi ta votojmë këtë buxhet për hir të proceseve. Mirëpo, nëse ka ndodhur që është shtyrë dhe për dy muaj ditë kemi pritur me një vendim të PSSP-së, apo të zotit Ruecker, të miratohen apo të ndahen mjetet dhe të shfrytëzohen, atëherë do të kishim pritur edhe për një periudhë, qoftë edhe dyjavore apo edhe një muaj, dhe vërtet ta votojmë një buxhet me krejt këto vërejtje, me krejt këto kërkesa që ishin nga deputetët, mendoj shumë të arsyeshme, po sido që të jetë, ne do t'i përkrahim dhe do të jemi pjesë e proceseve. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit zonja Rysha! Fjalën e ka Ibrahim Gashi, le të përgatitet ministrja Nekibe Kelmendi.

IBRAHIM GASHI: Ju faleminderit zoti Kryetar!  
Përshëndetje Kabinetit qeveritar,  
Përshëndetje të gjithë kolegëve deputetë,

Unë isha paraqitur më herët për të diskutuar, por e tërhoqa fjalën time, duke dëgjuar njerëz që janë më të fahut, përkatësisht diskutimet shumë konstruktive dhe shumë profesionale si nga radhët e opozitës, ashtu edhe nga radhët e pozitës për një çështje mjaft fundamentale siç është çështja e buxhetit të Kosovës.

Natyrisht, kah fundi, si duket dikë filloi të lëshoi kondicioni parlamentar që të debatojmë edhe më tutje dhe ramë në do emocione partiake që t'i bëjnë pak, si të themi, marketing punës së Qeverisë për një periudhë kaq të shkurtër, ose të na ndajnë leksione për rëndësinë në cilën është procesi i statusit të Kosovës.

Unë do të doja që të dy kolegëve deputetë, unë mendoj se e kanë parasysh për kënd e kam fjalën, t'ju kujtoj se ne po diskutojmë një çështje shumë kruciale siç është çështja e buxhetit, e cila është shumë e ndërlikuar me rrjedhën e procesit politik nëpër të cilën po kalon Kosova. Ne e kemi para vetes një sërë ligjesh, besoj që secilit ju kanë

grumbulluar në zyrat e tij, të cilat duhet të miratohen në një procedurë të rregullt, por natyrisht më të shpejtuar, dhe të cilat kanë njëfarë mënyre lidhshmëri dhe ndonjëherë kanë konsekuencë të drejtpërdrejtë buxhetore. Ne ende s'e kemi shumë të qartë se të gjitha këto ligje janë të harmonizuara me fuqinë buxhetore që po e aprovojmë sot. Pastaj, ne kemi një pako të ligjeve që burojnë nga Propozimi gjithëpërfshirës i zotit Ahtisari, për të cilat edhe nuk kemi kohë të diskutojmë, madje edhe të bëjmë analiza të shumta të implikimeve, përkatësisht të konsekuencave buxhetore që do të kenë ato.

E dyta, dua të kujtoj se u përmend 100 – ditshi. Ne këtë nuk e përmendëm nga radhët e opozitës, sepse kishim konsideratë edhe për procesin, edhe për peshën e zhvillimeve të cilat janë, para së gjithash, mbi Qeverinë, do me thënë barra e këtyre zhvillimeve po bie në radhë të parë mbi Qeverinë, pastaj mbi ne, do me thënë mbi opozitën. Unë dua t'ju kujtoj se nuk është mirë të thuhet se kemi filluar mirë, kur ne sot po diskutojmë dhe nuk kemi një program qeveritar. Mbi çfarë baze mund të konkludojmë se diçka po përmbushet nga ato parametra që ne nuk i dimë cilat do të ishin?

Pastaj, nuk ka shumë vend për mburrje se së pakut në fazën e parë të këtij buxheti që po e aprovojmë deri në rishikimin e parë në qershor, është thënë publikisht nga radhët e Qeverisë, pra nga njerëzit shumë kompetentë në Qeveri, se nuk do të ketë rritje të pagave deri në qershor. Në çfarë baze ta proklamojmë një sukses. Pastaj, është edhe një diçka tjetër që duhet ta kemi shumë parasysh. Të mos na kap euforia se kemi një praktikë kur qeveritë dinë të jenë të suksesshme në 100 ditët e para, por pastaj bien në një, si të themi, vetëkënaqësi dhe, si të thuash, bien në merimangën e dukurive që janë evidente në Kosovë. Megjithatë, nuk kemi ndonjë argument se kemi lëvizur diçka në drejtim të luftimit të këtyre dukurive, ende jemi në fazën e përgatitjes. Unë konsideroj se edhe Qeveria kështu mendon në fazën e përgatitjes për të filluar, si ta quaj ashtu kushtimisht, ofensivë ndaj këtyre dukurive.

Ende ka shumë fjalë, ende nuk ka diçka që preket, shihet. Kështu, duke pasur, gjithsesi si opozitë, mirëkuptim për procesin, edhe njëherë konsideroj se kjo ishte edhe arsyeja që partia jonë i dha mbështetje, apriori i dha mbështetje përshpejtimit të aprovimit të Projektbuxhetit. Ju faleminderit!

**KRYETARI:** I kisha lutur deputetët që, vërtet, të mos nxiten për debat nga debatues të ndryshëm. Fjalën e ka Nekibe Kelmendi, le të përgatitet Esad Brajshori.

**NEKIBE KELMENDI:** Diskutimi im është më tepër parimor se sa shifror, sepse shifra që është ndarë për sistemin e drejtësisë është për mua e pamjaftueshme. Do t'u mbetesha borxh kuadrove gjyqësore, prokuroriale dhe stafit administrativ të tyre, nëse nuk do të propozoja që për pagat e tyre buxheti apo nuk e di, siç i quajnë, vija buxhetore, të rritet, e të mos i harrojmë, gjithashtu, edhe shërbimin korrektues dhe pesë burgjet e qarqeve. Është kjo në interes të fillimit të reformës gjyqësore, është kjo në interes të sundimit të ligjit, të efikasitetit të gjykatave e të prokurorive, të luftës kundër korrupsionit. Këtë çështje e kam ngritur edhe në Qeveri, po e ngreh edhe këtu. T'ju përkujtoj se vetëm Shërbimi Korrektues ka 2200 punëtorë, e ku është pastaj numri i

gjyqtarëve, i prokurorëve, i stafit administrativ, i 14 zyrave ndërlidhëse gjyqësore etj. etj., dhe vetëm për 1.200.000 është rritur buxheti sa i përket sistemit të drejtësisë.

Kërkoj mirëkuptim edhe për sistemin e drejtësisë, meqenëse kjo është një shtyllë mjaft e rëndësishme e shtetit.

KRYETARI: Ju faleminderit, zonja Nekibe Kelmendi. Fjalën e ka Esat Brajshori, le të përgatitet Gani Geci.

ESAD BRAJSHORI: Zoti Kryetar,  
Kabinet qeveritar,  
Kolegë deputet,

Për mua është hera e parë që ndodhem brenda objektit të këtij Parlamenti dhe të them singërisht nga të qenit vetëm qytetar, kohë më parë kam qenë shumë kurioz të shoh se si mund të punojnë 100- 120 njerëzit e përzgjedhur të popullit të vet, ose edhe të pakicave të tjera.

Singërisht i kam parë me admirim, me përgjegjësi të mëdha këta njerëz dhe kam pasur njëfarë droje, që edhe unë një ditë do të jem pjesë e këtyre përgjegjësive. E kuptoni në ç' lartësi ka qenë respekti im për njerëzit e Parlamentit.

Përvojat që unë i krijova në këtë parlament, në këtë legjislacionin e tretë, më kanë krijuar një lloj shqetësimi të pashpjegueshëm ndoshta dhe të pakuptueshëm për disa këtu. Shpejtësia kozmike, të them kështu, me të cilën kërkohen që të merren disa vendime shumë të rëndësishme, më vë para një sprove dhe dileme nëse pesha e deputetit të Kosovës e ka peshën e vet të duhur, apo e luan këtë peshë. Sikur dhe në seancat e kaluara, kur çdo gjë duhej të votohej në mënyrë të shpejtuar...

KRYETARI: Ju lutem Esat, tema është shumë konkrete, dil në temë se nuk kemi kohë.

ESAD BRAJSHORI: ... shumë konkretisht zoti Kryetar, do të vijë aty sepse është e domosdoshme. Edhe kësaj radhe kërkohet një përshejtim, në mënyrë që të vendoset për Buxhetin e Kosovës.

Është shumë paradoksale që unë të votoj për një buxhet që nuk e njoh programin të cilit do t'i referohem. Singërisht, nuk e di si mund të votohet diçka kur nuk ka program qeveritar në lidhje me këtë çështje, dhe kjo u diskutua disa here. Kërkohet nga ky Kuvend që të bëjë propozime, të japë sugjerime dhe se ato do të shihen. Unë e di se Kuvendi merr vendime. Ti kthehemi asaj çështjeje të cilën unë dua ta ngrehë këtu, çështjen e kulturës dhe të artit në Kosovë.

U fol për shumë sfera dhe sigurisht secili nga këndi i vet i përgatitjes profesionale i shtroi ato. Mendoj se aristokracinë shpirtërore të këtij populli e përbëjnë pikërisht klasa e krijuesve, e artistëve dhe mendoj se pikërisht kjo klasë është lënë absolutisht pas dore ose nuk shihet fare si pjesë e rëndësishme e zhvillimit të shoqërisë sonë. Ju merrni me

mend se Qendra kinematografike e Kosovës, shumë fat i mirë që këtu e kemi edhe ministrin, ajo nuk frymon tash e tre - katër vjet dhe nuk dihet fati i saj dhe nuk e dimë fare ne se si do të shkojë zhvillimi i mëtutjeshëm.

Buxheti që figuron për Ministrinë e Kulturës, ka një rritje nga ai i Qeverisë së përparshme dhe kjo është për t'u përshëndetur, por kjo rritje është aq sa ka qenë para katër pesë viteve që ka pasur po kjo Ministri e Kulturës, 9 milionë e diçka.

Ajo që unë do të doja t'ju pyesja juve zoti Kryetar, Qeverinë që është këtu dhe këta deputetë, a ka mundësi ta kthejmë kokën pak nga zhvillimi i kulturës dhe artit te ne. Mendoj se kultura është me fytyrë për dhe, mendoj se artisti nuk ka asnjë lloj dinjiteti në kuptimin e trajtimit të tij, t'ju përmendi unë se aktori i klasit të parë çfarë page ka, seriozisht është qesharake për këtë Kuvend, dhe të gjejmë mënyra se si mund ta stimulojmë zhvillimin e kulturës dhe të artit te ne.

Për mos t'ju mërzhitur se jeni lodhur nga e gjithë kjo kohëzgjatje, unë kam një propozim. Unë mendoj që do të ishte shumë normale që të shkarkohen nga një pjesë e tatime të gjitha ato subjekte ekonomike, të cilat në formë donacionesh do ta ndihmonin artin dhe kulturën, përveç këtij buxheti që tani është i paraparë nga Qeveria e Kosovës. Meqë kultura te ne dhe arti nuk ka mundësi të rigjenerojë para, atëherë të gjendet ky model, në mënyrë që të mbështetet kjo fushë shumë e rëndësishme te ne. Ju faleminderit që patët durim. Unë e di që ju jeni mësuar që të dëgjoni vetëm projekte, do me thënë ndërtim, arsim dhe kultura pak më anash. Ndoshta ishte e bezdisshme, por seriozisht mendoj se duhet të kthehet shikimi pikërisht nga kjo kategori dhe nga kjo fushë që përbën aristokracinë shpirtërore të këtij populli. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit zoti Brajshori! Fjalën e ka Gani Geci, le të përgatitet Riza Smaka.

GANI GECI: Ju faleminderit, zoti kryesues!  
Të nderuar qeveritarë,  
Të nderuar kolegë deputetë,

Unë nuk jam ekspert i financave dhe nuk do të ndalem shumë rreth buxhetit dhe vijave buxhetore, por duke pasur parasysh situatën dhe rrjedhat politike që po kalon Kosova, rreth rrumbullakimit të statusit, edhe ne, edhe popullata jemi në pritje të vazhdueshme, edhe opozita, por edhe pozita nga frika se mos po bëhet pengesë e proceseve, po i votojmë edhe mocionet edhe përshpejtimet edhe shpejtimet edhe Ligjin për buxhet, i cili ligj është pa një program qeveritar. Ju lutem, unë besoj se tash ju nuk jeni më nën hije, jeni dalë në diell, dhe meqë jeni dalë në diell, atëherë ju lutem, na sillni një program qeveritar dhe ne ta shohim atë. Dhëntë Zoti e po e kalojmë këtë ankth, këtë frikë dhe po vendoset statusi i Kosovës dhe në të ardhmen, besoj se ligjet që do të na vijnë këtu do të kemi pak më shumë kohë që t'i analizojmë edhe si deputetë, edhe si ekspertë, prandaj, në të ardhmen nuk do t'i votojmë ligjet kështu, siç do të votojmë tash, përpara zgjidhjes së statusit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit deputet Geci! Fjalën e ka Riza Smaka, le të përgatitet ministri Skender Hyseni.

RIZA SMAKA: I nderuar Kryetar i Kuvendit të Kosovës,  
Ministra,  
Deputetë të respektuar të Kuvendit të Kosovës,

Një punë të cilën e pati nisur ish Qeveria dhe nuk e pati mbaruar, ishte punë e mirë kështu parimisht, por pati dështuar. Do të dëshiroja që kjo Qeveri ta realizonte dhe kjo është kjo, e cila ka direkt impakt në buxhet, për atë e ngrejë që të pozicionohet në buxhet. Është ë fjala për një ligj, për harmonizimin e pagave të shërbyesve civilë në përgjithësi, dhe gjithësi aty do të duhej medoemos të bëhen harmonizime substanciale, të tejkalohen disa diferenca kurrësi të logjikshme edhe absolutisht të patolerueshme, që bie fjala, një pastruese, të marrim konkretisht KEK-un, ta ketë pagën dyfish më të lartë se një profesor universitar, apo se një oficer i Shërbimit, po e zëmë, policor apo i TMK-së, e kështu me radhë. Prandaj, gjithësi kjo punë do të duhej të bëhej, sepse veç këtu u pamenden edhe nga ministrat, po e zëmë, që angazhohen për ministrinë e vet në atë kuptimin pozitiv, që të përmirësohen pagat. Prandaj, ju lutem, unë do të isha angazhuar që ky ligj të bëhet sa më parë që është e mundur, së paku të hyjë në fuqi për këtë pjesën e dytë, kur të bëhet rekapitullimi i buxhetit. Ju lutem, kudo në botën e përparuar, e na aspirojmë për t'u bërë botë e përparuar, ekstra profiti i cili realizohet në organizatat biznesore, në ndërmarrjet publike, që nuk është rezultat i punës, i rezultatit në punë, i efekteve nga puna e dobishme kreative, por i pozitës monopoliste, ai merret në bazë të ligjit që e përmenda, dhe pozicionohet në buxhetin e Kosovës. Nëse do bëhej kjo punë, pa fije të dyshimit do të krijojë një bazë juridike e solide shumë të përshtatshme edhe njerëzore, dhe do të kishim pasur mundësi për ta paguar diç më tepër invalidin e luftës, invalidin e punës, të pastrehuarin që e përmendi një koleg këtu, që tha se është e turpshme për t'u përmendur paga e një artisti të afirmuar, e një mjeku që punon me pacientë, bën operacione etj. etj. Prandaj, ju lutem, krejt kjo që e them, e them me qëllimin më të mirë në funksion edhe të postulateve premtuese në fushatën elektorale të pozitave të sotëm dhe e krijojnë një bazë solide për t'u realizuar kjo. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka Skender Hyseni.  
Lus deputetët që nuk janë në sallë, le të kthehen për të votuar.

SKENDER HYSENI: Ju faleminderit!

Zoti Kryetar i Parlamentit,

Të nderuar deputetë,

Dy deputetë të nderuar nga opozita e kanë kualifikuar gjendjen në kulturë si gjendje të rëndë të papranueshme, dhe mua nuk më mbetet tjetër pos të pajtohem plotësisht me ta dhe me të gjithë ata që gjenden në këtë fushë e kualifikojnë si të papranueshme.

Gjendja në tri fushat, në të vërtetë që i mbulon Ministria të cilën unë drejtoj, edhe kultura, edhe rinia, edhe sportet, është e rëndë, kryesisht si pasojë e përkrahjes joadekuate financiare dhe e trajtimit joadekuat financiar. Ky trajtim financiar që iu

është dhënë në vazhdimësi këtyre fushave, nuk është i qëllimtë, por është trajtim që ka ardhur prapë si rezultat i shtrëngimeve buxhetore dhe financiare të vendit. Sido që të jetë, sivjet ka një shtim të ndjeshëm të buxhetit për këto tri fusha. Prapë po ju them që është shumë larg nga kërkesat shumë racionale dhe shumë të arsyeshme për të tria këto fusha. Mirëpo, për një gjë mund t'ju siguroj. Kabineti aktual qeveritar e ka kuptuar shumë seriozisht thirrjen e ministrit të Kulturës, të Rinisë dhe të Sportit, si dhe të komunitetit artistik, kulturor e sportiv në Kosovë, që këto fusha nga periferia e vëmendjes së institucioneve t'i tërheqë drejt qendrës.

U përmend Qendra Kinematografike, u përmend trashëgimia kulturore. Të jeni të sigurt që edhe trashëgimia kulturore, duke përfshirë edhe Kështjellën në Vushtrri, edhe Urën e Gurit në Vushtrri, edhe shumë çka tjetër, do të jenë në fokus të Ministrisë dhe të departamenteve përkatëse. Sigurisht deputeti Brajshori, mbase i ka përcjellë me vëmendje dhe për këtë e falënderoj. Deklarimet e mia publike dhe qëllimet e mia janë për ta riaktivizuar Qendrën Kinematografike të Kosovës. S'do të bëjë asgjë, vetëm do ta zbatoj ligjin të cilin ky Kuvend e ka aprovuar. Po kështu do të aprovoj dhe do të zbatoj ligjet në fushat e tjera, në Teatër, dhe do të përpiqem që të subvencionoj në ato fusha të kulturës që nuk janë fitimprurëse. Këtu kam parasysh para se gjithash fushën e botimeve, do me thënë fushën e librit, pastaj hulumtimet dhe gërmimet arkeologjike që janë të një rëndësie të dorës së parë për Kosovën dhe identitetin e domosdoshëm kulturor, që Kosova duhet ta ndërtojë dhe me të cilin Kosova duhet të konkurrojë tash si shtet i pavarur dhe sovran.

Arkeologjia e Kosovës, baseni arkeologjik i Kosovës nuk është asgjë tjetër veçse vazhdimësi e basenit arkeologjik shqiptar, basenit arkeologjik të rajonit dhe kjo fushë do edhe investime, do edhe një vëmendje të veçantë. Për të gjithë këto, Qeveria aktuale ju siguron që në rishikimin e buxhetit në qershor do të ndajë më shumë mjete dhe për këtë unë e kam marrë zotime edhe nga ministri i Financave, edhe nga Kryeministri dhe nga i gjithë Kabineti qeveritar. Megjithatë, mua më duhet të them që kjo kornizë buxhetore që është caktuar për kulturën, rininë dhe sportet, duke pasur parasysh mundësitë financiare të Kosovës sot, është, ka qenë ajo e mundshmja. Të shpresojmë që me rishikim do të ketë mundësi për më shumë. Ju faleminderit shumë!

**KRYETARI:** Një sugjerim për ministrat. Kur Projektligji debatohet në parim, nuk ka nevojë për arsyetime. Në leximin e dytë ministrat mund ta arsyetojnë debatin që zhvillohet për Projektbuxhetin. Prandaj, edhe disa kërkesa kanë mundur t'i bëjnë në Qeveri kur është përgatitur Projektbuxheti.

Konsideroj se debati ka përfunduar. Lus deputetët dhe regjinë që të përgatiten për votim për miratimin në parim të Projektligjit për Buxhetin e Kosovës për vitin 2008.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 75 vota "për", 12 "kundër" dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për Buxhetin e Kosovës për vitin 2008.

Lus Komisionin për Buxhet dhe Financa, si Komision përgjegjës dhe raportues, që për seancën e veçantë, që do të mbahet sonte pas gjysmë ore, të paraqesë dhe arsyetojë Raportin me rekomandime lidhur me shqyrtimin e dytë të Projektligjit për Buxhetin e Kosovës për vitin 2008.

Seanca e sotme, kjo pjesë e seancës, mori fund. Vazhdojmë pas gjysmë ore seancën e re.

Përgatiti:

***Njësia e Transkripteve e Kuvendit të Kosovës***